



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Vlerësimi i varfërisë në Kosovë

Vëllimi I: Përshpejtimi i zhvillimit gjithëpërfshirës për uljen e shkallës së gjerë të varfërisë

3 tetor 2007

Banka Botërore
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
Njësia për reduktimin e varfërisë dhe
menaxhimin ekonomik
<http://www.worldbank.org/ECA/poverty>

Enti i Statistikës së Kosovës
Departamenti i Statistikave Sociale
Sektori i standartit jetësor
<http://www.ks-gov.net/ESK>

VALUTAT DHE NJËSITË EKUIVALENTE

(më 3 tetor 2007)

Njësia valutore	=	Euro
1 US\$	=	0.71 Euro

SHKURTESAT

ERR	Ekivalenti për të rritur
BSHP	Bashkësia e shteteve të pavarura
IÇK	Indeksi i çmimit të konsumatorëve
ZN	Zonat e numërimit
AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
ECA	Evropa Lindore dhe Azia Qendrore
ECAPOV	Baza e të dhënave të Bankës Botërore për varfërinë në Evropën Lindore dhe në Azinë Qendrore
BE	Bashkimi Evropian
BE-8	Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia Republika e Sllovakisë dhe Sllovenia
ABEF	Anketa e buxhetit të ekonomive familjare
EF	Ekonomi familjare
AHSHEF	Anketa e të hyrave dhe shpenzimeve të ekonomive familjare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
SPZHK	Strategjia dhe plani zhvillimor i Kosovës
VAU	Vendet me të ardhura të ulëta
AVSJ	Anketa për vlerësimin e standardit jetësor
VAM	Vendet me të ardhura të mesme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
VV05	Vlerësimi i varfërisë 2005
SHISHP	Shqyrtimi institucional dhe i shpenzimeve publike
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
EJL	Evropa Juglindore
SIDA	Agjencia suedeze për zhvillim ndërkombëtar
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
GPT	Grupet punuese teknike
UNMIK	Misioni i OKB-së në Kosovë

FALËNDERIMET

Ky raport është rezultat i punës së përbashkët të personelit të Entit Statistikor të Kosovës në njësinë e Anketave për buxhetin e ekonomive familjare të përbërë nga Bashkim Bellaqa, Bekim Canolli dhe Emina Deliu, si dhe ekipit teknik të Bankës Botërore, të përbërë nga Andrew Dabalen dhe Anna Gueorguieva, të përkrahur nga Sasun Tsirunyan dhe Shpend Ahmeti. Raporti është mbështetur nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID) i Britanisë së Madhe, i cili me zemërgjerësi ka financuar fondin e mirëbesimit për të përkrahur ndërtimin e kapaciteteve dhe aktiviteteve analitike të punës e programore për varfërinë në Ballkanin Perëndimor.

Ky raport nuk do të mund të hartohet pa pjesëmarrjen dhe përkrahjen e madhe të Departamentit për statistika sociale të Entit Statistikor të Kosovës.

Ekipi në mënyrë të veçantë e falënderon punën analitike të FMN-së (në fushën e makrostatistikave), AER-in dhe Ministrinë e Bujqësisë të IPVQ-ve, ESK-në dhe Vllaznim Bytyqin (Zyra për emigracion).

Ekipi ka përfituar nga komentet dhe udhëzimet e Peter Lanjouw (recensent), Pierella Paci (recensente), Asad Alam, Ardo Hansson, Elisabeth Huybens, Felix Martin dhe Kanthan Shankar. Ekipi u shpreh mirënjohje edhe Julian Lampiotti, Ruslan Yemtsov, Kinnon Scott, Gero Carletto, Marcus Goldstein, Gabriel Demombynes, Juan Munoz, dhe Johan Mistiaen për komentet dhe sugjerimet e tyre të shkëlqyeshme.

Hartimi i këtij raporti është ndihmuar në mënyrë të jashtëzakonshme nga aftësitë e shkëlqyeshme të redaktimit të Susana Padillas.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	i
KAPITULLI 1. KONTEKSTI SOCIAL DHE MAKROEKONOMIK	1
A. Rritja e BPV- së ka qenë e vogël	1
B. Zhvillimi bujqësor ka qenë i ngadalshëm	3
C. Funksionim zhgënjyes i tregut të punës.....	4
D. Perspektivë e ulët për zvogëlimin e varfërisë	5
KAPITULLI 2. TRENDET E VARFËRISË DHE ZBËRTHIMI	7
A. Një shënim mbi qasjen dhe cilësinë e të dhënave.....	7
B. Varfëria nuk ka ndryshuar	11
C. Dimensionet varfërisë që nuk bazohen në të hyra	16
KAPITULLI 3. PROFILI I VARFËRISË DHE RREZIKU I VARFËRISË.....	19
A. Karakteristikat demografike të ekonomive familjare të varfra	19
B. Karakteristikat e tregut të punës të të varfërve	21
C. Arsimiti dhe shkalla e varfërisë	22
D. Niveli i manifestimit të varfërisë	23
E. Pse janë të varfër njerëzit dhe kush është në rrezik të madh nga varfëria?	26
KAPITULLI 4. TRANSFERET PUBLIKE, PARATË E DËRGUARA NGA DIASPORA DHE VARFËRIA	32
A. Përbërja dhe trendet e transfereve të mbrojtjes sociale.....	32
B. Ndikimi i programeve të mbrojtjes sociale në varfëri	34
C. Sasia dhe shpërndarja e parave të dërguara nga diaspora	37
D. Ndikimi i emigracionit në varfëri	39
KAPITULLI 5. FORCIMI I THEMELIT TË MONITORIMIT TË VARFËRISË DHE HARTIMI I POLITIKAVE BAZUAR NË DËSHMI	44
Shtojca A. Tabelat dhe ilustrimet.....	48
Shtojca B. Profili i varfërisë.....	53
Shtojca C. Zbërthimi i varfërisë.....	72
Shtojca D. Transferet Sociale dhe paratë e dërguara nga diaspora.....	76
Referencat	83

Lista e Tabelave

Tabela i: Politikat e propozuara, kostoja e tyre dhe ndikimi i varfërisë.....	x
Tabela 1.1: Trendët makroekonomike	2
Tabela 1.2: Vlerësimet alternative të BPV-së për Kosovën	3
Tabela 1.3: Treguesit e sektorit makroekonomik dhe të bujqësisë	4
Tabela 1.4: Pagat mujore mesatare dhe numri i vëzhgimeve	5
Tabela 2.1: Zbërthimi i varfërisë: 2003/04 krahasuar me 2005/06.....	14
Tabela 2.2: Shkalla e zhvillimit në konsum për kokë banori.....	14
Tabela 2.3: Treguesit e pabarazisë për 2003/04 dhe 2005/ 06.....	14
Tabela 3.1: Shkalla absolute dhe e skajshme e varfërisë duke përdorur metodologjinë PA 05	21
Tabela 3.2: Varfëria dhe papunësia	22
Tabela 3.3: Punësimi dhe arsimi, 2005/06.....	23
Tabela 3.4: Shkalla e varfërisë dhe kontributi sipas rajonit në Kosovë, 2003-2006.....	24
Tabela 3.5: Ndikimi i ndryshimeve në karakteristikat e ekonomive familjare në varfëri	30
Tabela 4.1: Programet pensionale dhe të ndihmës sociale	32
Tabela 4.2: Ndihma sociale dhe pensionet	35
Tabela 4.3: Përshatshmëria dhe simulimi i transferit të ndihmës sociale dhe pensionit	37
Tabela 4.4: Emigrimi dhe paratë e dërguara nga diaspora: përmbledhje e statistikave për vitin 2005	39
Tabela 4.5: Rezultatet e krahasimit të prirjeve për shkallët e regjistrimit sekondar.....	40
Tabela 4.6: Paratë nga jashtë në vitin 2005 sipas ekonomive familjare pranuese.....	41
Tabela A.1: Dallimi në supozimet e Bankës Botërore dhe FMN-së.....	48
Tabela A.2: Përmbledhja e statistikave të përgjithshme kryesore sipas valës të anketimit	48
Tabela A.3: Konsumi mujor mesatar i ushqimit.....	48
Tabela A.4: Shpenzimet mujore mesatare joushqimore të EF.....	49
Tabela A.5: Pjesa e shpenzimeve ushqimore dhe joushqimore në shpenzimet e përgjithshme.....	50
Tabela A.6: Pjesa e shpenzimeve për kategoritë ushqimore	50
Tabela A.7: Llogaritja e varfërisë për banorë sipas lokacionit.....	50
Tabela A.8: Kosovë: Vlerësimet e BPV nga FMN në çmime aktuale, 2004–10.....	51
Tabela A.9: Shkalla e varfërisë, dallimi dhe ashpërsia.....	52
Tabela B.1: Llogaritja e varfërisë sipas lokacionit, rajonit dhe zonave etnike	53
Tabela B.2: Kontributi i varfërisë sipas lokacionit	53
Tabela B.3: Kontributi i varfërisë sipas rajonit.....	53
Tabela B.4: Kontributi i varfërisë sipas zonave etnike	53
Tabela B.5: Llogaritja e varfërisë për kokë banori sipas kategorisë së madhësisë së EF	54
Tabela B.6: Llogaritja e varfërisë sipas përkatësisë etnike të kryefamiljarit të EF	54
Tabela B.7: Llogaritja e varfërisë për kokë banori sipas gjinisë së kryefamiljarit të EF.	54
Tabela B.8: Pjesa e të moshuarve në EF dhe varfëria.....	54
Tabela B.9: Proporcioni i varshmërisë dhe llogaritja e varfërisë.....	54

Tabela B.10: Arsimimi i kryefamiljarit të EF dhe llogaritja e varfërisë për kokë banori	5454
Tabela B.11: Aktiviteti kryesor i kryefamiljarit të EF dhe llogaritja e varfërisë për kokë banori	55
Tabela B.12: Sektori i punësimit të kryefamiljarit të EF dhe llogaritja e varfërisë	5555
Tabela B.13: Posedimi i tokës dhe varfëria rurale	5555
Tabela B.14: Posedimi i bagëtisë.....	5555
Tabela B.15: Posedimi i pajisjeve të rënda dhe varfëria në zonat rurale.....	5555
Tabela B.16: Punësimi dhe arsimimi, 2002/03.....	5656
Tabela B.17: Papunësia dhe arsimi, 2003/04.....	56
Tabela B.18: Punësimi dhe arsimi, 2003/04	56
Tabela B.19: Papunësia dhe arsimimi, 2003/04.....	57
Tabela B.20: Arsimimi dhe punësimi, 2004/05	57
Tabela B.21: Papunësia dhe arsimi, 2004/05.....	57
Tabela B.22: Punësimi dhe Arsimi, 2005/06.....	58
Tabela B.23: Papunësia dhe arsimimi, 2005/06.....	58
Tabela B.24: Varfëria dhe papunësia.....	58
Tabela B.25: Bruto shkalla e regjistrimit për shkollimin fillor.....	58
Tabela B.26: Neto regjistrimi për shkollat fillore.....	59
Tabela B.27: Neto regjistrimi për shkollat e mesme.....	59
Tabela B.28: Neto shkalla e regjistrimit për arsimin terciar	59
Tabela B.29: Qasja në energji elektrike	60
Tabela B.30: Ngrohja qendrore.....	60
Tabela B.31: Qasja në objekte të sigurta banimi	60
Tabela B.32: Qasja në ujë	60
Tabela B.33: Niveli i varfërisë rurale për kokë banori dhe kontributi në varfëri	6161
Tabela B.34: Ndarja etnike rurale: Llogaritja e varfërisë për kokë banori dhe kontributi	61
Tabela B.35: Zona rurale, ngritja arsimore	62
Tabela B.36: Qasja e zonave rurale në energji elektrike	62
Tabela B.37: Qasja e zonave rurale në objekte të sigurta banimi	62
Tabela B.38: Ngrohja qendrore në zonat rurale.....	62
Tabela B.39: Qasja e zonave rurale në ujë.....	6262
Tabela B.40: Papunësia në zonat rurale	63
Tabela B.41: Bruto niveli i regjistrimit në zonat rurale për shkollat fillore	63
Tabela B.42: Neto niveli i regjistrimit në zonat rurale për shkollat fillore.....	63
Tabela B.43: Neto niveli i regjistrimit në zonat rurale për shkollat e mesme	63
Tabela B.44: Neto regjistrimi në zonat rural në arsimin e lartë.....	6464
Tabela B.45: Grupet në gjendje të rëndë mbi kufirin e varfërisë	6464
Tabela B.46: Grupi i në gjendje të rëndë i shënuar nën kufirin e varfërisë	6565
Tabela B.47: Migruesit e brendshëm dhe lokacioni ku janë pranuar ata	6767
Tabela B.48: Treguesit e pabarazisë gjatë 2002-2006	68
Tabela B.49: Lidhjet e konsumit sipas viteve.....	68
Tabela B.50: Krahasimi i nivelit të regjistrimit në shkolla në rajon, 2005	70
Tabela B.51: Kontributi në varfëri sipas aktivitetit të kryefamiljarit.....	70
Tabela B.52: Kontributi në varfëri sipas arsimimit, 2005/06.	70
Tabela B.53: Shpërndarja demografike	7171

Tabela B.54: Shpërndarja demografike sipas llojit të vendbanimit dhe rajonit 2005/06.	7171
Tabela C.1: Zbërthimi i varfërisë: 2002/03 krahasuar me 2003/04	7272
Tabela C.2: Zbërthimi i varfërisë: 2002/03 krahasuar me 2004/05	72
Tabela C.3: Zbërthimi i varfërisë: 2002/03 krahasuar me 2005/06	72
Tabela C.4: Zbërthimi i varfërisë: 2003/04 krahasuar me 2004/05	7272
Tabela C.5: Zbërthimi i varfërisë: 2003/04 krahasuar me 2005/06	72
Tabela C.6: Zbërthimi i varfërisë urbane: 2002/03 krahasuar me 2003/04	72
Tabela C.7: Zbërthimi i varfërisë urbane: 2002/03 krahasuar me 2003/04	73
Tabela C.8: Zbërthimi urban: 2002/03 krahasuar me 2004/05	73
Tabela C.9: Zbërthimi i varfërisë urbane: 2002/03 krahasuar me 2005/06	73
Tabela C.10: Zbërthimi i varfërisë urbane: 2003/04 krahasuar me 2005/06	7373
Tabela C.11: Zbërthimi i varfërisë urbane: 2003/04 krahasuar me 2005/06	73
Tabela C.12: Zbërthimi i varfërisë urbane: 2004/05 krahasuar me 2005/06	73
Tabela C.13: Zbërthimi i varfërisë rurale: 2002/03 krahasuar me 2003/04	74
Tabela C.14: Zbërthimi i varfërisë rurale: 2002/03 krahasuar me 2004/05	74
Tabela C.15: Zbërthimi i varfërisë rurale: 2002/03 krahasuar me 2005/06	74
Tabela C.16: Zbërthimi i varfërisë rurale: 2003/04 krahasuar me 2004/05	74
Tabela C.17: Zbërthimi i varfërisë rurale: 2003/04 krahasuar me 2005/06	74
Tabela C.18: Zbërthimi i varfërisë rurale: 2004/05 krahasuar me 2005/06	74
Tabela D.1: Ekonomitë familjare urbane dhe rurale me para nga diaspora dhe me emigrantë	7877
Tabela D.2: Rezultatet e krahasimit të variablave për vlerësimin 2-fazor të efektit që ka një emigrant në mirëqenien e ekonomisë familjare	7978
Tabela D.3: Rezultatet e bashkërendimit të bazës së prirjes për konsum	8079
Tabela D.4: Shkalla e varfërisë së EF-ve me dhe pa emigrantë, bashkërendimi i bazës së prirjes	8180
Tabela D.5: Krahasimi 2-fazor IV i variablave për efektin që ka një emigrantë në konsum, sipas zonave urbane dhe rurale	81

Lista e rubrikave

Rubrika 1.1: A është rritur shkalla e varfërisë në Kosovë? JO	ii
Rubrika 2.1: Vlerësimi i popullsisë së Kosovës	7
Rubrika 2.2: Sfidat e përdorimit të të dhënave të ABEF-it për analiza të varfërisë	8
Rubrika 3.1: Tri hipoteza për kushtet degjeneruese të ekonomive familjare serbe	2119

Lista e ilustrimeve

Ilustrimi i: Nivelet absolute dhe ekstreme të varfërisë	i
Ilustrimi ii: Llogaritja e varfërisë sipas banorëve në Ballkanin Perëndimor	ii
Ilustrimi iii: Nivelet e varfërisë sipas madhësisë së ekonomisë familjare	iii
Ilustrimi iv: Niveli i varfërisë sipas statusit të fuqisë punëtore	iv

Ilustrimi v: Trendët rurale dhe urbane të varfërisë	iv
Ilustrimi vi: Diagrami i Venit i varfërisë me të hyra dhe pa të hyra.....	v
Ilustrimi vii: Raporti në mes të zhvillimit dhe uljes së Varfërisë	viii
Ilustrimi 1.1: Shkalla e punësisë dhe papunësisë, 2001-2005	5
Ilustrimi 1.2: Papunësia e regjistruar dhe niveli i rritjes së BPV-së.....	5
Ilustrimi 1.3: Pronësia e pasurive dhe nivelet e të hyrave duke përdorur të dhënat e ABEF	7
Ilustrimi 2.1: Varfëria absolute dhe e skajshme për 2003/04 dhe 2005/06	11
Ilustrimi 2.2: Shpërndarja e konsumit, 2003/04 dhe 2005/06	122
Ilustrimi 2.3: Lakoret e rritjes për zhvillimin nga 2003/4 deri në 2005/06	133
Ilustrimi 2.4: Lakoret e Lorencit për vitet 2003/04 dhe 2005/06	155
Ilustrimi 2.5: Neto shkalla e regjistrimit në arsim	166
Ilustrimi 2.6: Qasja në ujë	177
Ilustrimi 2.7: Diagrami i Venit i varfërisë që nuk bazohet dhe asaj të bazuar në të hyra.....	18
Ilustrimi 3.1: Shkalla e varfërisë sipas madhësisë së ekonomisë familjare	2020
Ilustrimi 3.2: Trendët rurale dhe urbane të varfërisë.....	24
Ilustrimi 3.3: Qasja e zonave rurale në shërbime.....	25
Ilustrimi 3.4: Shkalla neto e regjistrimit në arsim.....	2525
Ilustrimi 4.1: Përfitimet e llogaritura vjetore për familje përfituese.....	32
Ilustrimi 4.2: Shpenzimet e mbrojtjes sociale, vende të zgjedhura: 2004	33
Ilustrimi 4.3: Efektshmëria e objektivave të programit për ndihmë sociale të Kosovës.....	35
Ilustrimi 4.4: Paratë e dërguara nga diaspora si pjesë e BPV-së në Ballkanin Perëndimor	3837
Ilustrimi 4.5: Shkalla e regjistrimit për ekonomitë familjare me emigrantë dhe pa emigrantë	3939
Ilustrimi C.1: Lakoret e rritjes së manifestimit të varfërisë	7573
Ilustrimi D.1: Mbulimi jo i plotë dhe humbja e ndihmës sociale sipas rajoneve urbane dhe rurale	74
Ilustrimi D.2: Top 20 vendet marrëse të parave të dërguara si pjesë të BPV-së, 2004	7674
Ilustrimi D.3: Bashkërendimi i bazës së prirjes për emigrim.....	8179
Ilustrimi D.4: Bazat e prirjes dhe shpeshësia e saj për grupet e trajtuara (ekonomitë familjare me migruer) dhe grupet e patrajtuara	8280

VËLLIMI II

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI 1: ANKETA E BUXHETIT TË EKONOMIVE FAMILJARE (ABEF) DHE MONITORIMI I VARFËRISË NË KOSOVË	6
A. Ekzistojnë probleme në krahasimin e të dhënave	7
(a) Problemi nr. 1: Ditari në raport me kujtesën	7
(b) Problemi nr. 2: Dizajni i anketës – Ridefinimi i artikujve të konsumuar	7
(c) Problemi nr. 3: Dizajni i anketës - AVSJ në raport me ABEF	8
B. Mostrat e vlerësimit e shtojnë pasigurinë	8
C. Pasojat e mundshme: Konsumi	9
D. Pasojat e mundshme: Vlerësimet e varfërisë	11
Kapitulli 2: Varfëria – Vlerësimet alternative	13
A. Gjendja pas stratifikimit	15
B. Krahasoni vetëm vitin 2003 dhe 2005	17
C. Metodologjia e konsumit të përgjithshëm të krahasueshëm	18
D. Krahasoni të gjitha vitet	20
E. Krahasimi i shifrave të varfërisë nga AVSJ dhe ABEF	21
Kapitulli 3: PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	23
A. Rekomandimet	23
Shtojca A: TABELAT DHE ILUSTRIMET	25
Shtojca B: REZULTAT E ANKETIMEVE TË VITEVE TË NDRYSHME	31

Lista e tabelave

Tabela 1.1: Popullsia sipas valës së anketimit dhe sipas vitit	9
Tabela 1.2: Përmbledhje e kufizimeve të anketave dhe ndikimi i tyre në vlerësimet e varfërisë	10
Tabela 1.3: Vlerësimi i varfërisë për banorë sipas lokalitetit dhe zonave etnike, përmes metodologjisë PA05	12
Tabela 1.4: Vlerësimi i varfërisë për banorë sipas përkatësisë etnike të kryefamiljarit	12
Tabela 2.1: Pasqyrë e përgjithshme e rezultateve të metodologjive për vlerësimet e krahasueshme të varfërisë	15
Tabela 2.2: Përmbledhje e vlerësimeve të varfërisë sipas metodologjisë së përdorur	15
Tabela 2.3: Shkalla e varfërisë me vlerësimet dhe rivlerësimet e tanishme	16
Tabela 2.4: Mostra e procedurës për anketën mbi buxhetin e ekonomive familjare në Bosnjë dhe Hercegovinë	17
Tabela 2.5: Shkalla e varfërisë me metodologjinë PA05 dhe metodologjitë e krahasueshme CA	18
Tabela 2.6: Kufijtë e rreptë të varfërisë bazuar në artikujt e zakonshëm ushqimorë	19
Tabela 2.7: Shkalla e varfërisë sipas metodologjisë së shkurtër përmbledhëse për konsum	19
Tabela A.1: Krahasimi i metodologjive të mëhershme	25
Tabela A.2: Krahasimi i anketave	27
Tabela A.3: Përqindja e ndryshimeve në totalet kryesore në bazë të	

krahasimi nga një anketë në tjetrën	28
Tabela A.4: Përkufizimet alternative të konsumit të përgjithshëm dhe shkalla e varfërisë	28
Tabela A.5: Pyetjet që bëhen vazhdimisht rreth katër anketimeve	29
Tabela A.6: Përkufizimi i konsumit të përgjithshëm sipas metodologjive të ndryshme	30
Tabela A.7: Kufiri i varfërisë në metodologjitë e ndryshme	30
Tabela B.1: Prezantimi i pyetësorëve të ri	31
Tabela B.2: Statistikat e varfërisë duke përdorur metodologjinë PA05	31
Tabela B.3: Shkalla e varfërisë sipas metodologjisë PA05	32
Tabela B.4: Simptomat e hollësishme të varfërisë me konsum të përgjithshëm të reviduar	32
Tabela B.5: Shkalla e varfërisë sipas metodologjive të konsumit alternativ dhe të kufirit të varfërisë	33

Lista e rubrikave

Rubrika 2.1: ABEF në Bosnjë dhe Hercegovinë: Shembull i mbledhjes së mostrave pa pasur regjistrim të popullsisë	17
Rubrika 2.2: Analiza e ndryshimeve	20

Lista e ilustrimeve

Ilustrimi 1.1: Popullsia e përgjithshme në milionë dhe madhësia e familjeve	8
Ilustrimi 1.2: Konsumi mesatar mujor i familjeve, në çmime nominale	9
Ilustrimi 1.3: Vlerësimet e shkallës së varfërisë dhe ndikimi i ndryshimeve në pyetësor	11
Ilustrimi 2.1: Shpërndarja e kumulative dhe densiteti i konsumit për 50 përqindëshin më të ulët të popullsisë	16


PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Rreth 45 për qind e popullsisë në Kosovë është e varfër, më një pjesë tjetër prej 18 për qind të rrezikuar nga varfëria. Mbizotërimi i niveleve të varfërisë në pjesën e parë të kësaj dekade nuk është për tu çuditur duke marrë parasysh kontekstin e kushteve ekzistuese makroekonomike që karakterizohen me zhvillim të ngadalshëm, me të hyra të ulëta dhe me kufizime të shumta të shpenzimeve. Pa sigurinë që e ofrojnë emigrantët dhe paratë nga diaspora, mirëqenia e një pjese të madhe të popullsisë do të ishte shumë më e keqe. Megjithatë, është gjë pozitive fakti se varfëria është e ‘butë’ sepse shumë njerëz janë ose pak mbi kufirin e varfërisë apo pak nën të. Niveli i varfërisë së ‘butë’ nënkupton se një ndryshim i vogël pozitiv në të hyra, përmes zhvillimit që krijon vende të punës, mund të nxjerr shumë persona nga varfëria.

Standardet e jetesës kanë ngecur

2. Ngecja e përgjithshme ekonomike pasqyrohet në mungesën e progresit për sa i përket përmirësimit të standardeve jetësore. Vlerësohet se rreth 15 për qind e popullsisë jeton në varfëri të skajshme, do të thotë janë njerëz që e kanë të vështirë të plotësojnë nevojat e tyre themelore për ushqim. (Ilustrimi i.). Rreth 45 për qind (që është pak mbi 2 në 5 kosovarë) raportojnë një nivel të konsumit nën kufirin e varfërisë, e cila sipas çmimeve të vitit 2002 është caktuar të jetë baras me 43 euro për një person të rritur në muaj. Këto nivele të varfërisë janë shumë të larta në krahasim me vendet fqinje dhe ndryshe nga shumë vende të rajonit, nuk kanë pësuar ndryshime për shumë kohë.

Ilustrimi i: Nivelet absolute dhe ekstreme të varfërisë



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.


3. Vetëm njëzet për qind e popullsisë në gjendje më të mirë kanë pasur një zhvillim të vogël pozitiv në konsum, mes të viteve 2003 dhe 2005, përderisa pjesa tjetër ka pasur zhvillim negativ. Sa i përket grupeve më të varfra, humbjet kanë qenë të konsiderueshme. Pesë përqindëshi më i varfër i popullsisë ka pësuar rënie në konsum prej rreth 10 për qind. Duke shikuar ndryshimet në konsum për rajonet urbane dhe rurale veç e veç, shihet se shkalla e konsumit ka rënë pothuaj për tërë popullsinë rurale, përderisa në rajonet urbane vetëm pesë përqindëshi i fundit i popullsisë ka raportuar rënie të konsumit.

4. Përveç varfërisë së mbetur në këtë nivel, një pjesë e madhe e popullsisë rrezikohet nga varfëria. Një tronditje që zvogëlon të hyrat për 25 për qind mund të shtyjë një numër prej 18 për qind shtesë të popullsisë nën kufirin e varfërisë. Një rritje e ngjashme pozitive në të hyrat e popullsisë mund të largojë shumë njerëz nga varfëria. Kjo pasqyron fenomenin se përderisa varfëria është mjaft e përhapur, ajo është e 'butë' në kuptimin se një pjesë e madhe e popullsisë është afër kufirit të varfërisë. Rreth 40 për qind e grupeve të rrezikuara vlerësohet se jetojnë në Prishtinë dhe Prizren.

Rubrika 1.1: A është rritur shkalla e varfërisë në Kosovë? JO

Ky raport është paraprirë nga dy vlerësime të tjera të varfërisë në Kosovë (Banka Botërore 2001, 2005a). Raporti i vitit 2001 përdori Anketimin për Matjen e Standardit Jetësor (AMSJ) të Kosovës dhe ka vlerësuar se pjesa e popullsisë që gjendet nën kufirin e varfërisë është rreth 50 për qind. Raporti i vitit 2005 ka përdorur anketën e buxhetit të ekonomive familjare të kryer gjatë viteve 2002/03 dhe ka vlerësuar nivelin e varfërisë të jetë rreth 37 për qind. Në këtë raport, ne vlerësojmë nivelin e varfërisë të jetë rreth 45 për qind. A do të thotë kjo se varfëria është rritur? Përgjigja është JO. Siç është sqaruar në vëllimin II të këtij raporti, këto tri grupe të të dhënave nuk janë të krahasueshme. Veçanërisht, edhe pse raporti i vitit 2005 dhe ky i fundit përdorin anketat e ABEF-it, ndryshimet në atë se si (a) u është kërkuar ekonomive familjare të kujtojnë periudhën e konsumit të artikullit të raportuar të blerë (ditor, javor etj.), dhe (b) konsumi i mallrave të prodhuara nga vet familjet, e bën vitin 2002/03 dhe anketimet e mëpastajme të ABEF-it të pakrahasueshme. Një pikë shtesë është që Kosova duket të jetë e veçuar në rajon sa i përket pjesës së popullsisë nën kufirin e varfërisë. Kjo nuk është për tu çuditur duke marrë parasysh se BPV për kokë banori është gati sa gjysma e mesatares regjionale.

Ilustrimi ii: Llogaritja e varfërisë sipas banorëve në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Vlerësimi përkatës i varfërisë nga Banka Botërore


5. **Përfundimisht, pabarazia – edhe pse e ulët – tregon shenja të rritjes, veçanërisht në zonat rurale.** Në përgjithësi, pabarazia në Kosovë është e ultë. Shkalla më e shpeshtë e raportuar e pabarazisë (indeksi Gini) është rreth 30 për qind në vitin 2005. Në vitin 2003, indeksi i njëjtë ka qenë 27 për qind. Siç është pritur, pabarazia urbane është më e lartë se sa ajo e konstatuar në zonat rurale. Megjithatë, me kalimin e

kohës, pabarazia urbane ka mbetur e pandryshuar në 31 për qind, përderisa pabarazia rurale është rritur nga 25 në 28 për qind. Përmasat e tjera të pabarazisë gjithashtu konfirmojnë pabarazi përgjithësisht të ulët por që është në rritje. Për shembull, dallimi në mes të grupeve më të pasura dhe atyre më të varfra është rritur gjatë kësaj periudhe. Pabarazia në rritje në rajonet rurale shpjegon rritjen e konstatuar të pabarazisë e përgjithshme. Por në zonat rurale, paratë e dërguara nga diaspora duket se e përcaktojnë rritjen e pabarazisë, pasi që ekonomitë familjare që janë në kushte më të mira është vërejtur se marrin kryesisht më shumë para nga diaspora.

Të varfrit kryesisht janë ata që jetojnë në familje të mëdha, të papunësuarit dhe ata me kualifikim më të ulët

6. **Familjet që janë më të mëdha janë mesatarisht më të varfra.** Numri i rasteve të varfërisë në familjet që kanë më tepër se 7 anëtarë të familjes është të paktën për 7 pikë të përqindjes më i lartë se sa në familjet që kanë 1 deri 3 anëtarë (Ilustrimi iii). Përveç madhësisë së ekonomisë familjare, edhe përbërja e saj paraqet një barrë shtesë në përmirësimin e mirëqenies. Në familjet që kanë më tepër anëtarë që varen nga të tjerët se sa të rritur që punojnë ka një manifestim më të madh të varfërisë krahasuar me familjet që kanë më shumë të rritur që punojnë se sa anëtarë që varen nga ta.

Ilustrimi iii: Nivelet e varfërisë sipas madhësisë së ekonomisë familjare



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF.


7. **Në ekonomitë familjare me kryefamiljare manifestohet më shpesh varfëria.** Manifestimi i varfërisë vlerësohet të jetë për 4 për qind më i lartë për ekonomitë familjare me kryefamiljare krahasuar me ato që kanë kryefamiljarë. Megjithatë, me kalimin e kohës, ky dallim nuk është rritur, çka sugjeron se përkundër situatës së vështirë makroekonomike, ekonomitë familjare me kryefamiljare nuk janë dobësuar. Numri i rasteve të varfërisë për familjet me kryefamiljarë serbë është rritur me kalimin e kohës, edhe pse çështja e cilësisë së të dhënave, e cila duket të jetë më serioze këtu se sa në rastet tjera të përgjithshme, lë të kuptohet se përmasa e përkeqësimit të gjendjes në këto trende duhet të trajtohet me kujdes.

8. **Rreziku nga varfëria është po ashtu më i lartë për të papunësuarit.** Jo të gjithë personat e papunë jetojnë në ekonomi të varfra familjare dhe jo të gjithë të punësuarit i kanë ikur varfërisë. Dëshmitë nga anketat sugjerojnë se rreth 70 për qind e të varfërve janë ose të punësuar ose joaktivë. Megjithatë, një krahasim në mes të rasteve të varfërisë së të punësuarve dhe të papunësuarve tregon se këta të fundit ballafaqohen me një rrezik prej 20 për qind më të madh se sa të parët (Ilustrimi iv). Me fjalë të tjera, përderisa të varfrit që punojnë përbëjnë grupin më të madh në mesin e gjithë të varfërve,

gjasat (gjegjësisht numri i rasteve) për të qenë i varfër janë më të mëdha nëse dikush është i papunë sesa nëse është i punësuar. Shumica e të varfërve të punësuar janë punëtorë “me mëditje” dhe punëtorë të sektorit të minierave.

9. **Siç edhe pritet, numri i rasteve të paraqitura të varfërisë bie sa më e lartë që të jetë përgatitja arsimore e kryefamiljarit.** Numri i rasteve të varfërisë për kryefamiljarët me arsimim të lartë është 20 për qind, por 1 në 2 kryefamiljarë me arsimim fillor është vlerësuar se jeton në varfëri. Tek ata që janë më të arsimuar ka manifestim më të ultë të varfërisë sepse personat e tillë kanë perspektiva më të mira të punësimit dhe pagesë më të mirë. Raportohet se 70 për qind e personave me arsimim të lartë dhe profesional janë të punësuar me pagë, krahasuar me 25 për qind të atyre që kanë arsimim të mesëm.

Ilustrimi iv: Niveli i varfërisë sipas statusit të fuqisë punëtore




Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

Të varfrit kryesisht jetojnë në zonat rurale dhe në Mitrovicë e Ferizaj

10. **Shumica e të varfërve jetojnë në zonat rurale.** Në vitin 2003, si banorët e zonave rurale, ashtu edhe ata të zonave urbane kishin gjasa të njëjta që të mbesin në varfëri, rreth 42 për qind. Megjithatë, deri në vitin 2005, varfëria urbane ka rënë për rreth 5 për qind ndërsa ajo rurale është rritur për gati po aq (Ilustrimi v), kështu që më tepër se dy të tretat e të gjithë të varfërve tani jetojnë në zonat rurale. Varfëria në zonat rurale është e lidhur ngushtë me mungesën e tokës, bagëtisë dhe të pajisjeve bujqësore.

11. **Manifestimi i rasteve të varfërisë ndryshon shumë varësisht nga rajoni.** Në vitin 2003, Mitrovica, Ferizaj, Gjakova dhe Prizreni kanë pasur manifestim të lartë të varfërisë krahasuar me shkallën e përgjithshme të varfërisë në mbarë Kosovën. Deri në vitin 2005, vetëm Mitrovica dhe Ferizaj janë dalluar në këtë aspekt. Prishtina, bashkë me Gjilanin, kanë pasur një nga nivelet më të ulëta të varfërisë në vitin 2003. Megjithatë, edhe pse kjo është përkeqësuar në vitin 2005, prapë

Ilustrimi v: Trendët rurale dhe urbane të varfërisë



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF.

ka qenë më e ulët se sa mesatarja në Kosovë. Gjithashtu, përderisa Prishtina ka shkallën më të ulët të manifestimit të varfërisë në nivel të Kosovës, ajo klasifikohet si kontribuuesi më i madh i varfërisë. Në të vërtetë, 3 nga 5 persona të varfër jetojnë në vetëm tri rajone – Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë.


Dimensionet e mirëqenies që nuk bazohen në të hyra tregojnë rezultate më të mira, por janë të ngulfatura nga pabarazitë në qasje dhe nga cilësia ulët e shërbimeve kryesore publike

12. Përfundimisht, përderisa dimensionet jo te bazuara në të hyra tregojnë rezultate më të mira, ato vuajnë nga pabarazitë e dukshme dhe nga cilësia e dobët. Thënë pak më qartë, ka dallime të dukshme për sa i përket qasjes në arsimin e mesëm dhe atë të lartë në mes të familjeve më të pasura dhe atyre më të varfra. Veç kësaj, familjet rurale kanë më pak qasje në ngrohjen qendrore dhe në ujë të pijshëm në krahasim me familjet urbane. Për më tej, si cilësia i ujit ashtu dhe ajo e shërbimeve shëndetësore janë më të dobëta në zonat rurale.

13. Madje, një pjesë e madhe e popullsisë raporton të jetë e privuar në dimensione të shumëfishta. Për shembull, rreth 8 për qind janë materialisht të varfër dhe nuk kanë qasje në ujë brenda në shtëpitë e tyre si dhe kushte higjienike-sanitare. Një numër gati i njëjtë, 9 për qind, janë të varfër dhe nuk kanë lidhje telefonike ose nuk kanë banjë në shtëpitë e tyre (Ilustrimi vi). Këto nivele janë shumë më të larta se në Rumani (ose në Gjeorgji dhe Rusi) ku vetëm 1 për qind e popullsisë është raportuar të jenë të privuar në dimensione të shumëfishta.


Ilustrimi vi: Diagrami Venit i varfërisë me të hyra dhe pa të hyra

A. Uji, kushtet higjienike – sanitare dhe varfëria



A: Qasja në ujë brenda shtëpisë
 B: Kushtet higjienike-sanitare: banjë
 C: Ekonomitë familjare të varfra

B. Telefoni, banimi dhe varfëria e njerëzve që kanë të hyra



A: Lidhja telefonike
 B: Banjë në dispozicion
 C: EF të varfra

14. Ky profil i shkurtër i njerëzve të varfërve tregon se një grup i ndryshëm i ekonomive familjare është ballafaquar me vështirësi gjatë periudhës në shqyrtim. Një shtrirje e tillë varfërisë nuk është për tu çuditur në kontekstin e kushteve ekzistuese makroekonomike.

Kushtet makroekonomike nuk kanë mundësuar ulje të madhe të varfërisë

15. **Kushtet aktuale makroekonomike nuk sigurojnë perspektiva për përmirësimin e standardeve jetësore.** Zhvillimi ekonomik pati një hov në periudhën menjëherë pas konfliktit të armatosur, që u mbështet nga hyrja e burimeve të mëdha për rindërtim. Që nga atëherë, dhe posaçërisht në 4 vitet e fundit, zhvillimi ka ngecur. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak se prodhimi industrial ende nuk është rimëkëmbur dhe bujqësia, e cila kontribuon në BPV me një pjesë të madhe dhe nga e cila shumica e popullsisë fiton për jetesë, mbetet një aktivitet me prodhimtari të ulët. Bujqësia që është mjet jetese, ballafaqohet me shpenzime të larta për lëndën e parë dhe me infrastrukturë të dobët, si dhe operon sipas të drejtave pronësore të cilat janë shumë të paqarta. Si pasojë, rendimentet dhe sipërfaqja në ari nuk është përmirësuar, e as prodhimtaria nuk ka shënuar rritje.

16. **Ky ambient ka rezultuar në kushte të dobëta të tregut të punës.** Rreth 30 për qind të fuqisë punëtore është vlerësuar të jetë e papunë, ndërsa për të rinjtë kushtet janë edhe më të vështira. Kushtet e dobëta ekzistuese të tregut të punës, pa dyshim, pjesërisht shpjegojnë atë çka dyshohet të jetë një shtim i aktiviteteve joformale, dhe ndoshta edhe rritje e nivelit të papunësisë. Veç kësaj, koha sa njerëzit rrinë papunë është e gjatë, dhe rrogat kanë mbetur të pandryshuara në 4 vitet e fundit (tabela 1.4).

Programet e ndihmës sociale janë joadekuate

17. Një nga pasojat e kushteve të vështira makroekonomike është vështirësia e balancimit të nevojave të mëdha për investime dhe prioritetet sociale, posaçërisht duke marrë parasysh rregullin fiskal kufizues dhe konzervatizmin. Kjo e ka bërë të vështirë mbrojtjen e shumë personave të varfër përmes mbështetjes publike. Në formën e tyre aktuale, programet e ndihmës sociale në Kosovë karakterizohen nga një tipar i dëshirueshëm, që është se përfitimet nga ky program, që ka për qëllim të ndihmojë të varfrit, i gëzojnë të varfrit. Përkundër këtij tipari të mirë ekzistojnë tri dobësi.

18. Së pari, programet nuk i mbulojnë të gjithë të varfrit, pjesërisht për shkak të hapësirës së kufizuar fiskale. Në mënyrë specifike, mbi 75 për qind e të varfërve nuk përfshihen në programet e ndihmës sociale. Së dyti, vlera e përfitimit për ekonomitë familjare që marrin këto ndihma ka mbetur e njëjtë në mes të viteve 2002 dhe 2005. Kjo është e kuptueshme duke marrë parasysh kushtet e vështira fiskale. Madje, duke marrë parasysh se edhe inflacioni i përgjithshëm ka qenë i ultë ose negativ, me siguri nuk ka pasur ndonjë rënie në vlerën reale të përfitimeve. Dobësia e tretë dhe fundit, mbulimi i dobët dhe niveli i ulët i përfitimeve së bashku kanë treguar se programet kanë pasur ndikim të vogël në përmirësimin e mirëqenies së popullsisë.

...por migrimi dhe paratë e dërguara nga diaspora kanë qenë mekanizma efikas për reduktimin e varfërisë.

19. Aktualisht, rreth 1 në 5 kosovarë kanë raportuar të kenë të paktën një anëtar të familjes i cili është emigrant. Po aq kanë raportuar të kenë pranuar para nga diaspora. Sa për krahasim vetëm 13 për qind e popullsisë përfitojnë ndihmën sociale, që është drejtuar vetëm për grupet më të varfra. Ato familje që kanë emigrantë gjithashtu raportojnë nivel më të lartë të konsumit dhe është vlerësuar se janë më pak të varfra. Dëshmitë nga anketat e ekonomive familjare tregojnë se ata që kanë 10% prirje më të madhe për emigrim raportojnë 2 për qind më shumë konsum. Një krahasim i ekonomive familjare me emigrantë jashtë vendit dhe atyre me karakteristika të ngjashme, por pa emigrantë, tregon se këta të fundit paraqesin rreth 25 % të shpenzimit të përgjithshëm të atyre që janë në kufi të varfërisë së skajshme. Manifestimi i varfërisë në mesin e familjeve me emigrantë gjithashtu është më e vogël, për rreth 7 për qind krahasuar me popullsinë e përgjithshme. Niveli më i lartë i konsumit dhe shkalla më e ulët e manifestimit të varfërisë për ekonomitë familjare me emigrantë janë edhe më të theksuara në zonat rurale. Për shembull, paraqitja e varfërisë për ekonomitë familjare me emigrantë është rreth 20 për qind më e ulët se te ekonomitë familjare të ngjashme në zonat rurale që nuk kanë emigrantë.

20. Të gjitha këto rezultate së bashku tregojnë se pa emigrim, manifestimi i varfërisë do të ishte më i lartë dhe më i koncentruar në zonat rurale. ***Prandaj, çfarëdo përpjekjeje për zvogëlimin drastik të formave aktuale të emigrimit mund të përkeqësojë mirëqenien e popullsisë së Kosovës, duke keqësuar pabarazitë tashmë të shfaqura në mes mirëqenies në zonat rurale dhe urbane, dhe ndoshta do të çojë në destabilizim, veçanërisht në zonat rurale.***


Shikimi drejt së ardhmes

21. Në pajtim me aspiratat evropiane, objektivat zhvillimore të Kosovës synojnë të krijojnë një shoqëri gjithëpërfshirëse me standarde më të mira të jetës. Kjo nënkupton përparim në një varg fushash, si qeverisja demokratike, decentralizimi efektiv dhe strategji gjithëpërfshirëse sektoriale. Megjithatë kjo nuk do të jetë e lehtë sepse Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida me të cilat ballafaqohen të gjitha shtetet e dobëta: me mungesë të madhe të investimeve për plotësimin e nevojave dhe me burime të kufizuara të qeverisë për të përmbushur ato, marrëdhënie të ndara shoqërore dhe me nivel të dobët të sigurisë. Do të jetë e nevojshme që të caktohen veprimet me prioritet që do të sillnin përmirësime të shpejta të mirëqenies së popullsisë me qëllim të forcimit të kohezionit social dhe të sigurimit të paqes së qëndrueshme. Përderisa e gjithë kjo është pjesë e negociatave për statusin përfundimtar, analizat në këtë raport theksojnë katër aspekte me të cilat mund të përmirësohet mirëqenia.

22. **Fillimisht, është shumë me rëndësi që të bëhet një zhvillim i madh dhe i qëndrueshëm.** Siç është theksuar më lartë, varfëria është e mjaft e përhapur dhe një numër shumë i madh të njerëzve preken edhe nga tronditjet e vogla. Kur një pjesë e

madhe e popullsisë jeton në kufi të varfërisë dhe pabarazia është e ulët, natyrisht që është e kuptueshme se ndjeshmëria e varfërisë ndaj zhvillimit (elasticiteti i zhvillimit të varfërisë) është shumë i lartë. Në Ballkanin perëndimor, Shqipëria paraqet shembullin më të qartë se si zhvillimi i madh dhe i qëndrueshëm mund të zvogëlojë varfërinë në shkallë të madhe. Në fillim të vitit 2000, rreth një e katërta e popullsisë së Shqipërisë ishte e varfër, dhe niveli i pabarazisë ishte i ulët. Megjithatë, me një nivel të zhvillimit vjetor prej 6 për qind në mes të viteve 2002 dhe 2005, varfëria ka rënë nga 25 për qind sa ishte në vitin 2002, në rreth 18.5 për qind në vitin 2005, duke nënkuptuar një elasticitet mes zhvillimit dhe varfërisë prej -1.5. Përveç Shqipërisë, shumë vende të tjera të botës me kushte jetësore të ngjashme me ato në Kosovë – varfëria e përhapur por jo e thellë dhe pabarazia e ulët, kanë mundur që të mundësojnë një zhvillim të lartë dhe gjithëpërfshirës. (Ilustrimi vii paraqet disa prej të këtyre vendeve). Për të mundësuar zhvillimin e perspektivave Kosovës për reduktimin e varfërisë, vëreni se 5 për qind e zhvillimit të BPV-së gjatë 5 viteve të ardhshme, e kombinuar me elasticitetin mes zhvillimit dhe varfërisë ngjashëm me atë të Shqipërisë, do të thotë ulje të varfërisë prej 38 për qind, ose rënie e varfërisë absolute nga 45 në 28 për qind. Me një nivel të tillë të zhvillimit dhe me një elasticitet të tillë mes zhvillimit dhe varfërisë për vendet e BSHP-së me të hyra te mesme prej -3.1, varfëria do të binte për 75 për qind ose nga 45 në 11 për qind në këto 5 vite.

Ilustrimi vii: Raporti në mes të zhvillimit dhe uljes së Varfërisë



Burimi: Personeli i Bankës Botërore nga baza e të dhënave ECAPOV e Bankës Botërore

23. Përderisa zhvillimi është vendimtar, ai e ndryshon gjendjen në lidhje me zvogëlimin e varfërisë vetëm nëse është gjithëpërfshirës. Pyetja logjike do të ishte se cili

është burimi i një zhvillimi të tillë. Përderisa analiza të tilla janë jashtë fushëveprimit të këtij raporti, një përvojë e zakonshme e shumë vendeve, të cilat kanë pasur ulje të mëdha të nivelit të varfërisë përmes zhvillimit, ka qenë zbatimi i strategjive që do të çonin në **një zhvillim që do të krijonte shumë vende të reja të punës**. Në rastin e Kosovës sektorët vendimtarë ku mund të pritet një punësim i madh dhe i favorshëm që do të ndikonte në uljen e varfërisë përfshijnë transportin dhe telekomunikacionin, infrastrukturën, ndërtimtarinë, shërbimet dhe përmirësimin e klimës investuese për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, posaçërisht duke bërë të mundur një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike. Një zhvillim i tillë gjithëpërfshirës është vendimtar sepse paraqitet në këtë raport tregojnë se politikat të cilat krijojnë vende të punës janë shumë të lidhura me zvogëlimin e varfërisë. Për shembull një ulje e papunësisë ekzistuese prej 10 për qind është e lidhur me uljen e varfërisë prej 6 për qind. Duke marrë parasysh se shumica e të varfërve janë të varfër aktivë, një zhvillim i tillë do të siguronte përfitim të dyfishta në mirëqenie po qe se mund të krijojë vende të punës dhe të përmirësojë pagat.

24. Gjithashtu do të ishte vendimtare që të përmirësohet **infrastruktura dhe shërbimet urbane**. Një veprim i tillë pranon që rajonet urbane janë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Në fakt, dëshmitë e lëvizjeve të emigrantëve të brendshëm tregojnë se të varfrit kanë filluar të lëvizin në rajonet urbane me qëllim që të gjejnë mundësi më të mira. Rajonet urbane janë në kushte pak më të mira, pavarësisht faktit se shuma më të mëdha parash të diasporës dërgohen në zona rurale. Përveç heqjes së arsyeve për emigrim jashtë vendit, përtëritja urbane gjithashtu do të shkojë paralelisht me zgjidhjen e disa problemeve të vështira në zhvillimin rural. Posaçërisht, lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale në ato urbane mund të zvogëlonin fragmentimin e mëtejshëm të tokës, të përmirësonin prodhimtarinë bujqësore dhe mirëqenien rurale.

25. Zhvillimi i qëndrueshëm duhet të përkrahët nga një fuqi punëtore e arsimuar mirë, që mund të përshtatet dhe që është e shëndetshme. Dëshmitë tregojnë se qasja në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë është mjaft e lartë. Pothuaj 9 nga 10 fëmijë të moshës së arsimit fillor dhe rreth 3 nga 4 fëmijë të moshës së arsimit të mesëm janë të regjistruar në shkollë. Megjithatë, këto rezultate fshehin tri pengesa potenciale për krijimin e një popullsie të arsimuar mirë. Një problem është prania e dallimeve të mëdha në nivelet e regjistrimit, posaçërisht në arsimin e mesëm dhe atë të lartë në mes të ekonomive familjare më të varfra dhe më të pasura nga njëra anë dhe të atyre urbane dhe rurale në tjetrën. Pengesa tjetër është se vlerat tradicionale të cilat pengojnë arsimimin e femrave janë ende mjaft të përhapura në zonat rurale. Si rezultat i kësaj, vërehet se niveli i regjistrimit të vajzave në arsimin e mesëm në zonat rurale është 20 për qind më e ulët se sa ai i djemve të moshës së shkollimit të mesëm. Problemi i fundit është besimi i përgjithshëm se përderisa shkalla e regjistrimit mund të jetë të lartë në masë të arsyeshme, cilësia e shkollimit në përgjithësi është e dobët. Si pasojë, rezultatet e mësimit për shumë fëmijë janë shpesh të ulëta kështu që ata e braktisin shkollimin. Pasqyrime të thjeshta në këtë raport tregojnë se sa më të arsimuar të jenë njerëzit, varfëria është më e vogël. Prandaj një përmirësim i përgjithshëm i cilësisë së arsimimit dhe qasja në arsimin e mesëm dhe atë të lartë, posaçërisht për vajzat e varfra dhe rurale, do të duhej të konsiderohej si strategji afatgjatë për mbështetjen e një niveli më të lartë të zhvillimit.

26. **Së dyti, në të ardhmen e afërt, ruajtja e këtij niveli të emigracionit është vendimtare për mbrojtjen e kushteve jetësore dhe stabilitetit.** Arsyeja kryesore për këtë argument është se një zhvillim i madh, i qëndrueshëm dhe i shpërndarë – që d.m.th. zhvillim që sjell nivel të lartë të punësimit – që do t'i mundësonte një pjese të madhe të popullsisë që të fitojnë sa duhet për të dal nga varfëria dhe, së këndejmi, do të shërbente si strategji efektive për reduktimin e madh të varfërisë, nuk duket të jetë e mundur të arrihet në afat të shkurtër. Për shembull, për reduktimin e nivelit aktual të papunësisë përgjysmë (nga 40 në 20 për qind) në 10 vitet e ardhshme, duke supozuar një rritje vjetore të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore prej 1.9 për qind dhe rritje të elasticitetit produktiv të punësimit prej 1.6, Kosova do të kishte nevojë të kishte një zhvillim vjetor prej rreth 6 për qind. Duke marrë parasysh klimën aktuale investuese dhe nevojat për investime në infrastrukturë të nevojshme për të filluar zhvillimin e madh, një strategji e tillë duket më e mundshme të realizohet vetëm në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

27. Në krahasim me këtë, emigracioni mbetet një nga mekanizmat më efektiv për zvogëlimin e varfërisë në Kosovë. Madje, përkundër zhvillimit, ndikimi këtu është i menjëhershëm. Nevoja për mbajtjen e emigracionit si mekanizëm për mbrojtjen e nivelit të mirëqenies në periudhën afatmesme mund të kërkojë që qeveria e Kosovës të marr hapin e guximshëm të hyrjes në ndonjë marrëveshje për emigrimin e vazhdueshëm me disa shtete kryesore. Një marrëveshje e tillë mund të jetë bilaterale ose rajonale (p.sh me disa ose me të gjitha vendet e BE-së). Mund të përfshij edhe nxitjen që përfundimisht emigrantët të kthehen në shtëpi përmes mundësisë për transferimin e pensioneve dhe të drejtave të tjera (Banka Botërore 2006c).

28. Përderisa të vazhdojnë emigrimet, Kosova mund të mbështetet në paratë që dërgohen nga ky emigracion për të mbrojtur një pjesë të konsiderueshme të popullsisë nga varfëria. Por është e qartë se një strategji zhvillimore, e cila është shumë e varur nga paratë e dërguara nga diaspora nuk është as e dëshirueshme e as e qëndrueshme. Arsyet janë të shumta, por vlen të përmenden tri prej tyre. Njëra është që emigrantët ndryshojnë. Me kalimin e kohës, pasi që emigrantët vendosen në shtetet ku jetojnë, lidhjet e tyre me shtetin “amë” zbehen. Ky dobësim i “lidhjes” përshpejtohet shumë nga brezat e ardhshëm. Arsyeja tjetër është ndryshimi i politikave të shtetit mikpritës. Kjo posaçërisht vlen për Kosovën, pasi që një numër i shteteve të Bashkimit Evropian, të cilat kanë qenë mikpritëse të mëdha të emigrantëve nga Kosova, i kanë mbyllur kufijtë ose kanë kërcënuar se do ta bëjnë një gjë të tillë. Arsyeja e fundit është që paratë e dërguara nga diaspora, të cilat në thelb janë transfere private, nuk mund të jenë zëvendësime efektive për resurset vendore më të qëndrueshme për financimin e investimeve publike në infrastrukturë, në kapitalin njerëzor, në shërbimet sociale etj. Kjo do të thotë se ka nevojë, përfundimisht, që të shmanget varshmëria e madhe nga emigracioni dhe paratë e dërguara nga diaspora.

29. **Së treti, përmirësimi i objektivave të programit të ndihmës sociale do të ndihmojë përmirësimin e gjendjes, ndonëse në masë të vogël.** Programet e ndihmës sociale janë modeste sa i përket madhësisë, e cila është e kuptueshme duke marrë parasysh gjendjen fiskale. Përveç kësaj, programi i ndihmës sociale është mjaft i qëlluar: ku rreth 50 për qind e fondeve shkojnë te një e pesta e popullsisë më të varfër. Megjithatë, rreth 25 për qind e atyre që nuk janë të varfër gëzojnë këto ndihma. Nuk do të

thotë se të gjithë këta njerëz që nuk janë të varfër nuk i plotësojnë domosdo kushtet për marrjen e ndihmës, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë të popullsisë. Megjithatë, nëse këta janë me të vërtetë individ që nuk i plotësojnë kushtet, këto janë përfitime jo të mëdha. Me kalimin kohës, me lehtësimin e kufizimeve fiskale, edhe skema e ndihmës sociale gjithashtu duhet të zgjerohet me qëllim të sigurimit të mbrojtjes më të mirë.

30. Kufizimet fiskale do të lehtësohen si rezultat i zhvillimit, dhe kjo është qartazi varianti më i preferuar për zgjerimin e programeve të mbrojtjes. Por ky nuk është varianti i vetëm. Kosova është aktualisht në përgatitje të kornizës afatmesme të shpenzimeve buxhetore, e cila do të prezantohet për financim në një konferencë donatorësh më vonë gjatë këtij viti. Një pyetje logjike është nëse shtohet buxheti dhe nëse ka më tepër resurse për shpenzim në mbrojtjen sociale, cilin program duhet ta zgjerojë qeveria. Që të sqarohet një gjë e tillë, ne shikuar shkallën e zvogëlimit të varfërisë duke aplikuar tre faktorë të mundshëm: a) rritjen e pensioneve (shumica pensione bazë) për 10 euro në muaj, b) rritjen e ndihmës sociale për 5 euro në muaj për përfituesit e tanishëm, dhe c) zgjerimin e programit të ndihmës sociale për të gjithë ata që jetojnë në varfëri të skajshme dhe siguri i një mesatareje të ndihmës së tanishme për secilin përfitues të ri të ndihmës sociale. Duhet të theksohet se një politikë e ngjashme nuk është provuar për pensionet sepse gati të gjithë ata që i plotësojnë kushtet tashmë i marrin pensionet.. Rezultatet nga (Tabela i) tregojnë se zgjerimi i programit të ndihmës sociale për ata që jetojnë në varfëri të skajshme do të përgjysojë varfërinë e skajshme (nga rreth 15 në 8 për qind). Ekzistojnë dy pika të tjera për sa i përket rezultateve në Tabelën i. Njëra është se shpenzimet e vlerësuara duhet të konsiderohen kufij të ulët pasi që nuk janë përfshirë shpenzime të tjera administrative. E dyta është se ndikimi i të tri veprimeve në varfërinë absolute nuk është aq i madh. Kjo nënkupton se, përveç zgjerimit, duhet të ngrihen edhe nivelet e përfitimit për tu arritur një ndikim i madh në varfëri.

Përfundimi

31. Varfëria në Kosovë është e përhapur dhe ka mbetur e në nivel të njëjtë në gjysmën e parë të kësaj dekade. Dëshmitë tregojnë se varfëria është më e lartë në mesin e atyre që jetojnë në familje të mëdha, që kanë shumë anëtarë të papunë, si dhe që kanë nivele të ulëta të arsimimit. Të varfrit janë po ashtu gjeografikisht të përqendruar në zonat rurale dhe në disa rajone. Porosia kryesore e këtij raporti është se zhvillimi i ngadalshëm dhe i paqëndrueshëm ka pasur mangësi të dyfishta. Mangësia e parë ka qenë fakti se nuk i ka dhënë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë mundësinë që të fitojnë për të dalë nga varfëria. E dyta ka qenë se duke kufizuar bazën e të ardhurave qeveritare, është bërë e vështirë për shumë familje që të gëzojnë mbrojtje sociale adekuate ndaj ndonjë tronditjeje. Prandaj, që të përmirësohet mirëqenia në të ardhmen, raporti rekomandon një përqendrim në zhvillimin më të madh dhe më të qëndrueshëm – duke përmirësuar shërbimet urbane dhe infrastrukturën, si dhe duke ndrequr padrejtësitë për sa i përket qasjes në arsimin e mesëm dhe atë të lartë për popullsinë më të varfër – duke kaluar nga varshmëria tepër e madhe në emigracion, dhe duke përmirësuar qëllimet dhe zgjeruar programin për ndihmë sociale nëse me kalimin kohës përmirësohet baza e të hyrave të qeverisë.

Tabela i: Politikat e propozuara, kostoja dhe ndikimi i tyre në varfëri

Politikat e propozuara:	Kostoja		Niveli absolut i varfërisë		Niveli i varfërisë së skajshme	
	Numri i vër. i marrësve	Kostoja margjinale	Marrësit	E tërë Popullsia	Marrësit	E tërë popullsia
Ndihma Sociale		(Euro në muaj)	(pikë të përqindjes)		(pikë të përqindjes)	
Rritja e transfereve për 5 Euro	43 356	216 780	-0.8	-0.1	-2.3	-0.3
Shtrirja te të gjithë të varfrit e skajshëm	37 076	2 345 328	-1.6	-0.4	-34.2	-8.3
Pensionet						
Rritja e transfereve për 10 Euro	127 742	1 277 423	-3.6	-1.1	-2.1	-0.7

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF. *Shënim:* 100 për qind prirje për konsumin e supozuar jashtë të hyrave të transferim. Numri i llogaritur i përfituesve të ndihmës sociale (shtylla 20). Te pensionet janë individët.

KAPITULLI 1:

KONTEKSTI SOCIAL DHE MAKROEKONOMIK

Niveli mesatar vjetor i rritjes së BPV-së reale në mes të viteve 2002 dhe 2006 është vlerësuar të jetë më pak se 1 për qind. Burimet potenciale të zhvillimit, posaçërisht në miniera, energji dhe bujqësi, do të përfitonin në mënyrë të jashtëzakonshme nga teknologjia e re dhe moderne. Megjithatë, gjërat nga e kaluara dhe të drejtat pronësore të pasigurta vazhdojnë të pengojnë hyrjen e investimeve direkte të jashtme. Prandaj, perspektiva për ekonomi nuk duket mjaft e ndritshme në një periudhë afatmesme.

1.1 Që nga përfundimi i armiqësive në vitin 1999, Kosova ka përparuar në përmirësimin e infrastrukturës, duke siguruar shërbime publike dhe duke i vënë themelet për forcimin e institucioneve shtetërore. Në vitin 2006, kanë filluar bisedimet mbi zgjidhjen e statusit të saj. Derisa bisedimet për statusin vazhdojnë dhe kur pritet zgjidhja përfundimtare, autoritetet kosovare kanë filluar përgatitjet e një Strategjie dhe Plani Zhvillimor për Kosovën (SPZHK) me qëllim që të punohet në vizionin dhe bashkërendimin e strategjive sektoriale, duke mbuluar sektorë të tillë si ai bujqësor dhe rural, shëndetësia, arsimiti, infrastruktura, gjinia si dhe uji dhe instalimet hidrosanitare. Pasi që plani i përgjithshëm zhvillimor synon që të përmirësojë mirëqenien e popullsisë, zvogëlimi i varfërisë pritet të jetë pjesë integrale e secilës nga këto strategji sektoriale. Në strategjitë sektoriale, përqendrimi në zvogëlimin e varfërisë është vendimtar për shkak se vlerësimi i fundit i varfërisë ka treguar se varfëria në Kosovë është e shumë e përhapur dhe godet një numër disproporcional të banorëve ruralë, fëmijëve, të moshuarve, ekonomive familjare me kryefamiljare femra dhe të pakicave joserbe. Gjithashtu, rezultatet në arsim dhe shëndetësi janë të ulëta, ndërsa ekspozimi ndaj rreziqeve shëndetësore është i madh. Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfidat që janë të zakonshme për të gjitha shtetet e dobëta; mungesa të mëdha të investimeve dhe burimet e kufizuara të qeverisë për të përmbushur nevojat për investime, marrëdhëniet e brishta shoqërore si dhe nivel të brishtë të sigurisë. Për të forcuar kohezionin social dhe për të siguruar paqen e qëndrueshme, hartimi i politikave publike ka nevojë të fokusohet në zhvillimin e një strategjie për zvogëlimin e varfërisë si çështje urgjente. SPZHK-ja mund të përfitoj në mënyrë të konsiderueshme nga përfshirja e rezultateve të një vlerësimi të tillë në strategjitë e saj sektoriale.

1.2 Ky raport siguron vlerësime të trendeve të varfërisë dhe pabarazisë duke përdorur të dhënat nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare i cili aplikohet nga Enti Statistikor i Kosovës çdo vit. Ajo azhuron informatat mbi madhësinë, fushën dhe përcaktuesit e varfërisë, të cilët herën e fundit janë marrë duke përdorur të dhënat e mbledhura në vitin 2002. Në këtë kapitull paraqitet një përshkrim i shkurtër i zhvillimeve makroekonomike. Në kapitullin 2 paraqiten trendet dhe zërthimi i varfërisë. Kapitulli 3 paraqet profilin e të varfërve dhe faktorëve që e përcaktojnë rrezikun e të qenit të varfër. Në kapitullin 4 zhvillohet një diskutim rreth sistemit të mbrojtjes sociale dhe efektin e tij në rezultatet e varfërisë. Gjithashtu këtu trajtohet roli që ka emigracioni dhe paratë e dërguara nga

diaspora në mbrojtjen e familjeve nga varfëria. Kapitulli 5 përfundon me rekomandimet për monitorimin e varfërisë.

A. Rritja e BPV- së ka qenë e vogël

1.3 **Zhvillimi në kohët e fundit ka qenë i ulët, por cilësia e të dhënave është problem.** Për një periudhë të shkurtër pas përfundimit të konfliktit të armatosur, zhvillimi morri hov si rezultat i përpjekjeve masive të rindërtimit të financuara nga donatorët dhe nga diaspora kosovare. Rritja e BPV-së në vitin 2000 është vlerësuar të jetë 21 për qind, kryesisht si rezultat i ndihmave të mëdha të huaja për aktivitetet e rindërtimit, si dhe i investimeve private si reagim ndaj reformave të rëndësishme tregtare. Por rritja e BPV-së e vlerësuar reale në mes të viteve 2002 dhe 2005 ka qenë e ngadalshme dhe e paqëndrueshme. Rritja reale e BPV-së ka qenë negative në vitin 2002 dhe 2003. Kjo është pasuar nga një përmirësim pozitiv në vitin 2004 si rezultat i qëndrimit më të gjerë fiskal. Vlerësimet e reviduara e vendosin zhvillimin në vitin 2005 afër zeros (në 0.5 për qind) dhe 3 për qind rritje në vitin in 2006. Parashikohet që ky zhvillim të bie në 2.3 për qind në vitin 2007 (Tabela 1.1). Rritja mesatare e BPV-së ishte rreth 1.5 për qind në 5 vitet prej 2002 deri më 2007. Ky ekspansion është rezultat i kombinimit të investimeve të vogla dhe tërheqja e vazhdueshme e bashkësisë ndërkombëtare nga Kosova.

Tabela 1.1: Trendët makroekonomike

	2002e	2003e	2004r	2005r	2006r	Proj. 2007p
Llogaritë Kombëtare						
Rritja reale e BPV-së	-0.1	-0.5	2.5	0.5	3.3	2.3
BPV për kokë banori (në vitin 2002 në euro) /1	1,141	1,147	1,156	1,143	1,161	1,168
Investimet (në vitin 2002 në milionë)	634	594	635	627	677	772
Llogaritë e Jashtme						
Bilanci aktual i llogarive (% BPV) /2	-50.1	-41.6	-39.5	-40.7	-42.2	-40.5
Ndihma e huaj (% e BPV-së) /3	42.7	32.4	25.5	22.6	20.7	16.2
Paratë e dërguara nga punëtorët jashtë vendit (miliona euro) /4	35	125	215	262	300	342
Çmimet						
Inflacioni IÇK	3.6	1.3	-1.4	-1.4	1.5	2.0

Burimi: FMN (2007) dhe vlerësimet nga personeli i Bankës Botërore dhe FMN-së. Vlerësimet e FMN mund të rishikohen. Shënime: v = vlerësime, r = rishikim në 2007, p = projeksion. 2/ Para granteve të donatorëve. 3/ Totali i ndihmës së jashtme duke përfshirë transferet kapitale. 4/ Duke përfshirë pensionet nga jashtë.

1.4 Aktualisht, edhe FMN edhe AER-i sigurojnë vlerësime të BPV-së. Rishikime të shumta të vlerësimeve pasqyrojnë edhe pasaktësinë e të dhënave dhe dallimet metodologjike. Dallimi kryesor është nëse duhet të trajtohet UNMIK-u si një kontribuues rezident për BPV-në. Në vlerësimet e FMN-së UNMIK-u trajtohet si rezident, përderisa AER-i jep vlerësime të cilat e trajtojnë UNMIK-un edhe si rezident edhe si jorezident. Si rezultat, vlerësimet e BPV-së të cilat e trajtojnë UNMIK-un si rezident kanë qenë 21 për

qind në vitin 2002 dhe 16 për qind në vitin 2003 më tepër se vlerësimet të cilat e trajtojnë UNMIK-un si jorezident. Trajtimi i UNMIK-ut si jorezident gjithashtu sqaron nivelet e rritjes negative në vitet e hershme me reduktimin e personelit të UNMIK-ut. Problemet me njehsimin e IÇK-së e bëjnë këtë edhe më të vështirë. Tabela 1.2 tregon nivelin e dallimeve.

1.5 Ndryshimet në konsum mund të ndikohen edhe nga supozimet e bëra rreth rritjes së popullsisë dhe përshtatjet shtesë që bëhen për disa artikuj të konsumit. Për shembull, në projektimin e konsumit privat si pjesë e BPV-së, FMN-ja supozon se rritja e popullsisë është rreth 1.7 për qind në vit. Ajo po ashtu përfshinë blerjet e makinave në konsum dhe bën rregullime shtesë për rrymë dhe ushqim që janë raportuar nga anketimet e ekonomive familjare. Në këtë raport, nuk janë bërë përshtatje për shpenzime të rrymës dhe ushqimit dhe nuk janë përfshirë blerjet e makinave të cilat nuk bëhen shpesh dhe përfitimet e të cilës gëzohen për një periudhë të gjatë (Tabela A.1). Ka po ashtu dallime me vlerësimet e mëhershme të konsumit nga ESK-ja: për shembull, raporti i ESK (2006b) i vlerëson shpenzimet e ekonomive familjare se janë rritur për 5 për qind në vit sepse ai përfshinë edhe konsumin e artikujve që përdoren më gjatë ndërsa në këtë raport këto mallra nuk përfshihen pasi që konsumi i tyre vjetor nuk mund të vlerësohet

Tabela 1.2: Vlerësimet alternative të BPV-së për Kosovën

	<u>2002</u>	<u>2003</u>	<u>2004</u>
BPV me çmimet aktuale (miliona Euro)			
Duke përfshirë sektorin e Donatorëve: AER	2 589.9	2 505.0	?
Vlerësimet e FMN-së	2423.9	2414.7	2434.3
Pa sektor të Donatorëve	2 139,2	2 157,4	2 008,2
BPV për kokë banori në çmimet aktuale (Euro)			
Duke përfshirë sektorin e Donatorëve	1 363,1	1 296,4	1239,0
Vlerësime të FMN-së			1294
Pa sektorin e Donatorëve	1 125,9	1 116,5	1021,9
Niveli i shtimit real të BPV-së (%)			
Duke përfshin sektorin e Donatorëve		-5.9	+2.8
Vlerësime të FMN-së		-0.6	+4.1
Pa sektorin e Donatorëve		-1.9	+ 7.1
Ndryshimi IÇP (%)			-1.6

Burimi: Llogaritë kombëtare të Kosovës, Raport i konsulentit . Mars 2006.

B. Zhvillimi bujqësor ka qenë i ngadalshëm

1.6 **Prodhimi i ultë është sqaruar pjesërisht me zhvillimin e ngadalshëm bujqësor.** Bujqësia mbetet sektori dhe punëdhënësi kryesor në Kosovë. Në vitin 2004, është llogaritur të jetë 25 për qind e BPV-së në Kosovë, 16 për qind e vlerës së eksporteve totale dhe ndërmjet 25 dhe 35 për qind të të gjitha punësimeve, kryesisht në sektorin joformal (AMP, 2006). Përderisa pjesa e raportuar e saj në kuadër të BPV-së ka zbritur në 19 për qind në vitin 2005, kjo nuk besohet të jetë një pasqyrim i dobive të prodhimit në sektor. Dëshmitë duket se më tepër çojnë tek rimëkëmbja në sektorët e tjerë, posaçërisht në atë të shërbimeve. Zhvillimi i ngadalshëm bujqësor është pjesërisht si

rezultat i dëmeve të luftës siç janë shkatërrimi i infrastrukturës, makinerisë dhe bagëtisë, si dhe i humbjes së tregjeve tradicionale të eksportit. Si rezultat, vlerësimet e produkteve bujqësore tregojnë rritje të theksueshme në importin e ushqimit në mes të viteve 2000 dhe 2003, të cilat patën një rënie të vogël në mes të viteve 2004 dhe 2005, përderisa eksportet mes viteve 2004 dhe 2005 patën një rritje nga niveli shumë i ulët bazë.

1.7 Toka e dedikuar për prodhimtarinë bujqësore ka mbetur e njëjtë. Sipas anketës së ESK-së mbi ekonominë familjare bujqësore, shfrytëzimi i tokës bujqësore ka mbetur në të njëjtin nivel prej rreth 360,000 ha në 2004 dhe 2005. Posedimi i bagëtisë gjithashtu nuk tregon ndonjë rritje. Bujqësia në Kosovë dominohet nga drithërat (49 për qind e tokës së punueshme kultivohet me drithëra), dhe karakterizohet nga ferma të vogla (rreth 65 për qind e të gjitha fermave kanë më pak se 3 hektarë), mungesë të shërbimeve këshilluese dhe me prodhimtari të ulët, ku të gjitha e kufizojnë kontribuimin e saj në zhvillim. Sipërfaqja e shprehur në ari që kultivohet ka mbërritur kulmin në vitin 2004 (gjithashtu i vetmi vit ku BPV e vlerësuar ka qenë më e lartë sesa mesatarja për atë periudhë), por ka shënuar rënie prej rreth 14 për qind në vitin 2005 (Tabela 1.3).

Tabela 1.3: Treguesit e sektorit makroekonomik dhe të bujqësisë

	2001	2002	2003	2004	2005
Prodhimi bujqësor²					
Importet e ushqimit	283	300	330	193	
Eksportet e ushqimit	1.5	3.8	7.6	10.3	
Sipërfaqja totale bujq ³	209,058	196,883	n/a	220,506	190,479
Grurë, sipërfaqja bujq	75,070	70,000	n/a	77,783	80,127
Misër, sipërfaqja bujq	75,038	69,000	n/a	100,970	74,079
Perime, sipërfaqja bujq	28,000	28,220	n/a	14,419	14,140
Treguesit e tregut të punës¹					
Papunësia e regjistruar		282.3	282.3	302	319.7
Paratë e dërguara nga bota e jashtme		341	341	345	347
Anketa e Ekonomive Familjare Bujqësore 2004 dhe 2005^{4,5}					
Madhësia e ekonomisë familjare				7.7	7.8
Popullsia bujqësore (miliona)	1.3			1.3	1.3
Toka bujqësore (000)			291	264.9	260.1
Prodhimi mesatar (000) ⁶					
Drithërat				3.1	3.4
Perimet				16.2	12.6
Të korrat foragjere				4.5	5.8
Frutat				9.7	5.1
Numrat e bagëtimeve					
Bagëti (në mija)		347	318	351.8	335.2
Shpendët (në miliona)		2.2	3.1	2.6	2.2

Burimi: ¹ BB 2006 Strategjia e përkohshme; ² AMP Plani zhvillimor bujqësor; ³ Enti Statistikor Bujqësor - MBPZHR (totali përfshijon foragjeret dhe frutat). ⁴ Hulumtimi i familjeve që merren me bujqësi i ESK-së, 2005. Madhësia e ekonomive familjare 2004 është nga raporti i vitit 2004, në këtë mënyrë nuk është i rregulluar për ndryshimet në procedurat e matjes. ⁵ Të dhënat e hulumtimit të ekonomive familjare që merren me bujqësi për dy vitet e fundit nuk janë të krahasueshme për vitet 2001 dhe 2002 për shkak të ndryshimit në metodologji.

⁶ Prodhimet mesatare janë llogaritur duke marrë mesataren e prodhimeve të pamatura të raportuara në Tabelat 4.1


dhe 12 në Anketën e ekonomive familjare bujqësore të ESK-së, 2005. Prodhimet janë në kg/hektar, përderisa toka është në hektar

1.8 Veç kësaj, prodhimet nuk tregojnë një përmirësim gjatë dy viteve të fundit. Prodhimet bujqësore kanë rënë ose kanë mbetur relativisht të njëjta në mes të viteve 2004 dhe 2005, edhe pse duhet të theksohet se dy vite janë pak për nxjerrjen e konkludimeve, duke marrë parasysh rëndësinë e kushteve klimatike për bujqësi. Përderisa prodhimet për drithëra kanë qenë të qëndrueshme, rëniet më të mëdha kanë qenë posaçërisht të dukshme për frutat dhe perimet (Tabela 1.3). Kur i kanë pyetur bujqit pse i kanë lënë tokat pa punuar, rreth 30 për qind e tyre kanë raportuar profit të ulët ekonomik çka sugjeron edhe prodhimtari të ultë bujqësore. Nuk është për tu çuditur se prodhimi bujqësor në mënyrë dominuese është i orientuar kah ekzistenca kështu që fermat e vogla kanë raportuar se 70 për qind e prodhimeve i dedikohet nevojave familjare në vitin 2005. Edhe fermat që janë më të mëdha ende e dedikojnë mbi 50 për qind të prodhimeve të tyre për përdorim shtëpiak (ESK, 2005a). Është e rëndësishme të kihet parasysh se ka disa çrregullime në bujqësinë e Kosovës kështu që ajo që është duke dalë në shesh është e krijuar me përparësi krahasuese.


C. Funkcionim zhgënjyes i tregut të punës

1.9 **Zhvillimi i ngadalshëm ka rezultuar me funksionim të dobët të tregut të punës në dy vitet e fundit** (Ilustrimi 1.1 dhe Ilustrimi 1.2). Shkalla e përgjithshme e papunësisë është ngritur nga 40 për qind në vitin 2004 në 42 për qind në vitin 2005 (ESK, 2006). Sipas hulumtimit të fuqisë punëtore të kryer nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK, 2006, 2005b), shkalla e papunësisë te punëtorët meshkuj ka qenë 30 për qind gjatë të dy viteve dhe te punëtorët 60 për qind. Numri i të papunësuarve të regjistruar sipas regjistrave zyrtarë për regjistrimin e personave të papunë (Banka Botërore, 2006) është ngritur nga 282,000 në vitin 2002 në 319,000 në vitin 2005. Sipas grupmoshave, shkalla më e lartë e papunësisë ka qenë tek të rinjtë (15-24 vjeç) – 67% gjatë viteve 02/03 dhe 65 % gjatë viteve 04/05. Më në fund, koha që njerëzit rrinë pa punë është e gjatë - ku mbi 80 për qind e të papunëve e mbajnë një status të tillë për një vit ose edhe më tepër.

Ilustrimi 1.1: Shkalla e punësisë dhe papunësisë, 2001-2005



Ilustrimi 1.2: Papunësia e regjistruar dhe niveli i rritjes së BPV-së



Burimi: LFS 2001-2005, Llogaritjet e ESK-së. Banka Botërore 2006 Strategjia e Përkohshme.

1.10 Pagat kanë mbetur të pandryshuara gjatë kësaj periudhe. Pagat mesatare mujore të raportuara nga të punësuarit kanë mbetur të pandryshuara në mes të viteve 2002 dhe 2005. Përvoja është e njëjtë po qe se shikohen punëtorët me mëditje, profesionistët ose prodhuesit (Tabela 1.4: Pagat mujore mesatare dhe numri i vëzhgimeve).

Tabela 1.4: Pagat mujore mesatare dhe numri i vëzhgimeve

	<u>2002/03</u>	<u>2003/04</u>	<u>2004/05</u>	<u>2005/06</u>
Total	218.4	214.7	219	209.4
<i>Numri i vëzhgimeve</i>	(1184)	(1590)	(1689)	(1820)
Meshkuj	220	219.8	225.7	213.2
Femra	211.2	197.2	195.5	193.9
Punëtorët me rrogë	218.6	214.4	222.6	219.5
<i>Numri i vëzhgimeve</i>	(1124)	(1566)	(1577)	(1577)
Profesionistët	229.6	239.6	249.9	232.3
Prodhues	204.3	204.6	196.4	210.6
Të tjerë	234.6	206.9	204.3	213.1
Punëtorët me mëditje	215.5	227.6	168.1	153.5
<i>N</i>	60	24	112	243

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it. Pagat reale në çmime të vitit 2002. Pagat të definuara si paga në para të gatshme, rroga neto nga tatimet. Të përfshirë vetëm punëtorët me rrogë dhe ata me mëditje. Definicioni i mëditjeve ndryshoi në vitin 2005 për të përfshirë vetëm ato që fitohen në Kosovë dhe kategoritë e të hyrave u rritën nga 8 kategori në vitin 2002 në 13 kategori në vitin 2005.

D. Perspektivë e ulët për zvogëlimin e varfërisë


1.11 Kushtet ekzistuese makroekonomike nuk sigurojnë platformën për zvogëlim të dukshëm të varfërisë. Perspektiva për përmirësimin e zhvillimit është e pasigurt. Sipas FMN-së, baza e dobët e ekonomisë dhe largimi i vazhdueshëm i donatorëve pritet

të ngadalësojnë zhvillimin edhe për një kohë në të ardhmen. Infrastruktura e dobët dhe energjia pritet të jenë pengesat kryesore. Në aspektin pozitiv, zgjidhja e mundshme e statusit do të siguronte një sinjal pozitiv për të drejta më të qarta pronësore dhe do të përmirësonte klimën investuese.

1.12 Veç kësaj, një shikim i shpejtë në pasuritë e ekonomive familjare nuk siguron dëshmi të qartë mbi ndryshimet pozitive të mirëqenies. Proporcioni i ekonomive familjare të cilat posedojnë vetura dhe telefona mobilë është rritur gjatë kësaj periudhe (Ilustrimi 1.3). Rritja është e evidente si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane, por ka qenë më e shpejtë në zonat urbane. Një gjë tjetër që është vërejtur është që një pjesë relativisht e madhe e ekonomive familjare që raportojnë se posedojnë mallra të tilla si frigorifer, vetura, telefona mobilë dhe makina larëse, konfirmojnë edhe më tej se varfëria në Kosovë mund të jetë shumë e përhapur, por jo e thellë. Të hyrat e ekonomive familjare duket të jenë rritur në mes të viteve 2002 dhe 2005 në zonat urbane dhe zvogëluar në ato rurale¹. Këto dëshmi janë të përziera dhe jo vendimtare për sa i përket drejtimit të ndryshimeve në shkallën e varfërisë në Kosovë, pasi që një pjesë e madhe e popullsisë jeton në zonat rurale.

1.13 Si përfundim, pas një rritjeje të zhvillimit nga financimi i rindërtimeve në fazat fillestare të periudhës së pas konfliktit të armatosur, zhvillimi është ngadalësuar në mënyrë të konsiderueshme. Rimëkëmbja e industrisë është ende e pasigurt ndërsa bujqësia, ku shumica fitojnë bukën e tyre, është dominuar nga orientimi për ekzistencë. Si rezultat, perspektivat e tregut të punës për shumë familje kanë qenë të errëta. Mungesa e mundësive për të gjetur rrugën jashtë varfërisë ka çuar drejt një varfërie në shkallë të gjerë dhe stagnuese, siç edhe do ta dokumentojë kapitulli i ardhshëm

Ilustrimi 1.3: Pronësia e pasurive dhe nivelet e të hyrave duke përdorur të dhënat e ABEF



Burimi: Llogaritjet e Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it. Të dhënat e të hyrave janë reale në çmime të majit të vitit 2002. Të hyrat definohej si kesh paga neto nga tatimet, pagat në mallra dhe shërbime, të hyrat nga puna me mëditje, qira, dividendë, interes, ndihmat sociale dhe pensionet nga Kosova.

¹ Këto shifra duhet të trajtohen me kujdes për shkak të brengave për matjen e mostrave për ABEF.

KAPITULLI 2. TRENDET E VARFËRISË DHE ZBËRTHIMI

Rreth 45 për qind të popullsisë në Kosovë ka mbetur e varfër gjatë periudhës së shqyrtimit. Një pjesë shtesë prej 18 për qind ka qenë e rrezikuar nga varfëria. Për më tepër, 15 për qind e popullsisë ka qenë vlerësuar të jetë skajshmërisht e varfër. Përderisa shkalla e gjerë e varfërisë së popullsisë ka mbetur e pandryshuar, varfëria urbane ka rënë, ndërsa ajo rurale është rritur. Dëshmitë tregojnë se në zonat urbane, zhvillimi pozitiv në konsum është shumë i shpërndarë, ndërsa në ato rurale vetëm pjesa më e madhe e popullsisë ka përfituar. Si rezultat, pabarazia e matur në popullsi dhe në zonat rurale është rritur.

A. Një shënim mbi qasjen dhe cilësinë e të dhënave

2.1 Ky raport bazohet në të dhënat e hulumtimit të buxhetit të ekonomive familjare (ABEF) për shumicën e përmbajtjes së saj. ABEF-i është hulumtimi kryesor i Entit Statistikor të Kosovës (ESK). Ai siguron një fillim të qëndrueshëm për monitorimin e varfërisë dhe pabarazisë. Megjithatë, duke përdorur 4 hulumtimet e fundit të ABEF-it për të analizuar varfërinë dhe pabarazinë paraqiten probleme praktike. Prandaj, është e dobishme që të fillohen analizat me një diskutim të sfidave dhe si këto analiza i janë qasur atyre.

2.2 **Pasiguria e parë e madhe ka të bëjë me atë që përfaqësojnë mostrat.** Kosova nuk ka pasur regjistrim të përgjithshëm të popullsisë që nga viti 1981. Prandaj, hulumtimet aktuale ende e përdorin regjistrimin e vitit 1981 si pikënisje për zonat e caktuara e, rrjedhimisht, edhe për përfshirjen në mostër të ekonomive familjare. Megjithatë, shumë ka ndryshuar që nga atëherë. Disa rajone që kanë qenë shumë të populluara mund të mos jenë të tilla tani, ndërsa disa që kanë pasur pak njerëz tani mund të kenë shumë më tepër. Pa ndonjë veprim të mëtijmë, e para paraqet një gabim të madh të mostrave përderisa e dyta paraqet një anshmëri. Për shembull, popullsia e vlerësuar nga hulumtimet tregon një rënie dramatike nga 2 milionë në vitet 2002/03 në 1.5 milionë në 2005/06, që nuk është në përputhje me burimet alternative të të dhënave (shih rubrikën 2.1.). Pasi që nuk ka njohuri të qarta për popullsinë të cilës i referohet është e vështirë që të korrigjohen këto probleme. Prandaj, është e mundur që të dhënat mostër dhe statistikat e marra nga ajo përmbajnë anësi të papërcaktuara.

Rubrika 2.1: Vlerësimi i popullsisë së Kosovës

Nuk ka ndonjë burim të vetëm që siguron një njehsim të saktë të popullsisë. Ne bazohemi në dy burime për të vlerësuar totalin e popullsisë dhe proporcionin urban dhe rural. Fillimisht, ne përdorim të dhënat e regjistrimit të popullsisë për të vlerësuar popullsinë e përgjithshme. Në mes të viteve 2002/03 dhe 2005/06, regjistrimet e përgjithshme në shkollat fillore dhe të mesme janë rritur nga 410, 000 në 422,000. Rreth 380,000 nga ta janë regjistruar në shkollimin fillor – moshat 6-14. Duke përdorur piramidën e popullsisë të Shqipërisë fqinje dhe duke aplikuar proporcionin e kësaj grup moshe në popullsinë e Shqipërisë, ne vlerësojmë se popullsia duhet të jetë diku rreth 2 milionë. Ne i kombinojmë këto me vlerësimet e popullsisë rurale nga anketa e ekonomive familjare bujqësore (AEFB), të kryer nga ESK-ja, për të vlerësuar përhapjen e nënkuptuar rurale dhe urbane. Ky hulumtim në fillim futi në listë të gjitha 1400 fshatrat e Kosovës. Pastaj mori një mostër nga këto fshatra dhe i futi në listë të gjitha banimet. Ato kanë vlerësuar se popullsia rurale është diku rreth 1.3 milion. Kjo do të thotë se pjesa rurale është rreth 65 për qind , ndërsa ajo urbane rreth 35 për qind.

2.3 Sfida e dytë ka të bëjë me krahasueshmërinë e anketimeve. Anketa e parë e kësaj serie, e kryer gjatë viteve 2002/03, ka kërkuar nga ekonomitë familjare që të regjistrojnë shpenzimet ditore në një ditar të hapur. Në vitet pasuese, familjeve u është dhënë një listë, pa dyshim duke përfshirë artikujt të cilët janë raportuar të jenë shpenzuar në hulumtimin e parë. Megjithatë, nga ta gjithashtu është kërkuar që të regjistrojnë shpenzimet javore, e jo ditore. Gjithashtu lista është zgjeruar me kalimin e kohës, edhe pse vetëm për disa artikuj. Ndryshimi i dytë i konsiderueshëm është mënyra si është raportuar për konsumin e mallrave të prodhuara nga vet ata. Në hulumtimin e parë u është lënë familjeve që të raportojnë për secilin artikull. Në hulumtimet pasuese, ato janë grumbulluar në disa kategori. Ekonomive familjare në vend të raportit se sa grurë prodhojnë për konsum vetanak, u është kërkuar që të raportojnë për prodhimin e drithërave, frutave, produkteve të frutave etj. Veç kësaj, nga ta është kërkuar që të raportojnë në euro vlerën e prodhimit të cilin e kanë lënë anash për përdorim vetanak, e jo sasinë e konsumuar. Gjithashtu periudha e të kujtuarit për prodhim të konsumit vetanak, ndryshoi nga baza ditore në hulumtimin e parë në atë mujore në muajt pasues. Arsyeja pse këto ndryshime kanë rëndësi është se kalimi nga një kujtim i shkurtër në atë më të gjatë ka tendencë që të zvogëloj konsumin dhe të rris shkallën e varfërisë (rubrika 2-2).

Rubrika 2.2: Sfidat e përdorimit të të dhënave të ABEF-it për analiza të varfërisë

Anketa e buxhetit të ekonomive familjare të Kosovës (ABEF) ka filluar në qershor të vitit 2002 dhe është administruar që nga atëherë në baza mujore nga Enti Statistikor i Kosovës. Ajo është bërë anketa bazë në përpjekjet e Kosovës për të ndërtuar një sistem afatgjatë të monitorimit dhe vlerësimit dhe është plotësisht i financuar nga qeveria. Megjithatë, të dhënat e anketës përmbajnë disa probleme praktike për të pasur një vlerësim të besueshëm në pjesën e parë të vitit 2000 në Kosovë. Dy çështje justifikojnë një përdorim të kujdesshëm të rezultateve:

1. *Një kornizë e vjetruar për marrjen e mostrave ka sjell gabime të mëdha në përdorimin e mostrave.* Si çdo mikroanketim tjetër, ABEF-i bazohet në mostra përfaqësuese të popullsisë me qëllim të sigurimit të vlerësimeve të paanshme statistikore të popullsisë. Për të bërë këtë, nevojitet një kornizë e besueshme nga e cila do të zgjidheshin mostrat. Regjistrimi i fundit i besueshëm i popullsisë është bërë në vitin 1981. Korniza e zgjedhjes së mostrave (një listë e zonave të numërimit (ZN)) është dhënë nga ESK ndërsa zgjedhja e mostrave është bërë nga Zyra Statistikore e Suedisë nën një projekt të financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA) (Andersson, 2002b). Cilësia e listës së ZN-së është e dyshimtë: dallimi në mes të asaj urbane dhe rurale është thjesht administrativ; klasifikimi sipas përkatësisë etnike zbaton rregulla të rrepta, ndërsa përshkrimi i kufijve gjeografik të ZN-ve është i vjetruar (Andersson, 2002a). Në fund,

administrimi i hulumentit për të siguruar që ato të jenë cilësore ka qenë i kufizuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të kufizimit të burimeve në ESK dhe në këtë mënyrë edhe klasifikimi i gabuar i ZN-ve është lënë anash (Andersson, 2002c), ri-regjistrimi i ZN-ve të mëdha ka qenë i papërfunduar dhe kontrolli i numëruesve në terren mungon. Gjithashtu ekzistojnë edhe çështjet e mbulimit të paktë. Prandaj, statistikat demografike të ABEF-it të secilit vit duket të jenë nga numri i ndryshueshëm i popullatave të marra. Për shembull, vlerësimi për popullsinë totale bazuar në ABEF është 2.1 milionë në 2002-03 dhe 1.5 milion - në 2005-06. Zvogëlimi i tillë nuk është real dhe është në kundërtë me dëshmitë nga të dhënat administrative të regjistrimit në shkollë - se numri i popullsisë ka mbetur relativisht stabil.

2. Problemet e krahasueshmërisë së të dhënave.

Përfundimi se si ka ndryshuar varfëria në Kosovë duke përdorur të dhënat e ABEF-it nuk është i drejtë. Ekzistojnë dy ndryshime gjatë hulumtimeve që i bëjnë të dhënat të pakrahasueshme dhe kërkojnë metodologji speciale për të korrigjuar krahasueshmërinë, të cilat janë diskutuar në Vëllimin II. Ndryshimi i parë është kalimi nga ditari në metodën e kujtimit për grumbullimin e shpenzimeve, duke filluar që nga viti 2003. Ndryshimi i dytë në hartimin e anketës i paraqitur ka qenë ridefinimi i artikujve të konsumit, duke shkurtuar ose zgjatur listën. Një ndryshim i tillë, ai i treti, është grumbullimi i konsumit të prodhimit vetanak nga një listë e gjatë (me 85 artikuj) në një të shkurtër (12) dhe ndryshimi i periudhës së kujtimit nga ajo ditore në mujore në të njëjtën kohë. Grumbullimi i artikujve të konsumit ndikon varësisht asaj që mund t'iu kujtohet të anketuarve dhe kalimi nga një listë më e gjatë në një tjetër duket të qoj në raportim më të ulët të konsumit, dhe në këtë mënyrë edhe në varfëri më të lartë.

2.4 Për të zgjidhur këto çështje ne ndjekim tre hapa. Së pari, përdorim vlerësimet më të mira për shpërndarjen e popullsisë nga hulumtimet e tjera dhe të dhënat administrative për të përshtatur mostrat e zgjedhura. Ne përshtatim matjet e mostrave zgjedhura ashtu që proporcionet rurale dhe urbane mbesin stabile, dhe këto i quajmë këto mostra të vlerësuara si mostra të vlerësuara pas stratifikimit. Prandaj të gjitha rezultatet tona janë të vlerësuara duke përdorura matjet e pas-stratifikimit.

2.5 Së dyti, ne marrin tri vendime në mënyrë për trajtimin e çështjes së krahasueshmërisë. Vendimi i parë është që të krahasohen vetëm të dhënat e viteve 2003/04 dhe 2005/06 për qëllimet e ekzaminimit të trendëve. Nuk i kemi marrë parasysh të dhënat e vitit 2002/03 për shkak se kjo anketë është më së paku e krahasueshme me tri anketat tjera. Për shembull, ka përdorur një ditari të hapur, ka pasur shumë më tepër artikuj dhe ka pasur përkufizim më të gjerë të mallrave të prodhimit vetanak. Ne gjithashtu përjashtojmë vitin 2004/05 por vendimi është shumë më i vështirë. Në të gjitha aspektet, anketa është e krahasueshme me ato të viteve 2003/04 dhe 2005/06. Ajo u ka siguruar ekonomive familjare listën e njëjtë të artikujve ushqimorë dhe joushqimorë, ka definuar konsumin e prodhimit vetanak në mënyrën e njëjtë dhe ka përdorur periudhën e njëjtë të kujtimit. Në bazë të kësaj, ne përfundojmë se konsumi gjatë 2004/05 është shumë më i lartë krahasuar me vitin paraprak ose pasues. Në mënyrë specifike, konsumi joushqimor është rreth 30 për qind më i lartë krahasuar me vitet 2003/04 dhe 18 për qind - krahasuar me 2005/06 (Error! Reference source not found.1). Si pasojë, nivelet e varfërisë janë shumë më të ulëta, ndërsa trendët janë më të paqëndrueshme. Nuk ka ndonjë sqarim të qartë për këtë ngritje të madhe të konsumit gjatë periudhës 2004/05. Andaj për këtë arsye e kemi përjashtuar atë nga analiza e trendëve.

2.6 Vendimi i parë përfshin caktimin e varfërisë bazë sikurse atë të siguruar për të dhënat e 2003/04. Ideale do të ishte që të sigurohet kufiri i varfërisë duke përdorur

shpenzimet e qasjes së nevojave themelore duke përdorur të njëjtën anketë. Por anketat pas vitit 2002/03 nuk grumbullojnë më informata sasiore që janë esenciale për llogaritjen e kufirit të varfërisë. Prandaj vendimi i dytë është dashur të përdorë kufirin e varfërisë i siguar në vitin 2002/03 dhe i përdorur në vlerësimin më të fundit të varfërisë (Banka Botërore 2005), i përshtatur për ndryshimet e çmimeve.

2.7 Vendimi përfundimtar përfshinë ndërmarrjen e një numri të analizave të ndjeshmërisë. Me qëllim të përpjekjes për përdorimin e të gjitha anketave, në të dhënat e Kosovës janë aplikuar disa metoda për krahasimin e të dhënave të pakrahasueshme që janë në dispozicion në literaturë. Në përgjithësi, janë përdorur katër metoda të ndryshme. Një diskutim i hollësishëm i këtyre metodave dhe rezultatet e siguruara nga aplikimi i tyre në të dhënat e ABEF-it është temë e Vëllimit II të këtij raporti. Duke pasur ketë parasysh, pjesa tjetër e këtij raporti trajton rezultatet e varfërisë duke përdorur të dhënat e 2003/04 dhe 2005/06


B. Varfëria nuk ka ndryshuar

2.8 Në përputhje me aktivitetin e ngadalshëm ekonomik, dëshmitë nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare argumentojnë se nuk ka ndryshime në shkallën e varfërisë. Shkalla e varfërisë është rreth 45 për qind në vitet 2003/4 dhe në vitet 2005/6 (

2.9 Ilustrimi 2.1). Rezultatet nga disa metodologji (shih Vëllimin II), të cilat përpiqen të korrigjojnë një numër të dobësive në të dhëna, përkrahin shkallën e pandryshuar të varfërisë. Çuditërisht, ekziston një rënie shumë e madhe e shkallës së varfërisë në mes të viteve 2003 dhe 2004, por nuk ka mundësi që kjo të paraqet një ndryshim real në mirëqenien e popullsisë. Më shumë ka mundësi që problemet që dalin nga zgjedhja e mostrave dhe moszgjedhja e tyre (administrimi i anketave) i kanë kontribuar rënies së konstatuar (shih rubrikën 2-2 për hollësi). Masat e tjera të varfërisë përkrahin varfërinë e stagnuar. Varfëria e ka mbetur rreth 12 deri në 13 për qind dhe ashpërsia e varfërisë ka qenë rreth 5 për qind (Tabela A. 9).

2.9 Gjithashtu nuk ka pasur ndryshime në pjesën e njerëzve në varfëri të skajshme. Ata që jetojnë në varfëri të skajshme, të definuar si individë, të cilët kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave themelore me kalori, kanë përbërë 13 për qind të popullsisë në vitin 2003, por rreth 16 për qind në vitin 2005. Rritja e dukshme është pothuaj tërësisht rezultat i rritjes së madhe dhe të pabesueshme i proporcionit të të varfërve të skajshëm në mesin e ekonomive familjare

Ilustrimi 2.1: Varfëria absolute dhe e skajshme për 2003/04 dhe 2005/06




Burimi: Vlerësime të personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF.

me kryefamiljar serb. (shih rubrikën 3-1). Shkalla e varfërisë së skajshme në mesin e ekonomive familjare me kryefamiljar shqiptar u rrit nga 13 në 15 për qind, përderisa te ato me kryefamiljar serb nga 9 në 44 për qind për periudhën e njëjtë (tabela 3.1).

2.10 Përveç varfërisë së përhapur, edhe rreziku nga ajo është i lartë. Edhe pse e shumë e përhapur, varfëria në Kosovë nuk është e thellë. Një mënyrë për të matur se sa cektë është ajo, është që të shikohen masat e tjera të varfërisë që janë të ndjeshme ndaj lokacionit të të varfërve në shpërndarjen e mirëqenies. Për shembull, varfëria është më e ndjeshme sa më larg që janë të varfërit nga kufiri i varfërisë. Ai bën matjen e mungesës së konsumit për kokë banori si pjesë e kufirit të varfërisë, dhe duke qenë në 12 deri 13 për qind në këtë periudhë ajo është e ulët. Ashpërsia e varfërisë, e cila është e ndjeshme si në distancën nga kufiri i varfërisë ashtu edhe në pabarazinë në mes të të varfërve, gjithashtu është e ulët dhe është vlerësuar të jetë rreth 5 për qind. Një mënyrë tjetër e matjes së cektësisë së varfërisë është që të matet ajo pjesë e popullsisë e cila gjendet rreth kufirit të varfërisë. Ilustrimi 2.2 (paneli A) tregon se një tronditje e cila zvogëlon konsumin e atyre të cilët tani konsiderohen se nuk janë të varfër për 25 për qind, do të çonte një pjesë shtesë të popullsisë prej 18 për qind në varfëri. Me fjalë të tjera, po të ishte kufiri i varfërisë 25 për qind më i lartë, shkalla e varfërisë do të ishte rreth 63 për qind, e jo 45.

Ilustrimi 2.2: Shpërndarja e konsumit, 2003/04 dhe 2005/06




Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF. Kufijtë e varfërisë janë mesataret e matura të popullsisë për dy vitet e anketave.

2.11 Rritja e konsumit ka qenë negative për shumicën e popullsisë. Ndryshimet në konsum për secilën përqindje të popullsisë (grupe të ekonomive familjare të kategorizuara sipas konsumit për kokë banori) të shpërndarjes së konsumit tregojnë se katër pesë përqindëshat e fundit kanë pasur rritje negative në mes të viteve 2003 dhe 2005. Gjithashtu, një inspektim vizual i dobive të një të pestës më të lartë tregojnë vetëm norma modeste, gati në renditje të një të pestës mesatarisht.

2.12 Megjithatë, popullsia urbane ka përfituar dhe zhvillimi ka qenë i shpërndarë në mënyrë më të barabartë. Ilustrimi 2.3 (Paneli B) tregon ndryshimet në konsum për

secilën pjesë. Po ashtu tregon se përfitimet për të gjitha grupet urbane, përveç ndoshta një të pestës së ulët kanë qenë pozitive. Dëshmitë gjithashtu sugjerojnë se madhësia e përfitimeve të vrojtuar për përqindjet të cilat kanë përfituar në gjysmën e poshtme të shpërndarjes kanë qenë gati të së njëjtës madhësi sa përfitimet e atyre në gjysmën e sipërme të shpërndarjes. Me fjalë të tjera, përfitimet (për ata të cilët kanë përfituar) kanë qenë në mes të 5 dhe 10 për qind, pavarësisht nga renditja e përqindjes.

Ilustrimi 2.3: Paraqitja e rritjes për zhvillimin nga 2003/4 në 2005/06



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-së.

2.13 Por në rajonet rurale vetëm një e pesta e parë e popullsisë ka përfituar.

Përfitimet për tri të pestat e para (deri në përqindëshin e 60-të) kanë qenë negative, dhe zero për një të pestën e katërt (Ilustrimi 2.3, Paneli C). Humbjet e konsumit duket të jenë mjaft substanciale për një të pestën e fundit. Ato raportojnë humbje më të mëdha se 10 për qind. Në gjithashtu kemi vrojtuar humbje prej më shumë se 20 për qind për disa grupe të popullsisë në përqindjen e ulët. Grafiku gjithashtu lë të kuptohet se pse ne vëzhgojmë varfërinë në rajonet urbane e jo rurale. Në të parën, dy nga katër pjesët prej një të dhjetës që konsiderohen të varfra kanë pasur përfitime pozitive, duke lejuar disa nga këto grupe që t'i ikin varfërisë, përderisa në rajonet rurale ka pasur rënie në pozicionet e konsumit për pjesët e varfra të popullsisë. Pasi që të paktën 60 për qind e popullsisë së Kosovës është ende rurale, nuk është për tu çuditur që ka pasur një ngecje të përgjithshme të varfërisë.

2.14 Një zbërthim i ndryshimeve në varfëri tregon se rishpërndarja ka luajtur një rol më të madh se sa zhvillimi në trendët e vrojtuar të varfërisë.

Tabela 2.1 tregon pjesën e trendëve të vrojtuar që paraqitet nga zhvillimi, ndryshimet në shpërndarje dhe teprica. Zbërthimi është bërë për kokë banori, për dallimin e varfërisë dhe dallimin e rrafshët të varfërisë. Duhet përmendur se në mes të viteve 2003 dhe 2005, llogaritja i për kokë banori është rritur për rreth 1.6 për qind. Tabela 2.1 tregon se nëse forma e shpërndarjes mbetet e njëjtë - meqë pabarazia nuk ka ndryshuar në mes të viteve 2003 dhe 2005 – atëherë varfëria për kokë banori do të zvogëlohej për 0.8 për qind për shkak të rritjes së konsumit mesatar. Kjo do të thotë që rreth 16,000 njerëz do të mund t'i ikin varfërisë. Në vend të kësaj ne vërejmë një rritje të varfërisë për shkak se rishpërndarja brenda popullsisë çon në një ngritje prej 2.5 për qind në varfërinë për numër të banorëve, e cila ka nisur dhe tejkalar përfitimet e pritura nga zhvillimi. E thënë ndryshe, tabela

propozon që përveç zhvillimit të dobët, ka pasur një rritje edhe të pabarazisë në Kosovë gjatë kësaj periudhe.

Tabela 2.1: Zbërthimi i varfërisë: 2003/04 krahasuar me 2005/06

	<u>Ndryshimi</u>	<u>Zhvillimi</u>	<u>Rishpërndarja</u>	<u>Bashkëveprimi</u>
<u>Totali</u>				
Llogaritja e varfërisë (P0)	1.6	-0.8	2.5	-0.1
Boshllëku i varfërisë (P1)	1.4	-0.4	1.7	0
Ashpërsia e varfërisë (P2)	1.2	-0.2	1.3	0
<u>Urbane</u>				
Llogaritja e varfërisë (P0)	-4.7	-3.3	-0.1	-1.3
Boshllëku i varfërisë (P1)	-1.2	-1.5	0.2	0.1
Ashpërsia e varfërisë (P2)	-0.2	-0.7	0.5	0
<u>Rurale</u>				
Llogaritja e varfërisë (P0)	5	1.4	3.7	-0.1
Boshllëku i varfërisë (P1)	2.8	0.5	2.3	0
Ashpërsia e varfërisë (P2)	1.9	0.2	1.6	0

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

2.15 Tabela 2.2 siguron një përmbledhje të ndryshimeve përgjatë shpërndarjes. Ajo tregon se në mes të viteve 2003 dhe 2005, mesatarja e konsumit për kokë banori është rritur për 1 për qind, por që ato të mesit nuk janë zhvilluar pothuaj fare. Në të vërtetë, zhvillimi mesatar i konsumit për kokë banori për secilin përqindësh ka qenë negativ (Tabela 2.2, rreshti 3). Më me rëndësi, konsumi për kokë banori i grupit prej 44 për qind – asaj pjese të popullsisë e cila është klasifikuar si e varfër në vitin 2003 – ka përfjetuar humbjet më të mëdha, një reduktim prej 5.8 për qind.

Tabela 2.2: Shkalla e zhvillimit në konsum për kokë banori

Shkalla e zhvillimit në mesatare	1.13
Shkalla e zhvillimit në medium	-0.50
Përqindja mesatare e shkallës së zhvillimit	-1.28
Kufiri i varfërisë	43
Përqindja korresponduese	43
Shkalla e zhvillimit pro-të varfërve	-5.78

2.16 Në zonat urbane, zhvillimi ka treguar një rënie të dukshme të varfërisë, përderisa në ato rurale rishpërndarja ka treguar rritje të varfërisë. Rreth 3.3 për qind të zvogëlimit të vrotuar të varfërisë urbane është bërë për shkak të zhvillimit. Për më tepër rritja e çdo rishpërndarje që është bërë nuk duket të ketë pasur ndonjë efekt të kundërt në varfëri. Për krahasim, ngritja prej 4 nga 5 për qind në varfërinë rurale, ka qenë rezultat i ndryshimit në formën e shpërndarjes (Tabela 2.1).

Tabela 2.3: Treguesit e pabarazisë për 2003/04 dhe 2005/06


	<u>Total</u>		<u>Urbane</u>		<u>Rurale</u>	
	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>
Proporcioni në përqindje p90/p10	3.33	3.96	4.05	4.42	3.09	3.68
p75/p25	1.89	1.97	2.14	2.06	1.78	1.9
Entropia e Gjeneralizuar , EG(0)	0.12	0.15	0.16	0.17	0.1	0.14

GE(1)	0.13	0.16	0.17	0.16	0.1	0.14
Koeficienti Gini	0.27	0.3	0.31	0.31	0.25	0.28

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

2.17 Veç varfërisë që ka stagnuar, ka pasur edhe një rritje të vogël të pabarazisë. Siç është diskutuar më lartë, ekzistojnë dy rrugë të rishpërndarjes së vrojtuar, të cilat do të çonin tek një pabarazi edhe më e madhe. Fillimisht, përderisa shumica e popullsisë urbane ka pasur zhvillim pozitiv, shumica e popullsisë rurale ka pasur zhvillim negativ. Së dyti, në zonat rurale, ku jeton të paktën dy e treta e popullsisë, ata të klasifikuar në fund të shpërndarjes së konsumit kanë pasur humbje negative thelbësore, përderisa një e pesta e sipërme ka pasur zhvillim pozitiv. Rezultati përfundimtar do të duhej të ishte një rritje në pabarazi, e cila edhe është ajo çka vërehet (Tabela 2.3 dhe ilustrimi 2.4). Rezultatet tregojnë se koeficienti Gini është rritur për rreth 4 për qind në mes të viteve 2003 dhe 2005. Masat e tjera të pabarazisë gjithashtu tregojnë një rritje. Për më tepër, pabarazia në rajonet rurale është rritur më tepër se sa në ato urbane, edhe pse pabarazia në rajonet urbane është më e madhe se sa në ato rurale. Në mënyrë specifike, siç ka treguar paraqitja vizuale e dobive dhe humbjeve (Ilustrimi 2.3), proporcioni në mes të ekonomive familjare më të pasura dhe atyre më të varfra është rritur në mënyrë të theksuar në zonat rurale (tabela 2.3).

Ilustrimi 2.4: Lakoret e Lorencit për vitet 2003/04 dhe 2005/06




Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

C. Dimensionet varfërisë që nuk bazohen në të hyra

2.18 Dimensionet e mirëqenies që nuk bazohen në të hyra tregojnë rezultate më të mira. Edhe pse trendët në varfërinë e bazuar në të ardhura kanë qenë zhgënjyese, ekziston një regjistrim gati i përgjithshëm në arsimin fillor. Gjithashtu nuk ka dallime të dukshme mes meshkujve dhe femrave në regjistrimin në shkollën fillore, dhe dallimet në mes të varfërve dhe të atyre që nuk janë të varfër ose rural dhe urban janë gjithashtu të papërfillshme. Regjistrimi në shkollimin e mesëm është po ashtu brenda niveleve të vlerësuara për vendet në regjion. Mirëpo shkalla e regjistrimit në shkollim të lartë është paksa më e vogël se sa shkallët e vlerësuara për rajonin, përveç Shqipërisë. Për shembull shkalla neto e regjistrimit për të rinjtë prej 20-24 vjeç, në vitin 2005 ka qenë 17 për qind. Vetëm sa për krahasim, kjo shifër në Bosnje ishte 17 për qind. Shkalla e regjistrimit për të rinjtë prej moshës 20-29 vjeçare në Kosovë është 10%, ndërsa në Shqipëri është 13% (tabela B.50). Përveç kësaj, një numër relativisht i lartë i njerëzve raportojnë se jetojnë në objekte banime të sigurta (me mure nga tullat, blloqet ose çimento) (shih Tabelën B. 31), objekte banimi me energji elektrike dhe me lidhje të ujit brenda objekteve të banimit (shih Ilustrimi 2.6 dhe Tabela B.29).


Ilustrimi 2.5: Neto shkalla e regjistrimit në arsim



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it . Neto shkalla e regjistrimit = Totali i nxënësve të regjistruar të moshës 6-14/fëmijët e kësaj grup moshe. Në pyetësorin 2002/03 pyetja për regjistrim është shtuar për fëmijët mbi 7 vjet. Në anketat e mëvonshme kjo është ndryshuar në fëmijët mbi 6 vjet. Grupmoshat e përdorura janë: për arsimin fillor 7-14 gjatë 2002/03, fillor 6-15 duke filluar nga 2003/04; lëmesëm 16-18; terciar 20-24.

2.19 Përkundër këtyre rezultateve pozitive, ekzistojnë dy aspekte kryesore të dobësive në shërbimet themelore. Fillimisht, ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme për sa i përket qasjes në shërbimet themelore. Në arsim, neto regjistrimi në arsimin e mesëm është mesatarisht rreth 70 për qind. Megjithatë, shkalla e regjistrimit për një të pestën më të pasur është për rreth 20 për qind më e lartë se sa ajo e një të pestës më të varfër. Kontrasti në regjistrime është shumë më i lartë në arsimin e lartë, ku shkalla e regjistrimeve për një të pestën më të pasur janë dyfish më të larta se sa ato për një të pestën më të varfër. Në shëndetësi, imunizimi i fëmijëve dhe ushqimi i pamjaftueshëm, posaçërisht tek grupet e pakicave (romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët) tregojnë rezultate të ulëta (Banka Botërore, 2006a). Ngjashëm, dallime të mëdha në mes të grupeve më të pasura dhe atyre më të varfra vërehen edhe për sa i përket lidhjes së ujit brenda në shtëpi (Ilustrimi 2.6).

Ilustrimi 2.6: Qasja në ujë: përqindja e njerëzve të cilët jetojnë në objekte banime që kanë ujë brenda në shtëpi, 2003/04 dhe 2005/06




Burimi: Llogaritje të personelit të Bankës Botërore duke përdorur të dhënat e ABEF-it. Pyetjet për banim nuk janë të njëjta për vitet 2002/03 dhe anketat më të vona. Numri i kategorive zvogëlohet nga mbi 20 në 9.

2.20 Së dyti, qasja gati e përgjithshme nuk është shoqëruar me cilësi të mirë të shërbimeve. Edhe pse anketat ABEF-it nuk janë në gjendje të trajtojnë këto çështje, është më se e kuptueshme se cilësia e shërbimeve themelore është e ulët. Në arsim, ekzistojnë përpjekje për të modernizuar planprogramin dhe për të bërë profesionin e mësimdhënies më konkurrues. Sidoqoftë, ngarkesa e madhe sidomos në shkollat urbane është e zakonshme, një pjesë e madhe e mësimdhënësve nuk kanë kualifikim të duhur profesional dhe nuk ka standarde ose vlerësime të jashtme (Banka Botërore, 2006a). Prandaj, nuk ka ndonjë mënyrë për të ditur çka mësojnë fëmijët në shkolla. Për sa i përket energjisë elektrike, ekzistojnë probleme të njohura në furnizimin e pamjaftueshëm, posaçërisht gjatë kur kërkesa është më e madhe, ndërsa cilësia e ujit nuk është e njëjtë për të gjitha ndarjet e zonave sipas pasurisë ose sipas ndarjeve rurale/urbane. Kur jemi tek çështja e ujit, dallimet në cilësi janë posaçërisht të mëdha në mes të rajoneve urbane dhe rurale. Në vitin 2003, 70 për qind e mostrave të ujit nga rajonet rurale kanë qenë bakteriologjikisht të kontaminuara përderisa vetëm 8 për qind e mostrave nga rajonet urbane kanë qenë kështu. Gjithashtu kontaminimi kimik është vërejtur në 46 për qind të mostrave rurale krahasuar me 4 për qind të atyre urbane (Banka Botërore, 2006a).

2.21 Së fundi, rreth 9 për qind të popullsisë është e privuar në dimensione të shumëfishta. Rreth 32 për qind e popullsisë është e varfër dhe e kanë të instaluar ujin brenda shtëpive dhe kanë kushtet higjienike sanitare. Kjo do të thotë se pjesa tjetër prej 15 për qind e të varfërve kanë qasje ose në lidhje të brendshme të ujit ose në kushte higjienike sanitare të duhura, por jo në të dyja. Por më të privuarit janë ata të cilët janë materialisht të varfër dhe veç kësaj nuk kanë qasje në ujë brenda objektit të banimit dhe në kushte higjienike dhe sanitare të përshtatshme. Dëshmitë nga ABEF thonë se rreth 8 për qind janë të varfër dhe gjithashtu nuk kanë qasje në ujë brenda shtëpive ose kushte higjienike dhe sanitare të përshtatshme (tualetet për banjë). Ngjashëm me këtë, 9 për qind e popullsisë është e varfër de nuk kanë qasje në lidhje telefonike ose banjë (ilustrimi 2.7). Për krahasim, një studim i kohëve të fundit ka treguar se vetëm 1 për qind e popullsisë në Rusi, Gjeorgji dhe Rumaninë fqinje janë privuar në dimensionet e shumëfishta (Banka Botërore, 2005b).

Ilustrimi 2.7: Diagrami i Venit i varfërisë që nuk bazohet në të hyra dhe ai i bazuar në të hyra



2.22 Për të përfunduar, dëshmitë e dokumentuara në këtë kapitull tregojnë se varfëria bazuar në të hyra ka mbetur shumë e përhapur dhe ka vazhduar gjatë viteve 2003 dhe 2005. Zbërthimi i trendit të varfërisë ka treguar se ndryshimet e pabarazisë kanë pasur ndikim shumë më të madh në rezultatet e varfërisë së vrojtuar sesa zhvillimi. Për më tepër, këto ndryshime të pabarazisë gjithashtu pjesërisht shpjegojnë diferencat e vërejtura në zonat urbane dhe rurale. Gjithashtu kemi arritur në përfundim se përderisa dimensionet e varfërisë që nuk bazohen në të hyra tregojnë rezultate më të mira, qasja jo e barabartë dhe cilësia e dobët janë të zakonshme. Në fund, ne kemi gjetur se një pjesë e madhe e popullsisë është e privuar në shumë aspekte dhe dimensione.

KAPITULLI 3. PROFILI I VARFËRISË DHE RREZIKU I VARFËRISË

Varfëria manifestohet shumë në ekonomitë familjare të mëdha, posaçërisht në ato të cilat kanë më shumë anëtarë që varen nga të tjerët, si dhe te familjet të cilat kanë shumë anëtarë të papunësuar. Gjithashtu ka dëshmi së ekonomitë familjare me kryefamiljarë serb ose femra janë në rrezik më të madh nga varfëria, edhe pse cilësia e të dhënave të mëparshme është e diskutueshme. Si në shumë situata të tjera, nivelet më të larta të shkollimit janë të lidhura me nivele më të ulëta të varfërisë. Në fund, ne kemi ardhur në përfundim se paraqitja e varfërisë e bazuar në aspektin gjeografik tregon se ajo është më e madhe për banorët e zonave rurale dhe për popullsinë e cila jeton në Mitrovicë dhe Ferizaj.


3.1 Ky kapitull paraqet një përshkrim të shkurtër të karakteristikave të dukshme të të varfërve. Ai përqendrohet në resurset e tyre njerëzore, strukturën e tyre demografike, lokacionin e tyre, si dhe performancën e tyre në tregun e punës. Po ashtu i kushton vëmendje të posaçme të varfërve në zonat rurale. Pastaj, i trajton faktorët të cilët e përcaktojnë rrezikun e rënies në varfëri.

A. Karakteristikat demografike të ekonomive familjare të varfra

3.2 **Ekonomitë familjare më të mëdha janë mesatarisht më të varfra.** Ekonomitë familjare që kanë mbi 6 anëtarë të familjes kanë manifestim të varfërisë prej gati 50 për qind, krahasuar me atë prej 30 për qind të familjeve përgjysmë më të vogla ose edhe me më pak anëtarë (1 deri në 3 anëtarë). Me kalimin e kohës shkalla e varfërisë për ekonomitë familjare më të mëdha ka mbetur e pandryshuar, përderisa për ekonomitë familjare më të vogla është rritur, duke pasqyruar perspektivat e vogla për tërë popullsinë gjatë kohës. (Ilustrimi 3.1 dhe Tabela B.5).

3.3 Përveç madhësisë, edhe struktura e ekonomisë familjare paraqet influencën e vet në përmirësimin e mirëqenies. Ekonomitë familjare vetëm me persona të varur, pra ato familje që përbëhen vetëm nga fëmijët dhe të moshuarit, kanë pasur 40 për qind shkallë të varfërisë në vitin 2003. Në krahasim me këtë, ekonomitë familjare që nuk kanë persona të varur kanë shkallë të varfërisë prej 29 për qind. Me kalimin e kohës, shkalla e varfërisë për ekonomitë familjare me më shumë anëtarë të moshuar ose të varur është përkeqësuar. Për shembull, në vitin 2003 shkalla e varfërisë për ekonomitë familjare më të vjetra, të definuar si familje me më shumë së gjysmën e anëtarëve të moshuar, ka qenë përafërsisht e njëjtë se mesatarja e Kosovës ose se mesatarja për ekonomitë familjare që nuk kanë të moshuar. Megjithatë në vitin 2005 ne kemi vërejtur një shkallë shumë më të lartë të varfërisë për ekonomitë familjare më të varfra. Ngjashëm, dallimet në paraqitjen e varfërisë në mes të ekonomive familjare me proporcione më të larta ose më të ulëta të varshmërisë është rritur me kalimin e kohës (Tabela B.8 dhe Tabela B.9).

Ilustrimi 3.1: Shkalla e varfërisë sipas madhësisë se ekonomisë familjare



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF.

3.4 Shkalla e varfërisë gjithashtu është më e madhe te ekonomitë familjare me kryefamiljare, krahasuar me ato ku kryefamiljari i familjes është mashkull. Shkalla e varfërisë për familjet ku kryefamiljare janë femrat ka qenë 47 për qind në vitin 2003, ndërsa për ato ku kreu i familjes ka qenë mashkull ka qenë 43. Me kalimin e kohës shkalla e varfërisë është rritur në të dy kategoritë, me të njëjtën madhësi, kështu që dallimi ka mbetur i pandryshuar (Tabela B.7).

3.5 Rajonet ku dominojnë grupet e mëdha etnike serbe dhe në ekonomitë familjare ku kryefamiljari është identifikuar si serb duket të kenë përjetuar më shumë varfëri, edhe pse cilësia e të dhënave mbetet problem. Për të krijuar një mostër përfaqësuese të ekonomive familjare, anketa buxhetore e ekonomive familjare të Kosovës e paraqet mostrën e saj për rajonet shqiptare dhe serbe. Klasifikimi i rajoneve në rajone me shumicë etnike shqiptare ose serbe është i bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981 dhe është mjaft arbitrar. Veç kësaj, vetëm rreth 300 ekonomi familjare nga rajonet me shumicë serbe janë anketuar çdo vit. Kështu rezultatet për grupet etnike janë më të pasakta. Me këtë histori rezultatet tregojnë se llogaritja e varfërisë për rajonet serbe dhe për ekonomitë familjare me kryefamiljar serb duket të jenë ngritur tej mase në mes të viteve 2003 dhe 2005 (shih ilustrimin b3.1 dhe rubrikën 3.1 më poshtë).

Tabela 3.1: Shkalla absolute dhe e skajshme e varfërisë duke përdorur metodologjinë PA05


	<u>Absolute</u>		<u>E skajshme</u>	
	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>
Totali	43.5	45.1	13.3	16.6
Shqiptar	43.6	42.5	13.4	14.7
Serb	34.7	81.8	8.6	43.5
Tjetër	54.3	51.8	18.5	22.7

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

Rubrika 3.1: Tri hipoteza për kushtet degjeneruese në mesin e ekonomive familjare serbe

Shkalla e varfërisë në mesin e ekonomive familjare të cilat janë klasifikuar si serbe duket të tregojnë një rritje të madhe të varfërisë në vitet 2003 deri 2005. Ekzistojnë tri mundësi për këto rritje. E para është se rajonet serbe janë bërë enklava, ekonomi të izoluar, të cilat janë duke u sprovuar me perspektiva më të errëta ekonomike përbrenda ekonomisë tepër të stagnuar të Kosovës. E dyta është se shumë nga familjet serbe të cilat janë në gjendje më të mirë janë zhvendosur në Republikën e Serbisë dhe ata të cilët kanë mbetur janë kryesisht më të varfrit. Së fundi, ekziston mundësia se kualiteti i të dhënave kryesisht nga rajonet statistikore serbe, janë të dobëta sepse zyra Statistikore nuk ka shumë kontroll mbi numëruesit në rajonet serbe. Është shumë e mundshme që të tri hipotezat vlejnjë. Nga e lartpërmendura, përmasa e rritjes në shkallën e varfërisë duket të jenë të pamundshme për shkak se as nivelet e pranuar konvencionale të migrimit të jashtëm të serbeve nga Kosova e as klasifikimi i mirëqenies së tyre në Kosovë nuk i përkrahin këto shifra. Për më tepër statusi i fuqisë punëtore dhe pagat në rajonet me shumicë Serbe nuk duket të jenë shumë të ndryshme (shih më poshtë).

Ilustrimi b3.1: Papunësia dhe niveli i pjesëmarrjes së fuqisë punëtore sipas përkatësisë etnike.



Burimi: Llogaritje të personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it. Anketa lejon një vlerësim të përafërt të pasivitetit (punëtor familjar pa pagesë, amvisë, nxënës/student, pensione/të paafët) dhe në këtë mënyrë nivelet e papunësisë janë vetëm të përafërta

Tabela b3.1: Nivelet e varfërisë, statusi i fuqisë punëtore dhe pagat e popullsisë serbe.

Vetëm popullsia Serbe	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>
Niveli i varfërisë së të papunëve	43.8	84.9
Niveli i varfërisë të të papunët	30.0	77.0
Niveli i Papunësisë së të varfërve	40.8	30.3
Niveli i papunësisë të jo të varfrit	27.4	20.6
Pagat (ne çmime 2002)	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>
Shqiptar	215.2	215.6
Serb	241.8	181.2
Të tjerë	181.6	182.0

Burimi: Llogaritje të personelit të Bankës botërore nga të dhënat e ABEF-it. Etniciteti i vet-raportuar (siç i është kundërvënë klasifikimit të rajonit të numërimit) dhe papunësia e përdorur.

B. Karakteristikat e tregut të punës së të varfërve

3.6 Të papunësuarit kanë gjasa më të mëdha që të jenë të varfër dhe kushtet e tyre janë keqësuar me kalimin e kohës. Sipas HBS (Tabela 3.2), niveli i papunësisë gjatë viteve 2005/06 është rreth 55 për qind, dhe rreth 17 për qind e njerëzve që janë të varfër dhe të papunë janë kryefamiljarë. Në popullsi, rreth 16 për qind e kryefamiljarëve

janë të papunë dhe kjo për qindje ka mbetur e pandryshuar gjatë kësaj periudhe. Prandaj, shkalla e varfërisë në mesin e kryefamiljarëve të papunë ka qenë gati 50 për qind, dhe kjo shifër nuk është rritur me kalimin e kohës.

Tabela 3.2: Varfëria dhe papunësia

	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>
Shkalla e varfërisë të të papunësuarit	50.6	49.6
Shkalla e varfërisë të të punësuarit	31.9	34.7
Shkalla e papunësisë të të varfërve	59.7	54.5
Shkalla e papunësisë të jo-të varfrit	41.8	41.3

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it. Anketa lejon një përafrim të pasivitetit (punëtor familjar i papaguar, nxënës/student, pensionist/i paaftë) dhe në këtë mënyrë shkallët e papunësisë janë vetëm të përafërta.

3.7 Një grup tjetër me manifestim të madh të varfërisë janë punëtorët me pagesë ditore. Rreth 70 për qind e të varfërve janë ose të punësuar (me rrogë ose të vetëpunësuar) ose pasiv. Në mesin e të punësuarve, punëtorët me pagesë ditore (me mëditje) (me siguri punëtorët e thjeshtë të cilëve u bëhet një pagesë në bazë të punës së kryer) kanë shkallën më të lartë të varfërisë (tabela B11 dhe tabela B12). Ky grup, bashkë me kryefamiljarët e ekonomive familjare të cilët janë të vetëpunësuar dhe ata në sektorin e minierave, përbëjnë një pjesë të rëndësishme e të varfërve që punojnë (tabela B51).

3.8 Ekonomitë familjare të vetëpunësuarra bujqësore ballafaqohen më shkallë mesatare të varfërisë, por për nga madhësia janë kontribuuesit e tretë në shkallën varfërisë. Rreth 40 për qind e ekonomive familjare të udhëhequra nga punëtorë bujqësorë të vetëpunësuar janë të varfër, që përbën shkallën e varfërisë në këtë grup pak nën mesataren e vendit. Megjithatë, ky grup është mjaft i madh pasi që përbën rreth 10 për qind të të gjithë të varfërve (tabela B.51).

C. Arsimimi dhe shkalla e varfërisë

3.9 Shkalla e varfërisë zvogëlohet në mënyrë të shpejtë sa më i lartë që të jetë niveli arsimor i kryefamiljarit. Rreth 43 për qind të kryefamiljarëve të ekonomive familjare e kanë përfunduar arsimin e mesëm ose edhe më shumë. Shkalla e varfërisë është më e lartë në mesin e atyre që jetojnë në ekonomi familjare ku kryefamiljari nuk e ka të përfunduar arsimin fillor (tabela B.10). Shumica e të varfërve, megjithatë, e kanë të përfunduar arsimin fillor ose të mesëm (tabela B.52). Shkalla e varfërisë bie në mënyrë drastike për rreth 20 për qind te familjet ku kryefamiljari ka përgatitje universitare.

3.10 Siç pritet, ata më të arsimuar kanë shkallë më të ulët të varfërisë për shkak se kanë perspektiva më të mira dhe pagesë më të mirë. Mbi 70 për qind e personave me arsim profesional ose të lartë janë punëtorë me rrogë. Për krahasim, vetëm 27.7 për qind të personave me arsim të mesëm kanë vende të tilla të punës, përderisa 41.1 për qind raportojnë të jenë të papunë. Gjithashtu një pjesë më e madhe e personave me arsim të mesëm raportojnë se punojnë si punëtorë “me mëditje” ose punëtorë “të tjerë” (tabela 3.3). Gjithashtu ka dallime në pagesë. Në mes të viteve 2002 dhe 2005, pagat reale të

punëtorëve me rrogë kanë mbetur të pandryshueshme përderisa ato për punëtorët “me mëditje” ose punëtorët “tjerë” kanë rënë (Tabela 1.4: Pagat mujore mesatare dhe numri i vëzhgimeve .

Tabela 3.3: Punësimi dhe arsimi, 2005/06.

	Shkollimi fillor i pakryer	Fillor	I mesëm	Profesional	I lartë
Punëdhënësi	0.3	0.1	1.4	1.1	3.6
Punëtori me rrogë	3	6.2	27.7	70.6	69
Bujku për ekzistencë Punëtori ditor	3.6	7	5.6	2.4	1.1
I papunë	1.8	3.9	4.3	1.6	1.3
Amvise	16.9	32.1	41.1	15.1	16.6
Të tjerë	55.2	43.7	10.3	2.6	1
Total	19.2	6.8	9.7	6.6	7.3
	100	100	100	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.
Shifrat e matura për moshat 15-65 vjet.

D. Niveli i manifestimit të varfërisë

3.11 **Shkalla e varfërisë ndryshon gjerësisht nëpër hapësirë.** Përveç përkatësisë etnike, të dhënat janë shtresuar në 7 rajone, dhe urbane dhe rurale. Ne përdorim 7 rajonet e definuara në anketa për të siguruar shkallën e varfërisë nëpër hapësirë. Në vitin 2003, shkalla e varfërisë ka qenë më e larta në Mitrovicë, pasuar nga Ferizaj, Gjakova dhe Prizreni (tabela 3.4). Shkalla e varfërisë në të katërtat ka qenë më e lartë se sa llogaritja kombëtare. Deri në vitin 2005, vetëm Mitrovica (me popullsi të madhe serbe) dhe Ferizaj kanë pasur shkallë të varfërisë më të lartë se sa llogaritja kombëtare. Mitrovica ka një pjesë më të madhe të popullsisë rurale (mbi 70%) dhe pjesë më të madhe të grupeve etnike joshqiptare, si serbët (mbi 10%) (tabela B.53 dhe tabela B.54). Prishtina, e cila ka pasur një prej shkallëve më të ulëta të varfërisë, gjatë kësaj periudhe ka pësuar një rritje të varfërisë gjatë kësaj periudhe. Kjo propozon ose se një pjesë e madhe e të varfërve në rajonet tjera urbane apo rurale janë tërhequr në rajon ose se

Tabela 3.4: Shkalla e varfërisë dhe kontributi sipas rajoneve në Kosovë, 2003-2006

	<i>Llogaritja e nivelit të varfërisë</i>		<i>Shpërndarja e të varfërve</i>	
	<i>2003-04</i>	<i>2005-06</i>	<i>2003-04</i>	<i>2005-06</i>
Gjakova	48.9	45.3	11.5	12.8
Gjilani	32.5	23.5	7.9	5.6
Mitrovica	59	69.7	22.7	22.6
Peja	37.8	40.1	9.6	10.2
Prizreni	48.3	40.5	15.3	15.8
Prishtina	34.3	40.6	22.5	19.8
Ferizaj	49.8	54.4	10.5	13.3
Total	43.7	45	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF .


popullsia e saj jomigruese nuk ka kaluar mirë gjatë kësaj periudhe.

3.12 Të dhënat e ABEF-it kërkojnë nga të anketuarit që t'i raportojnë anëtarët e ekonomive familjare të cilët kanë lindur jashtë komunës së tyre të banimit (një autorizim për shpërngulje). Nuk pyetet se para sa kohësh janë shpërngulur në vendbanimin e tyre aktual ose prej cilës komunë kanë ardhur. Kështu përderisa informatat në dispozicion nuk mundësojnë të bëhet një dallim të qartë në mes të këtyre proceseve, mund të sigurohet më i mundshmi. Tabela B.47 tregon pjesën e vlerësuar të popullsisë që banon në secilën komunë, pjesën e popullsisë që kanë raportuar të kenë lindur jashtë komunave të tyre aktuale, si dhe shpërndarjen e të varfërve me anëtarë të lindur jashtë komunës. Mitrovica, Prizreni, Peja dhe Prishtina kanë pjesën më të madhe të popullsisë që kanë lindur jashtë komunës së tyre aktuale. Me fjalë të tjera, këto katër komuna kanë pranuar 3 nga 4 “emigruesit e brendshëm”. Por kur e shikojmë statusin e varfërisë të popullsisë “emigruese” dhe ku jetojnë ata, ne gjejmë se çdo i treti jeton në Mitrovicë, rreth çdo i katërti në Prizren dhe një 16 përqindësh në Ferizaj. Vetëm 7 për qind e të varfërve “emigrues” jeton në Prishtinë.

3.13 **Mungesa e përparimit të përgjithshëm në zvogëlimin e varfërisë e fsheh divergjencën në mes të zonave rurale dhe urbane.** Në vitin 2003, nivelet e varfërisë rurale dhe urbane kanë qenë deri diku të njëjta: 44 dhe 42 për qind. Deri në vitin 2005, varfëria urbane ka rënë për 5 për qind përderisa ajo rurale është rritur për po aq. (Ilustrimi 3.2). Si rezultat i kësaj, më tepër se dy të tretat e të gjithë të varfërve jetojnë në rajone rurale dhe kjo pjesë ka pësuar rënie të vogël gjatë kësaj periudhe.


3.14 Individët pa pasuri bujqësore prodhuese e kanë shkallën më të lartë të vlerësuar të varfërisë në popullsinë rurale. Në vitin 2002 dhe sërish në vitin 2005, është kërkuar nga ekonomitë familjare në rajonet rurale që të raportojnë nëse posedojnë tokë ose jo. Nuk ka ndonjë informacion për periudhën mes këtyre dy viteve, prandaj nuk është e mundur që të përcillen ndryshimet në shkallën e varfërisë në mes të viteve 2002 dhe 2005 për shkak se të dhënat e konsumit për këto dy vite nuk janë të krahasueshme. Në vend të kësaj ne raportojmë shkallën e varfërisë për vitin 2005. Rreth 10 për qind e ekonomive familjare në rajonet rurale kanë raportuar të mos kenë tokë dhe ne kemi konstatuar se 7 nga 10 ekonomitë familjare në këtë grup janë klasifikuar si të varfër në vitin 2005 (Tabela B.13). Veç kësaj, ata të cilët kanë raportuar që nuk kanë bagëti ose pajisje bujqësore si traktor, plug ose rimorkio, gjithashtu tregojnë shkallë më të lartë të varfërisë se sa ajo mesatare. (Tabela B.14 dhe Tabela B.15).

Ilustrimi 3.2: Trendët rurale dhe urbane të varfërisë



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.


Ilustrimi 3.3: Qasja e zonave rurale në shërbime



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

3.15 Në dimensionet e mirëqenies që nuk bazohen në te hyra, popullsia rurale ka më pak qasje në ujë brenda objekteve të banimit dhe në ngrohje qendrore. Qasja në furnizim me ujë brenda objektit të banimit duket të jetë përmirësuar në zonat rurale, por është ende e ulët në krahasim me rajonet urbane. Ilustrimi 3.3 (paneli B) tregon se qasja në ujin e sigurt në rajonet rurale është rritur për të gjitha pjesët e popullatës nga viti 2003 në vitin 2005. Përderisa ky është një zhvillim pozitiv, pabarazia e qasjes së grupeve më të pasura dhe atyre më të varfra është e madhe. Vetëm 60 për qind e popullsisë më të varfër kanë furnizim me ujë brenda objektit të banimit krahasuar me 80 për qind të atyre më të pasura. Për më tepër, këto nivele janë ende më të ulëta se sa ato në rajonet urbane. Për sa i përket ngrohjes qendrore, më pak se 10 për qind të popullsisë rurale raportojnë se jetojnë në objekte banimi me ngrohje qendrore, përderisa në ato urbane ekziston qasja gati e përgjithshme. Dallimi në nivelet e regjistrimit në arsimin e mesëm në mes të rajoneve rurale dhe urbane në vitin 2003/04 ka qenë rreth 20 për qind dhe ka rënë në rreth 10 për qind në 2005/06. Për arsimin e lartë, ky dallim ka qenë rreth 15% gjatë viteve 2003/04 dhe 10 gjatë 2005/06.

Ilustrimi 3.4: Shkalla neto e regjistrimeve në arsim



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

E. Pse janë të varfër njerëzit dhe kush është në rrezik nga varfëria?

3.16 Diskutimi paraparak ka trajtuar trendët e varfërisë dhe profilin e të varfërve në mes të viteve 2003 dhe 2005. Ekzistojnë dy arsye për të zgjeruar analizën përtej shikimit në trende dhe profile. Fillimisht, sipas përkufizimit profili i varfërisë është një korrelacion i thjeshtë në mes të karakteristikave të vrojtuarra dhe statusit të varfërisë. Këto korrelacione nuk na bëjnë të ditur efektin e pavarur të karakteristikave të vrojtuarra që është në korrelacion me statusin e varfërisë. Si shembull, një korrelacion i lartë në mes të varfërisë dhe arsimit fillor shpesh nuk na tregon sa prej atij korrelacioni është rezultat i faktit se ata që kanë vetëm arsimim fillor gjithashtu kanë gjasa të jenë më tepër të papunësuar ose, edhe nëse janë të punësuar ata me siguri marrin paga më të ulëta. Prandaj ekziston nevoja për të kuptuar lidhshmërinë në mes të një karakteristike të vëzhguar dhe gjendjes të varfërisë, kur ndikimi i të gjitha variabëlve të tjera është “kapur” jashtë.

3.17 Arsyeja e dytë për të zgjeruar analizën është se një dokumentim i trendëve dhe profileve na e bën të njohur atë që ka ndodhur në të kaluarën, por jo edhe atë që ka gjasa të ndodh në të ardhmen. Natyrisht se modelet e kaluara na sigurojnë informata të dobishme për atë që mund të pritët në të ardhmen. Megjithatë, politikat e zvogëlimit të varfërisë janë më shumë të interesuara në atë që do të ndodh në të ardhmen. Për shembull, çka do të ndodh me rezultatet e varfërisë në popullsi nëse disa variabla (si për shembull, plleshmëria, arsimimi etj.) ndryshojnë nga modelet aktuale? Një eksperiment i tillë i kujdesshëm është shumë më interesant, posaçërisht nëse mund të ndikohet nga hartimi i politikave. Këto dy zgjerime forcojnë përmbajtjen e politikës së analizës së profileve.

3.18 Në këtë seksion, ne zgjerojmë analizën paraprahe në këtë drejtim. Fillimisht ne vlerësojmë një model të konsumit me qëllim të kuptimit të madhësisë së mungesës së konsumit për ekonomitë familjare me karakteristika specifike. Kjo fazë e parë nënvizon variablat të cilat sqarojnë ndryshimet e vërejtura në konsum. Natyra e shumëllojshme e modelit do të thotë se ne mund të përfundojmë madhësinë e mungesës e cila i është ngarkuar një variable specifike të interesit. Në hapin e dytë ne vlerësojmë probabilitetin e rënies së një ekonomie familjare me karakteristika të tilla në varfëri, duke marrë parasysh konsumin e tyre të parashikuar dhe mospërputhjen në konsumin e tyre (që është nga pjesa e pasqaruar e konsumit). Hapi i tretë është që të zgjidhen disa variabla në interes të politikave, që të ndryshohen vlerat e tyre dhe të parashikohen madhësitë e mundshme të ndryshimit në shkallën e varfërisë (për një diskutim komplet të metodave, shih El-laithy, Lokshin dhe Banerji, 2003). Rezultatet e varfërisë së shumëllojshme janë në përputhje me rezultatet paraprahe. Tabela B.49 paraqet rezultatet e modelit të konsumit në mënyrë të veçantë për secilin vit.

3.19 Fillimisht, variablat kryesore demografike duket të jenë struktura e ekonomisë familjare dhe fati i anëtarëve të familjes në tregun e punës. Ekonomitë familjare me më shumë anëtarë të varur kanë rreth 10 për qind më pak konsum, dhe ky dallim ka qenë i njëtrajtshëm gjatë kësaj periudhe, përderisa ekonomitë familjare me më shumë anëtarë të papunësuar kanë 4 deri në 8 për qind më pak konsum. Në anën tjetër, pasi që ekzaminojmë karakteristikat e tjera të dukshme, ekonomitë familjare me kryefamiljare

deri në një farë mase nuk duket të kenë më pak konsum se sa familjet me kryefamiljar. Në fund, ekonomitë familjare me kryefamiljar serb duket të raportojnë më pak konsum në vitet e fundit, duke treguar kështu se situata e tyre mund të jetë keqësuar (por shih Rubrikën 3.1).

3.20 Së dyti, lidhja e matur në mes të arsimimit dhe konsumit është në përputhje me rezultatet nga profili i varfërisë. Për të shikuar efektin e arsimimit në konsum, ne përdorim arritjen më të lartë arsimore në ekonominë familjare, e jo atë të kryefamiljarit, sepse mendojmë se ajo e para i shpjegon më mirë kushtet e ekonomisë familjare. Modeli e përdor arsimin e mesëm si grup krahasues. Rezultatet tregojnë se të gjitha ekonomitë familjare të cilat arsimimi më i lartë i arritur është ai fillor ose edhe më pak, kanë të paktën 12 për qind më pak konsum, përderisa ato të cilat arsimi më i lartë i arritur është ai profesional ose i lartë kanë të paktën 12 për qind më shumë konsum.

3.21 Së treti, profili i varfërisë ka dëshmuar se punëtorët ditor kanë një nga shkallët më të larta të varfërisë. Rezultatet në Tabelën B.49 konfirmojnë se ekonomitë familjare të cilat burimi kryesor i të hyrave është pagesa “me mëditje” kanë rreth 33 për qind më pak konsum se sa familjet të cilat burimi kryesor i të hyrave janë paratë e dërguara nga diaspora. Veç kësaj, ne kemi ardhur në përfundim se ato familje të cilat burimi kryesor i të hyrave është ndihma sociale kanë mungesë gati më të madhe të konsumit në krahasim me ato që varen nga paratë e dërguara nga diaspora.

3.22 Në fund, pasi që kontrollojmë lokacionin, kapitalin njerëzor dhe karakteristikat demografike të ekonomisë familjare, ne zbulojmë se familjet urbane deri në një farë mase nuk kanë konsum më të lartë se sa familjet rurale. Megjithatë, rezultatet konfirmojnë se familjet urbane kanë përmirësuar konsumin me kalimin e kohës siç e kemi vërejtur në zhvillimin e varfërisë. Në vitin 2003, ekonomitë familjare urbane kanë pasur rreth 11 për qind më pak konsum se sa ato rurale, e cila nuk ekziston në vitin 2005. Në baza regionale Mitrovica, Gjakova dhe Ferizaj kanë 18 deri 20 për qind më pak konsum se sa Prishtina, ndërsa Gjilani ka 20 për qind më shumë.

3.23 Në fazën e dytë të analizës sonë të zgjeruar ne përdorim konsumin e parashikuar nga modeli i mësipërm i konsumit bashkë me pjesën e pasqaruar të konsumit (kushti i gabimit) për të siguruar probabilitetin e rënies në varfëri për secilën familje. Ne mund të gjejmë një mesatare të këtyre probabiliteteve nëpër grupe (p.sh arsim fillor, rural etj.) me qëllim të sigurimit të probabilitetit mesatar të të qenit të varfër për atë grup. Në të vërtetë kjo bëhet rreziku mesatar i rënies së një grupi në varfëri. Pastaj mund të përdorim të njëjtin model që të shohim se si një ndryshim në një variabël të politikës e ndryshon rrezikun e rënies në varfëri. Tabela 3.5: **Ndikimi i ndryshimeve në karakteristikat e ekonomive familjare në varfëri (në pikë përqindjepërmbledh rezultatet duke përdorur të dhënat e vitit 2005.**

3.24 Shtylla e parë në Tabela 3.5: **Ndikimi i ndryshimeve në karakteristikat e ekonomive familjare në varfëri (në pikë përqindjedisa eksperimente me politikat.** Për variablat demografike, duhet të shtrohet pyetja se çka do të ndodhte me rrezikun nga varfëria nëse ekonomitë familjare me kryefamiljare kanë të njëjtat mundësi sikurse familjet me kryefamiljar. Një tjetër përpiket të parashikojë ndryshimet në varfëri nëse numri i

personave të varur do të zvogëlohej në ekonomitë familjare të cilat proporcioni i të varurve është më i lartë se sa mesatarja. Pasi që arsimit fillor është i përgjithshëm, pyetjet më interesante të politikave përqendrohen në ndryshimet në rrezikun e varfërisë po që se arsimit i mesëm bëhet i përgjithshëm ose u ofrohet edhe pjesës më të varfër. Grupi i fundit i pyetjeve ka të bëjë me atë se si rreziku i varfërisë mund të ndryshoj po që se popullsia rurale ka të njëjtat mundësi si ajo urbane, si dhe nëse të gjitha rajonet kanë të njëjtat mundësi sikurse që i ka Prishtina. Një diskutim mbi politikat specifike që mund të kërkohet për të realizuar këto eksperimente të kujdesshme nuk është i trajtuar në këtë raport. Është e mjaftueshme që të mendohet se cili do të ishte ndikimi i mundshëm në rrezikun varfërisë nëse do të arriheshin këto synime.

3.25 Shtylla e dytë e Tabela 3.5 paraqet manifestimin e varfërisë për grupin e synuar nga ndryshimi i politikës, siç është llogaritur në profilin e varfërisë. Kjo mund të mendohet si një probabilitet empirik i varfërisë për grupin. Shtylla 3 është probabiliteti i parashikuar duke përdorur modelin e konsumit, dhe siç tregojnë rezultatet ekziston një ngjashmëri e afërt në mes të dyjave. Shtylla 4 tregon se çka do të ndodhte me probabilitetin e parashikuar e të qenit të varfër nëse do të arriheshin ndryshimet politike në shtyllën 1, duke përdorur kufirin absolut të varfërisë. Tri shtyllat e fundit e bëjnë të njëjtën gjë për varfërinë e skajshme.

3.26 Politikat të cilat përmirësojnë mundësitë në rajonet e prapambetura, që përmirësojnë qasjen në arsimin e mesëm dhe që krijojnë mundësi punësimi e kanë ndikojnë shumë në zvogëlimin e rrezikut nga varfëria. Rreziku nga varfëria do të zvogëlohej për rreth 15 për qind nëse tri rajonet Gjakova, Mitrovica dhe Ferizaj, të cilat së bashku përbëjnë 40 për qind të popullsisë, do të zhduknin dallimin e tyre me Prishtinën. Kjo do të ishte njëjtë si të zvogëlohej shkalla kombëtare e nivelit të varfërisë në vitin 2005 nga 45 në 36 (që është $45 - 0.4 * 15$). Po të kryenin shkollën e mesme të gjithë personat që e kanë kryer shkollën fillore, rreziku i varfërisë për atë grup do të zvogëlohej për 10 për qind. Zvogëlimi do të ishte edhe më i madh nëse i njëjti grup do të kryente edhe shkollimin e lartë. Megjithatë, nuk parashikohet ndonjë ulje e rrezikut të varfërisë po që se pesë përqindëshi më i varfër e kryen arsimin e mesëm. Kjo nuk do të thotë se arsimit i mesëm nuk është i rëndësishëm ose relevant për këtë grup. Kjo vetëm nënkupton se në kushtet specifike, intervenime të tjera mund kishin ndikim më të madh. Një zvogëlim prej 10 për qind në numrin e të papunësuarve në secilën ekonomi familjare do të ulte rrezikun nga varfëria për 6 për qind.

3.27 Si përfundim, ky Kapitull ka treguar tendencë që të varfrit jetojnë të përqendruar në ekonomitë familjare që janë të mëdha, që kanë moshë më të vjetër, më shumë anëtarë të varur, më shumë të papunë dhe që gjenden në rajonet rurale, ndërsa nga aspekti regjional, në Mitrovicë dhe Ferizaj. Kapitulli gjithashtu ka shikuar përcaktorët e rrezikut nga varfëria, ose faktorët të cilët i rrisin gjasat e rënies në varfëri. Ka gjetur se suksesi i anëtarëve të familjes në tregun e punës, struktura demografike (proporcioni i varshmërisë), arsimit dhe regjioni i banimit janë faktorët më të rëndësishëm. Posaçërisht, eksperimentet në politika tregojnë se politikat të cilat krijojnë vende të punës, që përmirësojnë mundësitë në rajonet e izoluar dhe që ngritin arritjet arsimore të popullsisë kanë efektet më të mëdha në uljen e rrezikut nga varfëria.

Tabela 3.5: Ndikimi i ndryshimeve në karakteristikat e ekonomive familjare në varfëri (në pikë përqindje)

	Shkalla absolute e varfërisë	Probabiliteti parashikuar i të qenit i varfër absolut	Ndryshimi në probab e parashikuar në të qenit i varfër absolut	Shkalla e skajshme e varfërisë	Parashikimi i probabilitetit të qenit në varfërinë e skajshme	Ndryshimet në shkallën e varfërisë së skajshme
Karakteristikat demografike						
Familjet me kryefamiljare femra ndaj atyre me kryefamiljar meshkuj	49	44.6	-0.9	18.4	20.6	-0.6
Proporcioni i te varurve më i madh se mesatarja	49.1	47.4	-4.3	18.9	47.4	-3
Proporcioni i te varurve me i madh se mesatarja reduktuar për 25 për qind	49.1	47.4	-7	18.9	21.2	-4.8
Arsimi (arsimi max në ekonominë familjare)						
Ndryshimi arsim fillor në të mesëm	64.2	62.2	-10.1	28.5	33.2	-8.4
Ndryshimi në arsim të mesëm për grupin më të varfër	100	67.9	-2.6	83.5	39.1	-3.3
Ndryshimi arsim fillor në terciar	64.2	62.2	-27.4	28.5	33.2	-19.9
Karakteristikat e tregut të punës						
Një më pak i papunë në EF	47.7	48.3	-1.3	18.7	21.5	-0.9
10% më pak papunësi	47.7	48.3	-5.9	18.7	21.5	-3.9
Dimensionet hapësinore (urbane dhe Prishtina janë referencë)						
Rural	49.2	47.9	-1.5	18.1	21.4	-1
Gjakova	45.3	46.7	-13.2	13.5	19	-7.4
Gjilani	23.5	24.1	14.1	5.4	8.1	7.3
Mitrovica	69.7	65.3	-16.4	33.5	35.3	-13.7
Peja	40.1	37	-3	18.7	13.6	-1.6
Prizreni	40.5	42.9	-2.2	10.2	16.3	-1.3
Ferizaj	54.4	53.8	-14.7	21.6	25.5	-9.8

Burimi: Llogaritjet e Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it. Vëreni se ndryshimet në shkallën e varfërisë së skajshme për ekonomitë familjare më arsimin më të lartë “Aspak, nuk di të lexoj/shkruaj” është më i lartë se sa shkalla e vërejtur e varfërisë për shkak se ndryshimi = rrezikun e parashikuar të varfërisë – rrezikun e simuluar të varfërisë dhe i parashikuari në këtë rast është më i lartë se sa ai i vërejtur.

KAPITULLI 4. TRANSFERET PUBLIKE, PARATË E DËRGUARA NGA DIASPORA DHE VARFËRIA

Programet e mbrojtjes sociale në Kosovë kanë një mbulim të ulët, por programet e tyre të ndihmës sociale, më saktë programi kundër varfërisë është mjaft i qëlluar. Megjithatë, madhësia modeste e programeve dhe përfitimet e njëjta për një ekonomi familjare që i merr ato me kalimin e kohës ka rezultuar me një ndikim modest në varfëri. Rezultatet me transferet private janë të ndryshme. Fillimisht, krahasuar me mbulimin e programeve të mbrojtjes sociale, kryesisht ka më shumë ekonomi familjare që kanë persona në emigracion dhe që pranojnë para nga ta. Së dyti, ndikimi i emigracionit dhe parave të dërguara nga ai në mirëqenie ka qenë i madh. Në zonat rurale, ndryshimet e vlerësuara në rezultatet e varfërisë në mes të ekonomive familjare që kanë emigrantë dhe të atyre që nuk kanë është gati 20 për qind. Megjithatë, emigracioni gjithashtu ka mundur të kontribuojë në pabarazinë e konstatuar në zonat rurale.

4.1 Diskutimi i gjertanishëm ka theksuar se rreth 45 për qind e popullsisë në Kosovë kanë jetuar në varfëri në mes të viteve 2003 dhe 2005, dhe rreth 15 për qind kanë qenë në varfëri të skajshme. Një pjesë e konsiderueshme mbetet në rrezik nga keqësimet më të vogla të ekonomisë. Për më tej, me kalimin e kohës, përderisa e njëjta pjesë vazhdon të mbetet e varfër, pabarazia është zgjeruar. Në këtë kontekst, një sistem i përballeshëm i mbrojtjes sociale që ka një shtrirje të gjerë dhe që është mirë i planifikuar mund të bëhet instrument thelbësor për të ndihmuar të varfrit dhe që popullsia në rrezik të mbrohet nga varfëria e madhe.

A. Përbërja dhe trendet e transfereve të mbrojtjes sociale

4.2 Sistemi aktual i mbrojtjes sociale përbëhet nga një sistem pensionesh bazë i cili ka tri shtylla, skema speciale për invalidët e luftës dhe të afërmit e tyre, pensionimin e hershëm për minatorë në mënyrë që të shpejtohet ristrukturimi i sektorit, përfitimet për të paaftët për punë, ndihma sociale, programet për ndihmë në punësim dhe subvencionet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për grupet që konsiderohen si të rrezikuara (Banka Botërore, 2006a).

4.3 **Pensionimi bazë** është një pagesë mujore fikse që është në dispozicion për të gjithë banorët e Kosovës dhe refugjatët kosovarë të cilët jetojnë jashtë territorit, të cilët janë të moshës 65 vjet dhe sipër, pavarësisht nga kontributet paraprake. Ky përfitim është caktuar që të jetë i barabartë me kufirin e varfërisë së skajshme (shportën ushqimore) dhe është rregulluar në baza vjetore që të pasqyrojë ndryshimet në çmime. Pensionet nuk janë të synuara për familjet e varfra. **Ndihmat sociale** janë të planifikuara mirë për ekonomitë familjare të varfra dhe skajshmërisht të varfra. Kjo skemë ka filluar të zbatohet në vitin

2002 dhe është korigjuar në dhjetor të vitit 2003. Ata që kanë të drejtë të marrin këtë lloj ndihme ndahen në dy kategori: (1) familjet pa burime të ardhurash ku askush nuk është i aftë për punë, ose nuk pritet që të filloj punë (nënat e vetme, fëmijët); dhe (2) familjet me të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare ose që kujdeset për ndonjë bonjak nën moshën 15 vjeçare. Në kategorinë e dytë, anëtarët e tjerë të ekonomive familjare të cilët kanë mundësi që të punojnë nuk janë të pranueshëm pasi që atyre u duhet të regjistrohen si të papunë. Për më tepër, familjet që kanë të drejtë në këtë ndihmë nuk duhet të posedojnë pasuri të cilat sjellin të ardhura dhe që kalojnë 0.5 hektar tokë. Gjithashtu, nëse familjet e që kualifikohen për këtë ndihmë kanë burime të jashtme të parave të gatshme që tejkalojnë shumën e ndihmës sociale, atëherë ata nuk do t'i marrin këto ndihma, por nëse burimi i jashtëm është më i ulët se ndihma sociale, atëherë ata do të marrin diferencën (Banka Botërore, 2006a).

4.4 Të dhënat e ABEF-it të përdorura në këtë raport nuk e bëjnë dallimin në mes të llojeve të ndryshme të pensioneve ose programeve të ndihmës sociale. Megjithatë, është e rëndësishme që të theksohet se mbi 75 për qind e sistemit të mbrojtjes sociale i është dedikuar pensionit bazë (tri shtyllat) dhe ndihmës sociale. Edhe pse programi i pensionimit të hershëm për sektorin e minierave pritet që të zgjerohet në mënyrë të theksuar krahasuar me nivelin e saj në vitin 2003, ai ende paraqet një pjesë të vogël të sistemit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale. Prandaj, duhet pasur parasysh se shumica e konkludimeve të dhëna këtu me siguri që aplikohen në dy programet më të mëdha. Tabela 4.1 raporton zhvillimin e numrit të marrësve dhe të përfitimeve të përgjithshme nga pensionet dhe programet e ndihmës sociale sipas të dhënave administrative dhe të anketave. Të dy burimet e tregojnë të njëjtin rrëfim.

Tabela 0.1: Programet pensionale dhe të ndihmës sociale, numri zyrtar dhe i vlerësuar nga ABEF të ekonomive familjare përfituese dhe vlera totale e paguar

1. Numri i përfituesve:	2002	2003	2004	2005	2006	2007
A: Pension						
Shifrat zyrtare		116,387	143,045	158,600	169,000	171,400
Vlerësimet ABEF		68,307	115,871	111,200	127,742	
B: Ndihma sociale						
Shifrat zyrtare	52,329	50,724	46,441			
Vlerësimet ABEF	28,917	36,088	45,420	43,356		
2. Përfitimet: Pagesat totale, në 000 Euros)						
A: Pension						
Shifrat zyrtare		49,495	61,572	84,711	86,268	89,450
Vlerësimet ABEF		67,799	68,277	70,052	72,788	
B: Ndihma sociale						
Shifrat zyrtare	32,293	32,217	32,480			
Vlerësimet ABEF	19,615	26,323	34,880	33,048		


Burimi: Shifra të MPMS-së nga SHISHP (2006) dhe llogaritjet e Bankës Botërore nga ABEF 2002/2006. Shënim: ¹ Numri i individëve. ²Numri i ekonomive familjare. ³ Në mijëra euro. Shënim: shifrat zyrtare të MPMS për vitet 2002-2004 janë ekzistuese dhe të parashikuara për vitet 2005-2007. Pagesat e vlerësuara ABEF janë në çmime reale në Euro 2002. Në të dhënat e ABEF, pensionet janë të pleqërisë, për personat e paaftë dhe për invalidët e luftës

4.5 **Fillimisht, sistemi i mbrojtjes sociale është zgjeruar me shpejtësi, por ky zgjerim duket se është duke u ngadalësuar.** Të dy burimet e të dhënave tregojnë një

rritje të madhe të numrit të përfituesve në mes të viteve 2003 dhe 2006, dhe pastaj një ngadalësim. Të dhënat administrative tregojnë se numri i përfituesve të pensioneve është shtuar për 6 për qind për vit në mes të viteve 2004 dhe 2006, përderisa vlerësimet ABEF-it vlerësojnë një rritje vjetore prej 3 për qind gjatë periudhës së njëjtë. Për krahasim, numri i pranuesve të ndihmës sociale kur shikohen të dhënat administrative është vlerësuar të ketë zbritur nga rreth 52,000 në rreth 46,000. ABEF-it gjithashtu vlerëson se rreth 46,000 përfitues të ndihmës sociale në vitin e fundit, çka mund të jetë rezultat i zgjerimit të mëhershëm.

4.6 Së dyti, vlera e përfitimeve për familje familjet pranuese ka mbetur e njëjtë me kalimin e kohës.

Ilustrimi 0.1 paraqet trendet në përfitimet e vlerësuara te familjet pranuese. Përsëri, përveç ndoshta vlerësimeve të pensioneve për vitin 2003, të dhënat administrative dhe të dhënat e anketave tregojnë nivele dhe trende të ngjashme të përfitimit. Në përgjithësi, pensionet për familje përfituese duket të jenë më të ulëta se sa përfitimet nga ndihmat sociale për familje pranuese. Për më tepër, të dy programet nuk tregojnë ndonjë zhvillim në përfitimet për ekonomitë familjare marrëse në mes të viteve 2003 dhe 2006.




4.7 Në fund, shpenzimet e mbrojtjes sociale të Kosovës janë më të ulëta se sa ato të programeve të ngjashme publike në rajon.

Ilustrimi 0.2 tregon pjesën e programeve të mbrojtjes sociale në përqindje të BPV-së dhe shpenzimet totale qeveritare në disa vende të Evropës Juglindore – dhe në shtetet me zhvillim të lartë me të hyra mesatare nga regjionet e tjera. Qoftë nëse dikush zgjedh të shikoj përqindjen e BPV-së ose pjesën e shpenzimeve të qeverisë, programet e mbrojtjes sociale të Kosovës janë më të ulëtat. Kjo reflekton kufizimet si ekonomike ashtu edhe fiskale. Baza e të hyrave është e kufizuar si rezultat i zhvillimit të ulët ndërsa mundësitë e huamarrjes janë të kufizuara.

4.8 Evolucion i shpenzimeve të mbrojtjes sociale duhet të shikohet në kontekst të historisë së kohëve të fundit të Kosovës. Zgjerimi fillestar ka qenë i motivuar nga numri i madh i popullsisë që është gjendur në gjendje të vështirë si pasojë e konfliktit dhe çrregullimet ekonomike. Vetëm në pensione, ekzistojnë programe speciale për invalidët e luftës, personat e paaftë (pa dyshim pjesërisht për shkak të konfliktit) dhe pensionistët e parakohshëm të minierave. Ka dëshmi se lista e marrësve të pensionit të paaftësisë është zgjeruar shumë që nga viti 2004 (Banka Botërore, 2006a). Megjithatë, aktualisht dhe në të ardhmen e afërme, përderisa nevoja për mbrojtje sociale mund të jetë e madhe duke marrë parasysh rezultatet e varfërisë, zgjerimi do të kufizohet nga një përcaktim i kufizuar i buxhetit. Kjo do të thotë se programet ekzistuese të mbrojtjes sociale duhet të jenë mirë të planifikuara dhe efikase me qëllim që të kenë ndikim më të madh në rezultatet e varfërisë.

Ilustrimi 0.2: Shpenzimet e mbrojtjes sociale, vende të zgjedhura: 2004



Burimi: Banka Botërore, 2006a, dhe baza e të dhënave për shpenzime publike ECA Banka Botërore. Shifrat për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kroacinë janë të bazuara në vlerësimet zyrtare të BPV që nga 3/21/2007.

B. Ndikimi i programeve të mbrojtjes sociale në varfëri

4.9 **Tipari kryesor i programeve të mbrojtjes sociale është mbulimi i ulët.** Paneli kryesor në tabelën 4.2 përmbledhë pjesën e llogaritur të popullsisë që përfiton pensione dhe ndihmë sociale. Ndihmë sociale marrin rreth 13 për qind e popullsisë dhe kjo nuk ka ndryshuar me kalimin e kohës. Për më tepër, ajo mbulon pjesë të barabarta të popullsisë urbane dhe rurale. Programi mbulon vetëm 33 për qind të një të pestës së popullsisë më të varfër dhe një 16 për qindësh shtesë të një të pestës së dytë më të varfër. Modeli i mbulimit do të thotë se vetëm rreth 23 për qind e të varfërve dhe rreth 34 për qind e atyre në varfëri të skajshme është e përfshirë në programin e ndihmës sociale. 6 për qind e popullsisë përfitojnë lloje të ndryshme të pensioneve. Shpërndarja e përfshirjes nëpër rajonet urbane/rurale dhe nëpër grupe të ndryshme është gjithashtu e ngjashme, siç edhe duhet të jetë, pasi që ka kritere të shumëfishta për plotësimin e kushteve pensionale.

Tabela 0.2: Ndihma sociale dhe pensionet: mbulimi dhe shkalla sipas rajoneve urbane/rurale dhe grupeve, përqindja e individëve

	<i>Ndihma sociale</i>		<i>Pensionet</i>	
	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>
Mbulimi (% e popullsisë)	11.2	13.2	5.8	6.4
Urbane	9.7	11.1	5.7	6.3
Rurale	11.9	14.4	5.8	6.4
Një e pesta më e varfër	28.9	32.6	4.5	7.1
Një e pesta 2	13.2	16.2	7.1	6
Një e pesta 3	9.2	9.6	5.8	6.5
Një e pesta 4	3.3	3.8	6.7	6
Një e pesta më e pasur	1.3	3.9	5.1	6.4
Shkalla e përfitimeve (shpërndarja e marrësve)	100	100	100	100
Urban	34.4	31.7	34.4	34.5
Rural	65.6	68.3	65.6	65.5
Një e pesta më e varfër	46.2	49.6	15.7	22.2
Një e pesta 2	24.2	22.1	23.9	18.9
Një e pesta 3	18.1	13.8	19.5	20.3
Një e pesta 4	8.2	7.9	23	18.8
Një e pesta më e pasur	3.3	6.6	18	19.9

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it. Pensionet përfshijnë të gjitha llojet e pensioneve (bazë, të paaftësisë, të invalidëve të luftës, etj)


4.10 **Dhe planifikim shumë i mirë i programit të ndihmës sociale.** Paneli i fundit në tabela 4.2 tregon shpërndarjen e përfituesve, që është lokacioni i popullsisë marrëse në hapësirë (urban/rural) dhe klasifikimi i mirëqenies (grupet sipas konsumit). Fillimisht, vërejmë se nuk ka anim në mes të popullsisë urbane dhe rurale. Grupet e përfituesve në rajonet urbane dhe rurale janë në përputhje me pjesët e popullsisë urbane dhe rurale. Pasi që mbi dy të tretat e të varfërve jetojnë në rajonet rurale, ata janë gjithashtu në përputhje me shpërndarjen e të varfërve. Fondet e përdorura kanë qenë pak më të ulëta në rajonet rurale – gjatë 2003/04 rreth 23% e përfituesve të mbrojtjes sociale nuk kanë qenë të varfër në krahasim me 11% në rajonet urbane—por aktualisht është e barabartë me atë urbane në rreth 22 për qind (Ilustrimi D.1). Së dyti, gati 70 për qind e përfituesve janë të varfër, dhe gati vetëm 6 për qind janë në pjesën më të pasur. Së treti, duke marrë parasysh se një pjesë e madhe e popullsisë është në gjendje të rëndë, rezultatet në Tabelë sugjerojnë se gati 90 për qind e përfituesve janë ose të varfër ose në gjendje të rëndë, çka tregon një efikasitet të shkëlqyeshëm të planifikimit. Për më tepër, për shkak se klasifikimi i mirëqenies është bërë në konsum ajo nuk përjashton përfitimet e ndihmës sociale të përdorura për konsum, efikasiteti i planifikimit me siguri që është edhe më i mirë se sa që është raportuar këtu.

4.11 Madhësia modeste e nivelit të përfitimit dhe mbulimi i ulët i programeve të mbrojtjes sociale propozojnë se programet e mbrojtjes sociale kanë pasur ndikim të ulët në mirëqenie. Në mungesë të ndihmës sociale, varfëria do të ishte më e lartë për rreth 2 pikë të përqindjes. Në mungesë të pensioneve do të ishte edhe më e lartë për rreth 4 pikë të përqindjes (Tabela 4.3). Duke supozuar se nuk ka një përzierje në mes të pensioneve

dhe përfituesve të ndihmës sociale, simulimet tregojnë se varfëria është zvogëluar për rreth 6 pikë përqindje (ose 14 për qind). Ngjashëm, në mungesë të ndihmës sociale ose pensioneve, varfëria e skajshme do të ishte më e lartë për 4 dhe 5 pikë përqindje (rreth 40 për qind). Në mes të këtyre dy programeve, ndikimi më i madh në zvogëlimin e varfërisë ka ardhur nga pensionet. Simulimi i shkallëve të varfërisë me dhe pa programe të mbrojtjes sociale tregon se programet nuk kanë pasur ndikim në vendimet e ekonomive familjare përfituese, posaçërisht për sa i përket furnizimit me punë. Shpjegimi për këto ndryshime në sjellje do të komplikonte analizat dhe është jashtë fushës së këtij raporti. Me siguri që do të çonte drejt një ndikimi edhe më të ulët të programeve se sa që është thënë këtu. Megjithatë, simulimi i shpejtë është i dobishëm për të matur madhësinë potenciale të ndikimit, edhe nëse ato mund të pasqyrojnë ndikimin më të lartë të mundshëm (kufirin më të lartë).


Ilustrimi 0.3: Efektshmëria e objektivave e programit për ndihmë sociale të Kosovës

A. Mbulimi i dobët dhe humbjet e ndihmës sociale



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF. Mbulimi i dobët është përqindja e individëve që janë të varfër (ose në varfëri të skajshme) por që nuk janë të mbuluar. Humbja është përqindja e individëve marrës që nuk janë të varfër.

B. Përqindja e fondeve që i shkojnë një të pestës më të varfër në vendet me të ardhura të ulëta (VAU) dhe ato me të ardhura mesatare (VAM)



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF dhe Banka Botërore 2005.

Tabela 0.3: Përshtatshmëria dhe simulimi i transferit të ndihmës sociale dhe pensionit


	<i>Ndihma Sociale</i>		<i>Pensionet</i>	
	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>	<u>2003/04</u>	<u>2005/06</u>
<i>Përshtatshmëria</i>				
Transferi mujor mesatar i EF (2002 Euro)	60.8	63.5	64.4	63
<i>Shkallët e varfërisë para dhe pas transferit ,në % të individëve</i>				
Gjendja aktuale/pas-transferit				
Shkalla e varfërisë absolute	43.5	45.1	43.5	45.1
Shkalla e varfërisë së skajshme	13.6	16.7	13.6	16.7
Simulimi para-transferit				
Shkalla absolute e varfërisë	44.9	46.5	47.6	49.6
Shkalla e varfërisë së skajshme	17.2	20	18.6	21.7

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore duke përdorur të dhënat e ABEF-it 2002/06. Konsumi para-transferit është llogaritur në bazë të supozimit prej 100% të prirjes marginale të konsumit të transferit. Konsumi para-transferit është i barabartë me konsumin aktual minus vlerën e transferim.

C. Sasia dhe shpërndarja e parave të dërguara nga diaspora

4.12 Programet zyrtare të mbrojtjes sociale janë të plotësuara dhe shpesh të mbështetura nga transferet private. Përderisa këto marrin shumë forma – transferet në mallra dhe shërbime dhe ato zyrtare për sigurime të ndërsjella në mes të ekonomive familjare shërbimet e punës sociale nga OJQ-të, përkrahjet e bazuara në lidhje familjare, dhe kështu me radhë - paratë e dërguara nga diaspora janë disa nga transferet më të mëdha dhe më të përhapura të këtyre transfereve. Kosova zë vendin e tretë për nga marrja e parave nga emigracioni që dërgohen në Ballkanin Perëndimor, ku klasifikimi është bërë si pjesë e parave të diasporës në BPV (Ilustrimi 4.4). Në botë ajo zë vendin e 11^{të} (Ilustrimi D.2). Për shkak se gati shumica e këtyre parave të gatshme shkojnë tek ekonomitë familjare, është e pritshme që ato të kishin një ndikim të madh në mirëqenien e ekonomive familjare. Edhe pse ABEF nuk grumbullon informata të hollësishme mbi emigracionin dhe paratë e dërguara nga ta rregullisht, ka bërë një modul mbi masën e emigrimit jashtë vendit dhe vlerën e parave të dërguara që kanë marrë ekonomitë familjare në Kosovë në vitin 2005. Ky seksion përdor këto të dhëna për të vlerësuar sasinë e parave të dërguara nga diaspora dhe ndikimin e tyre në varfëri.

Ilustrimi 0.4: Paratë e dërguara nga diaspora si pjesë e BPV-së në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Perspektivat Ekonomike Globale 2006: Ndikimet ekonomike të parave të dërguara dhe emigracionit, Banka Botërore.

4.13 Gati çereku i kosovarëve kanë emigrantë jashtë vendit. Numri i emigrantëve jashtë vendit është vlerësuar të jetë rreth 400,000, dhe është në përputhje me vlerësimet e pavarura të numrit të emigrantëve nga Kosova në vendet e OECD-së. Duke përdorur regjistrimin e popullsisë dhe të dhënat e anketimeve të mbledhura nga të gjitha shtetet e destinimit të OECD, Docquier dhe Marfouk (2006) kanë vlerësuar popullsinë e shpërngulur nga Serbia, Mali i Zi dhe Kosova të jetë rreth 2 milionë. Duke supozuar se shkallët e emigracionit janë të njëjta, dhe pastaj duke ndarë këtë total sipas pjesëve të popullsisë totale në Serbi, Mal të Zi dhe Kosovë, mendohet të jenë rreth 400,000 emigrantë nga Kosova². Shumica e emigrantëve vijnë nga rajonet rurale. Për shembull, përdërisa 1 në 3 banorë (30 për qind) në zonat urbane raportojnë se kanë emigrantë, gati 70 për qind e popullsisë rurale e kanë raportuar këtë gjë. Në aspektin regjional, gati 1 në 5 banorë në Mitrovicë, Prizren dhe Gjakovë ka raportuar të kenë emigrantë ndërkombëtarë (Tabela 4.4).

Tabela 0.4: Emigrimi dhe paratë e dërguara nga diaspora për vitin 2005

	E gjithë popullsia	EF me emigrant	EF që marrin para të dërguara
Shkalla e varfërisë	37.2	30.4	29.8
% e popullsisë	100	25.9	21.4
Shpërndarja urbane /rurale			
Urban	36.2	28.7	27.6
Rural	63.8	71.3	72.4
Shpërndarja rajonale			
Gjakova	11.5	17.1	15.5

² Popullsia e Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës është 8 milionë, 0.7 milion dhe përkatësisht 2 milionë, me një total prej 10.7 milion. Kjo do të thotë se pjesa e Kosovës është rreth 19 për qind të popullsisë totale $(=(2/10.7)*100)$. Kështu që pjesa migruese e saj është $0.19*2\text{ milion}=380,000$.

Gjilani	12	10.2	12.4
Mitrovica	15.1	20.6	20.4
Peja	11.2	13.2	11.3
Prizreni	15.7	18.1	20.1
Prishtina	23.3	13.2	12.2
Ferizaj	11.2	7.6	8.1
Gjithsej	100	100	100


Burimi Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e matura në ABEF-in e vitit 2005- të dhënat sipas popullsisë. Shënim; ¹E shprehur në euro sipas vitit 2002 dhe për banorë të rritur.

4.14 **Pjesa e popullsisë e cila merr para të dërguara nga diaspora është shumë më madhe sesa pjesa e popullsisë e cila është përfituese e ndihmës sociale.** Siç është shënuar në Tabelën 4.2, rreth 13 për qind e popullsisë është mbuluar nga programet e asistencës sociale. Për krahasim, rreth 20 për qind kanë marrë para të dërguara nga diaspora. Shpërndarja hapësinore e popullsisë marrëse e parave të gatshme imiton modelin e vrojtuar të prejardhjes së emigrantëve: mbi 70 për qind të marrësve jetojnë në rajonet rurale, ndërsa Mitrovica dhe Prizreni raportojnë të kenë pjesën më të madhe të popullsisë që pranon para të dërguara nga diaspora.

D. Ndikimi i emigracionit në varfëri

4.15 **Ekonomitë familjare me emigrantë ose që marrin para të dërguara nga emigracioni nuk duket të kërkojnë më shumë arsimim.** Gjykuar nga krahasimi i nivelit të regjistrimit në shkollë, nuk ka dëshmi se paratë e dërguara përdoren për investime në arsim. Ekziston një diferencë e madhe e vërejtur në shkallët e regjistrimit të popullsisë së përgjithshme dhe nën-popullsisë me emigrantë ose që pranojnë para nga diaspora për rajonet urbane, por jo për ato rurale. Regjistrimet përfundimtare në shkolla janë për rreth 10 për qind më të ulëta për nën-popullsitë me emigrantë ose për ata që pranojnë para nga diaspora në rajonet urbane (Ilustrimi D.1). Shkallë të ndara të regjistrimit për fëmijët meshkuj dhe femra gjithashtu konfirmojnë një shkallë më të ulët për nën-popullsitë me emigrantë ose ata që pranojnë para nga ata të dërguara në rajonet urbane (Ilustrimi 0.5: Shkalla e regjistrimit për ekonomitë familjare me emigrantë dhe pa emigrantë, 200). Megjithatë, duke krahasuar popullsinë e përgjithshme urbane me nën-popullsinë e banorëve urban me emigrantë, diferenca e papërpunuar mund të qoj në konkludime çorientuese se emigrantët zvogëlojnë shkallët e regjistrimit. Duke bërë një krahasim më të kujdesshëm, që është krahasimi i nën-popullsisë urbane me emigrantë me nën-popullsinë urbane pa emigrantë por të cilët kanë gati të njëjtat karakteristika të dallueshme, nuk tregon ndonjë dallim në shkallët e regjistrimit (Tabela 0.5).

Ilustrimi 0.5: Shkalla e regjistrimit për ekonomitë familjare me emigrantë dhe pa emigrantë, 2005



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

4.16 **Ekonomitë familjare me emigrant kanë konsum më të lartë.** Vlera mesatare e parave të dërguara është 2000 euro në vit, ndërsa mesatarja është më e lartë në 2600 euro. Vlera mesatare e parave të dërguara në rajonet rurale është rreth 2800 euro, në krahasim vlerën prej 1500 euro për rajonet urbane Tabela 0.6, (paneli A). Këto vlera janë rreth 3 herë më të larta se sa vlerat mesatare nga programet e mbrojtjes sociale në ekonomitë familjare marrëse të treguara në ilustrimin 4.1. Gjithashtu, përdorimi i raportuar i parave të dërguara nga diaspora tregon se këto të fundit përdoren shumë për konsum. Të dhënat e anketave tregojnë se nën-popullsia me emigrantë ose që marrin para të dërguara prej tyre ka 9 për qind më shumë konsum për të rriturit në muaj, por jo edhe konsum më të lartë në ushqim (Tabela 4.4).

Tabela 0.5: Rezultatet e Krahasimit të Prirjeve për Shkallët e Regjistrimit Sekondar

	<i>Rezultati: Shkallët e Neto Regjistrimit Sekondar.</i>	<i>Diferenca</i>	<i>T-stat</i>
Urban	I pakrahasueshëm	-0.09	-3.19
	Efekt i trajtimit mesatar për të trajtuarit (ATT)	-0.04	-0.93
Rural	I pakrahasueshëm	-0.03	-1.07
	Efekt i trajtimit mesatar për të trajtuarit (ATT)	-0.01	-0.12

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF për vitin 2005. Metoda e bazës së prirjeve ka përdorur anëtarin e vetëm më të afërt.


4.17 Duke krahasuar dallimet mesatare në konsum në mes të nën-popullatës me emigrantë dhe popullsisë së përgjithshme nuk është një tregues i saktë se pasja e një emigranti është ajo që ka sjell deri te diferenca. Është mjaft e mundshme se ekonomitë familjare me emigrantë dosido do të kishin një konsum më të lartë, ndoshta për arsye se ka diçka në këto ekonomi familjare që i bën ato të suksesshme e që të dhënat në anketë nuk e tregojnë. Kështu që një mënyrë për të vlerësuar dallimin në konsum është që të krahasohet nën-popullata me emigrantë me një nën-popullatë e cila nuk ka emigrantë por e cila ka të njëjtat karakteristika të dallueshme. Vlerësimi ka dy faza. Në fazën e parë, vlerësohet probabiliteti i të pasurit një migrues jashtë vendit në baza të karakteristikave të vrojtuar për atë familje duke përfshirë këtu arsimin, lokacionin, strukturën demografike e kështu me radhë, me qëllim që të arrihet prirja për të migruar (pra, baza e prirjes). Në

fazën e dytë, një ekonomi familjare me një migrues jashtë vendit është krahasuar me një familje tjetër pa migrues jashtë vendit por që ka të njëjtin probabilitet të pasjes së një emigranti të tillë (nëse nuk mund të bëhet një krahasim i saktë, atëherë një i përafërt).

4.18 Pasi që të bëhen krahasimet për të gjitha ekonomitë familjare me migrues jashtë vendit, llogaritet dallimi mesatar në konsum ose çfarëdo rezultati me interes. Strategjia e vlerësimit mund të bëhet në mënyrë të pavarur për zonat urbane dhe rurale siç bëhet në Kosovë. Ilustrimi D.4 tregon cilësinë e krahasimeve për Kosovën, si dhe nën-popullatat urbane dhe rurale. Rezultatet tregojnë se për ekonomitë familjare emigruese që është parashikuar të kenë një prirje të madhe për të emigruar, ato me prirje 50 për qind ose më tepër, nuk ka krahasime shumë të mira nga nën-popullata pa emigrantë. Për ata të cilët parashikohet të kenë prirje të ulët që të emigrojnë dhe që emigrojnë, ka krahasime shumë të mira.

Tabela 0.6: Paratë e dërguara nga diaspora në vitin 2005 sipas ekonomive familjare që i kanë marrë ato, para të gatshme dhe mallra ose shërbime për 12 muajt e fundit

A. Mesatarja e parave të diasporës dhe përdorimi i tyre		B. Mesatarja e parave të diasporës sipas grupeve në rajonet urbane dhe rurale	
	Paratë nga diaspora	Të gjitha ose pjesa e madhe	Pjesa e vogël
Përmbledhje	2603.2		
Mesatar	2000		
Urbane	2179.4		
Rurale	2805.7		
Të varfër	1487.1		
Të varfër të skajshëm	1341.6		
Përdorimi i parave të diasporës			
Konsumi		82.5	10.6
Artikujt e qëndrueshëm		1.7	0.9
Ndërtime shtëpiake		5.4	3.1
Kursimet		2.5	13.6
Të tjera		3.3	7.3



Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

4.19 **Rezultatet e krahasuara konfirmojë një dallim të rëndësishëm statistikor në konsum në mes të ekonomive familjare me emigrantë dhe atyre pa ta.** Rezultatet tregojnë se dallimi në konsum në mes të atyre me emigrantë dhe atyre pa ta, për popullsinë urbane është rreth 1.2 euro për të rriturit në muaj, gjë që për një familje mesatare do të thotë 8 euro më tepër konsum në muaj, ose një rritje në konsum që është 25 për qind e kufirit të varfërisë së skajshme. Dallimet në rajonet rurale janë pak më të mëdha. (Tabela D.4)

4.20 Në vend të krahasimit, mund të shikohen dallimet në konsum ndërmjet analizës së ndryshimeve, e cila ende vlerësohet për probabilitetin e pasjes së një emigranti. Ky

proces akoma i ka dy faza: së pari llogaritet probabiliteti i pasjes së një emigranti jashtë vendit, pastaj probabiliteti i parashikuar përfshihet në analizën e ndryshimeve të konsumit në të gjitha karakteristikat e vrojtuar. Rezultatet nga kjo përfshirje (vlerësimi IV) po ashtu konfirmon se ekonomitë familjare me emigrantë konsumojnë më shumë (Tabela D.3). Ndryshimi i konsumit kur familja ka një emigrantë është 0.17, që nënkupton se një familje që ka probabilitet të parashikuar prej 10 për qind më të lartë për të pasur një emigrant jashtë vendit do të vlerësohet se ka 2 për qind konsum më të lartë. Të gjitha këto tregojnë se ne duhet të presim të shohim nivel më të ulët të varfërisë, çka edhe e shohim).

4.21 Shkalla e varfërisë për nën-popullsinë me emigrantë ose të cilët pranojnë para nga diaspora është 7 për qind më i ulët se sa në popullsinë e përgjithshme (Tabela 4.4) Niveli është 13 pikë përqindje më i ulët në rajonet rurale, përderisa në ato urbane është 6 pikë përqindje më i lartë në ekonomitë familjare me emigrantë (Tabela D.2). Diferenca e madhe në rajonet rurale krahasuar me ato urbane mund të jetë për shkak se të varfrit ruralë pranojnë nivele më të larta të parave nga diaspora se sa të varfrit urbanë. Mesatarisht vlera e parave të diasporës që marrin ekonomitë familjare rurale është shumë më e lartë se sa vlera që marrin familjet urbane. Paratë e diasporës që marrin familjet rurale janë më të larta se sa ato të ato urbane në secilin grup, përveç në atë më të varfrit (tabela 4.6, **paneli B**). Duke krahasuar shkallët e varfërisë për mostrat e krahasuara shihet se niveli i varfërisë është 20 pikë përqindje më i ulët për ekonomitë familjare rurale me emigrantë dhe jo e ndryshme në aspektin statistikor për ekonomitë familjare urbane me emigrantë (tabela D.5).

4.22 Dhe në fund, paratë nga diaspora mund të shpjegojnë pjesërisht rritjen e pabarazisë në popullsi. Në përgjithësi vlera e parave nga diaspora të marra nga ekonomitë familjare të varfra është e ulët. Tabela 4.6 (paneli B) tregon se në zonat rurale, ekonomitë familjare më të pasura marrin vlera më të larta të parave nga diaspora se sa grupet më të varfra. Në zonat urbane, ka më pak divergjencë, posaçërisht në mesin e katër një të pestave më të ulëta. Ky model mund të sqaroj rritjet e theksueshme të vërejtura të pabarazisë në rajonet rurale krahasuar me ato urbane. Gjithashtu mund të tregoj se varfëria mund të reduktohet më tepër po të merrnin të varfrit vlera më të larta të parave nga diaspora.

4.23 Si përfundim, ky kapitull ka treguar mbulesën e dobët të programeve të mbrojtjes sociale, por orientimin e mirë të programit të ndihmës sociale për të varfrit. Kjo tregon se madhësia modeste e programeve ka treguar se ndikimi i tyre i përgjithshëm në varfëri ka qenë modest. Për krahasim, kapitulli bën të ditur se emigrimi ndërkombëtar dhe paratë e dërguara nga emigrantët kanë pasur një shtrirje më të gjerë dhe kanë ndikim shumë më të madh në mirëqenie, e shprehur si konsum ose si rezultat i varfërisë.

KAPITULLI 5. FORCIMI I THEMELIT TË MONITORIMIT TË VARFËRISË DHE HARTIMI I POLITIKAVE BAZUAR NË DËSHMI

ABEF-i ka krijuar themelin për monitorimin e varfërisë në Kosovë. Megjithatë ashtu siç është dizajnuar aktualisht ai ka tri dobësi. Fillimisht, niveli i saj i përfaqësimit nuk është i sigurt për shkak se nuk ka regjistrim të besueshëm të popullsisë të kryer kohën e fundit, i cili do të mund të përdoret si referencë. Së dyti, është joadekuate për të siguruar bazën për vlerësimin dhe monitorimin e të gjitha dimensioneve të mirëqenies, dhe së treti mbikëqyrja është joadekuate. Me qëllim të përmirësimit të kualitetit dhe besueshmërisë së anketave, rekomandohet që të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë, por në një periudhë afatmesme është vendimtare që të menaxhohet më mirë korniza e vjetër, të mirëmbahet tradita e moduleve të specializuara, të zgjerohet madhësia e mostrave dhe të investohet në mbikëqyrje.

5.1 Ky raport e shikon evoluimin e varfërisë në Kosovë në gjysmën e parë të kësaj dekade. Ai dokumenton se zhvillimi në këtë periudhë ka qenë i ulët. Pas një shqyrtimi të mjedisit ekzistues makroekonomik, ai ekzaminoj evoluimin e mirëqenies së popullsisë së Kosovës. Ai ka arritur në tri konkludimet kryesore. Fillimisht, përderisa dimensionet e mirëqenies që nuk bazohen bazuan të hyra kanë pasur rezultate përgjithësisht të favorshme, masat e të hyrave (ose konsumit) për mirëqenie kanë stagnuar. Ai në mënyrë të veçantë tregon se zhvillimi i konsumit ka qenë minimal, dhe aty ku ka qenë pozitiv, përfitimet i kanë shkuar kryesisht popullsisë urbane dhe një të pestës më të pasur të popullsisë. Së dyti, përveç se varfëria ekzistuese është shumë e përhapur, një pjesë e madhe e popullsisë rrezikohet nga ajo. Së treti, modeli i fitimit dhe humbjeve ka qar në një rritje të pabarazisë, edhe pse pabarazia e përgjithshme në Kosovë ende konsiderohet si e ulët.

5.2 Raporti gjithashtu ka dokumentuar një profil të të varfërve, dhe ka arritur në përfundim se të varfrit më shumë gjenden në ekonomitë familjare të mëdha, në ato familje që kanë më tepër të persona të varur dhe të moshuar, të papunë si dhe në familjet që jetojnë në zonat rurale. Në fund, raporti ka shqyrtuar edhe dy mekanizmat për mbrojtjen e familjeve nga mjerimi ekonomik – programet e mbrojtjes sociale dhe transferet private në formë të parave të dërguara nga emigrantët. Ajo ka ardhur në përfundim se madhësia modeste e programeve kundër varfërisë ka pasur vetëm një ndikim mesatar në varfëri, përderisa madhësia dhe shpërndarja e parave të dërguara nga diaspora ka pasur një ndikim shumë më të madh dhe më pozitiv në mirëqenien e popullsisë, veçanërisht në zonat rurale.

5.3 Sa i përket politikës, ajo argumenton duke u bazuar në diagnozën që ka të bëjë me modelin e varfërisë dhe me profilin e të varfërve se politikën që fokusohen në mbështetjen

e zhvillimit më të madh dhe më gjithëpërfshirës ngritin prodhimin rural dhe përmirësojnë aftësitë e popullsisë do të kenë ndikimin më të madh dhe më të qëndrueshëm.

5.4 Në qendër të kësaj dëshmie dhe konkludimi, me siguri që janë të dhënat e ABEF-it. ABEF-i siguron një bazë të fortë për monitorimin e varfërisë në Kosovë. Ajo ka elementet e një ankete të qëndrueshme: është një anketë thelbësore e ESK-së, plotësisht e financuar nga qeveria, e ka personelin përkatës (megjithëse të vogël) të përkrahur nga personeli teknik i partnerëve zhvillimor, dhe është zbatuar me sukses për çdo vit prej fillimit të aplikimit. Me fjalë të tjera, ABEF-i e ka potencialin që të jetë themel për monitorimin dhe vlerësimin e politikave. Vlerësimet e tilla mund të jenë të rëndësishme për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi. Megjithatë, ekziston një paqartësi që qëndron mbi rezultatet e këtyre anketave dhe në të vërtetë mbi të gjitha mikro-anketat në Kosovë. Që të jemi më specifik, ekzistojnë tri dobësi.

5.5 **Fillimisht, ekziston një pasiguri themelore për sa i përket asaj se çka përfaqësojnë mostrat.** Për shkak se nuk ka pasur një regjistrim të besueshëm të popullsisë për gati një çerek shekulli – i fundit ka qenë në vitin 1981 – nuk ka ndonjë shifër referuese të popullsisë me të cilat mund të verifikohen mostrat. Gjatë pesë viteve të kaluara personeli i ESK-së ka azhurnuar 400 nga 3400 rajonet origjinale të njehsimit të hartuara në vitin 1981, kështu që çdo vit fitohen informata të reja. Megjithatë pasiguria mbetet.

5.6 **Së dyti, ashtu siç është e dizajnuar ABEF-i është joadekuat që të siguroj një bazë për vlerësimin dhe monitorimin e të gjitha dimensioneve të rezultateve të varfërisë.** Anketa grumbullon të dhëna të hollësishme mbi shpenzimet, por çështjet mbi dimensionet e varfërisë që nuk bazohen në të hyra janë shumë të paqëndrueshme dhe të pamjaftueshme. Është e vështirë të monitorohen një varg rezultatesh të arsimit, shëndetësisë, shërbimeve komunale dhe të banimit. Përveç vështirësive në monitorimin e qasjes në shërbime dhe në programe specifike, ka vështirësi edhe në vlerësimin e përfitimeve nga programet specifike për shkak se nuk ka informata mbi përfituesit dhe jo-përfituesit. Personeli i ESK-së ka paraqitur module mbi temat specifike në secilin cikël të anketave. Një shembull specifik i një moduli të tillë është moduli i emigrimit në anketën e vitit 2005 që është përdorur për Kapitullin 4 të këtij raporti. Por modulet shpesh nuk janë financuar sa duhet, kështu që përmbajtja e tyre ndonjëherë nuk është e njohur dhe shpesh nuk janë të lidhura më çështjet e mëdha të politikave në Kosovë. Pastaj, përderisa është mirë që mostrat janë të shtresuara sipas rajoneve, zonave urbane dhe etnike, dhe në parim e bën të mundur marrjen e të dhënave statistikore në këto nivele, anketimi i 2400 ekonomive familjare që merren mostër çdo vit mund të jetë shumë i vogël. Për disa nivele të ndarjes, nën-mostrat mund të jenë shumë të vogla që të mundësojnë monitorimin e saktë të rezultateve.

5.7 **Në fund, gabimet moszgjidhjes së mostrave nuk janë aq të papërfillshme.** Gabimet kryesore të moszgjidhjes së mostrave mund të paraqiten në implementimin e anketës dhe në anën administrative. Ekzistojnë dy kufizime që paraqesin gabimet e moszgjidhjes së mostrave. Fillimisht, mbikëqyrja e punës në terren rrezikohet nga mbikëqyrja joadekuate. Për të parë shkallën e problemit, vëreni se ka vetëm tre anëtarë thelbësor të njësisë së ABEF-së dhe një mbikëqyrës në zyrën e Prishtinës. Ka rreth 40

numërues të cilët punojnë në ABEF dhe në anketime të tjera. Mungesa e personelit, fërkimet konstante, financimi i pamjaftueshëm dhe pa dyshim mungesa e kontrollit të punës në terren në rajonet serbe për shkak të tensioneve ekzistuese shoqërore, do të ndikojnë në cilësinë e informatave të grumbulluara. Së dyti, mungesa e përvojës në menaxhimin e anketimeve të mëdha dhe komplekse gjithashtu e komprometon cilësinë. Zbatimi i anketave komplekse nga fillimi deri në analizë është diçka relativisht e re në ESK dhe ka filluar vetëm para 5 viteve. Prandaj, që gjatë periudhës së mësimit pritet të ketë edhe gabime në cilësi.

5.8 Për të rregulluar këto probleme, propozohen pesë rekomandime.

- **Me siguri, veprimi më i rëndësishëm dhe më përfitues do të ishte që të bëhet regjistrimi i popullsisë.** Regjistrimi i popullsisë do të krijonte një kornizë të besueshme për anketimet e ardhshme dhe me disa përpjekje do të mundësonte tejkalimin e çfarëdo paragjykimi që mund të gjendet në anketat ekzistuese. Por aktualisht, nuk është e qartë kur do të bëhet një regjistrim i popullsisë. Në ndërkohë ende ka nevojë që të vazhdohet përmirësohet kualiteti i anketave aktuale. Përderisa përgatitjet dhe data përfundimtare për zbatimin e regjistrimit të popullsisë vazhdojnë, do të ishte e dobishme që të,
- Krijohet një mostër kryesore nga një listë më e vogël e rajoneve numëruese, siç është bërë në Bosnje dhe Hercegovina (shih Vëllimin II). Për momentin, një azhurnim i mostrës kryesore është caktuar për fillim të vitit 2007. Duke përdorur fotografimet satelitore, janë krijuar rreth 5,000 zona të reja numërimi, prej të cilave rreth 1,000 do të shënohen në listë (numri i ekonomive familjare do të vlerësohet pas vizitës).
- **Përmirësimi i menaxhimit të azhurnimit të kornizës ekzistuese.** Aktualisht nuk ka një dokumentacion të qartë se si bëhet ri-regjistrimi i 400 ZN-ve të zgjedhura çdo vit ose si dhe në cilën fazë të procesit përdoren informatat. Krijimi i një njësie për mostra/metodologji me personel të përshtatshëm mund të ndihmojë në këto përpjekje.
- **Vazhdimi i traditës së paraqitjes së moduleve të specializuara, por ato duhet të jenë të lidhura me proceset e politikave.** Për krijimin e pronësisë dhe të mbajtjes së lidhjes, është e rëndësishme që procesi i zgjedhjes së temave dhe përmbajtjes së moduleve të jetë konsultativ. Posaçërisht, ministrinë përkatëse duhet të merren si partnerë.
- **Zmadhimi i madhësisë së mostrave.** Mostra aktuale është shumë e vogël për të monitoruar rezultatet e mirëqenies dhe për të kryer analizat mbi ndikimin e politikave në njësitë e ulëta të ndarjes, siç janë statistikat rurale dhe urbane për secilin regjion. Mostra e madhësisë së re duhet të ketë parasysh (a) kufizimet e kostos, (b) gabimin e dëshiruar të mostrave dhe intervalet e besueshmërisë, dhe (c) kufizimet e resurseve njerëzore (një anketim më i madh kërkon mbikëqyrje dhe bashkërendim të shkëlqyeshëm për të minimizuar gabimin e moszgjidhjes së mostrave). Në përgjithësi, si rregull, ulja e gabimit të mostrave është proporcionalisht e ndërsjellë me katrorin e madhësisë së mostrës. Për shembull,, për uljen e gabimit të mostrave për 2 kërkohet rritja e madhësisë së mostrës për

4. Përvoja nga anketimet e ngjashme në rajon tregon se duhet bërë dyfishimin e madhësisë së mostrës në rreth 4, 320-4, 800 por kërkohet një vlerësim më i kujdesshëm.

- **Investimi në mbikëqyrje.** Kjo do të minimizoj gabimet e moszgjidhjes së mostrave, do të përmirësoj cilësinë e anketave dhe do rris besueshmërinë e rezultateve nga anketat. Gjithashtu do të forcoj aftësitë personelit mbikëqyrës për ta zbatuar atë.
- **Mbajtja e çështjeve të tanishme të shpenzimeve** për të ruajtur krahaseshmërinë e të dhënave përgjatë viteve. Siç është paraqitur në vëllimin II të këtij raporti, ndryshimet në dizajnin e pyetësorit kufizon krahaseshmërinë përgjatë kohës. Respektimi i pyetësorit më të fundit, bashkë me testimet e rastit të moduleve ose çështjeve të ndryshme nëse duhet të bëhen ndryshime, do të sigurojë trende të qëndrueshme kohore.

SHTOJCA A. TABELAT DHE ILUSTRIMET

Tabela A.1: Dallimi në supozimet dhe përshtatjet e Bankës Botërore dhe FMN-së.

	<u>Supozimet e FMN-së</u>	<u>Supozimet e BB-së</u>
<u>Demografia</u>		
Shtimi i popullsisë	1.7%	0%
Numri i popullsisë		2 mil
Përpjesëtimi urban/rural	Nuk ka përshtatje	65% rurale
<u>Shpenzimet totale në ekonomi</u>	Blerje makinave, rryma elektrike, ushqimi	Asnjë

Tabela A.2: Përmbledhja e statistikave të përgjithshme kryesore sipas valës të anketimit

	Vala e anketimit							
	I		II		III		IV	
	E prit	sd	E prit	sd	E prit	sd	E prit	sd
Madhësia e ekonomisë familjare	6.77	3.53	6.46	3.27	6.09	2.84	6.09	3.08
Ekuivalenti i përshtatur për të rritur i EF	6.49	2.41	6.26	2.31	6.00	2.03	5.97	2.16
Konsumi mujor mesatar i EF (Euro)								
Konsumi i përgjithshëm i EF	370.66	282.39	331.04	210.62	362.22	256.08	314.85	221.10
Shpenzimet e përgjithshme të EF	317.31	254.80	279.83	194.45	320.01	245.36	277.85	207.58
Konsumi i ushqimit të prodhuar ose të marrë vet	53.35	86.32	51.21	75.94	42.21	68.73	37.00	70.10
Shpenzimet mujore mesatare të EF (€)								
Shpenzimet e përgjithshme të EF	317.31	254.80	279.83	194.45	320.01	245.36	277.85	207.58
Shpenzimet e ushqimit (përfshirë alkoolin dhe duhanin)	192.75	116.92	167.34	87.56	171.36	102.58	151.59	90.27
Shpenzimet jo-ushqimore	124.57	176.61	112.49	131.72	148.65	172.00	126.26	138.50

Tabela A.3: Konsumi mujor mesatar i ushqimit, në euro

	Vala e anketimit							
	I		II		III		IV	
	E prit	sd	E prit	sd	E prit	sd	E prit	sd
Shpenzimet ushqimore (përfshirë alkoolin dhe duhanin)	192.75	116.92	167.34	87.56	171.36	102.58	151.59	90.27
Buka dhe ushqimi nga drithërat	36.47	25.88	35.02	25.42	32.65	22.62	27.02	20.84
Mishi	34.27	34.73	26.67	20.16	27.51	23.28	24.83	20.27
Peshku	1.45	5.66	1.45	3.02	2.13	7.82	1.65	3.26
Qumështi, djathi dhe vezët	23.42	24.72	17.33	17.81	18.31	17.57	15.89	15.47
Vaji dhe yndyrat	10.33	8.37	8.41	6.58	8.31	5.41	7.62	5.80
Pemët	9.38	12.04	8.95	8.85	11.04	12.54	9.10	8.97
Perimet	20.36	21.09	20.12	17.95	17.52	17.88	15.87	14.64
Ëmbëlsirat (sheqer, xhem, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsirat)	11.51	9.91	10.52	8.36	11.48	9.76	9.85	8.28
Produktet e tjera ushqimore	9.00	8.07	9.34	10.30	9.56	9.60	7.64	6.35
Produktet e tjera ushqimore	9.00	8.07	9.34	10.30	9.56	9.60	7.64	6.35
Kafe, qaj dhe kakao	7.84	5.64	7.12	3.99	6.49	4.00	5.78	3.12
Pijet jo-alkoolike	9.13	12.91	9.05	9.28	10.06	10.38	8.40	8.24
Pijet alkoolike	1.86	5.98	1.39	5.02	1.36	4.09	1.24	4.20
Duhani	17.73	21.24	11.96	14.88	14.95	17.33	16.69	21.69

Tabela A.4: Shpenzimet mujore mesatare joushqimore të EF (Euro)

	Vala e anketimit							
	I		II		III		IV	
	E prit	sd	E prit	sd	E prit	sd	E prit	sd
Shpenzimet jo-ushqimore	124.57	176.61	112.49	131.72	148.65	172.00	126.26	138.50
Veshmbathja	25.52	52.58	21.72	38.13	30.09	45.54	23.40	48.34
Banimi dhe shërbimet përkatëse	43.80	91.62	38.83	53.88	45.86	63.47	41.22	59.41
Shëndeti	7.05	17.83	7.72	22.43	10.10	28.22	8.20	17.04
Transporti dhe komunikacioni	29.96	51.29	23.69	35.87	30.90	47.19	28.08	31.33
Rekreacioni dhe kultura	4.39	17.88	3.22	22.85	5.65	32.16	3.13	14.24
Arsimi	3.00	16.56	7.87	35.58	9.50	29.81	7.57	28.71
Restorantet dhe hotelet	2.57	13.73	3.72	29.85	4.24	14.45	3.64	17.45
Shërbimet dhe mallrat tjera	8.29	23.65	5.71	8.30	12.32	24.45	11.03	23.77

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF-it. Të llogaritura me matje origjinale.

Tabela A.5: Pjesët e shpenzimeve ushqimore dhe joushqimore në shpenzimet e përgjithshme

	Vala e anketimit			
	I	II	III	IV
Shpenzimet ushqimore (përfshirë alkoolin dhe duhanin)	60.75	59.80	53.55	54.56
Veshmbathja	8.04	7.76	9.40	8.42
Banimit dhe shërbimet përkatëse	13.80	13.88	14.33	14.84
Shëndeti	2.22	2.76	3.16	2.95
Transporti dhe komunikacioni	9.44	8.47	9.66	10.11
Rekreacioni dhe kultura	1.38	1.15	1.77	1.13
Arsimi	0.95	2.81	2.97	2.72
Restorantet dhe hotelet	0.81	1.33	1.32	1.31
Shërbimet dhe mallrat tjera	2.61	2.04	3.85	3.97

Tabela A.6: Pjesët e shpenzimeve për kategoritë ushqimore në shpenzimet përgjithshme në ushqim

	Vala e anketimit			
	I	II	III	IV
Buka dhe ushqimi nga drithërat	18.92	20.93	19.05	17.82
Mishi	17.78	15.94	16.05	16.38
Peshku	0.75	0.87	1.24	1.09
Qumështi, djathi dhe vezët	12.15	10.36	10.69	10.48
Vaji dhe yndyrat	5.36	5.03	4.85	5.03
Pemët	4.87	5.35	6.44	6.00
Perimet	10.56	12.02	10.22	10.47
Ëmbëlsirat (sheqer, xhem, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsirat)	5.97	6.29	6.70	6.50
Produktet e tjera ushqimore	4.67	5.58	5.58	5.04
Kafe, qaj dhe kakao	4.07	4.25	3.79	3.81
Pijet jo-alkoolike	4.74	5.41	5.87	5.54
Pijet alkoolike	0.96	0.83	0.79	0.82
Duhani	9.20	7.15	8.72	11.01

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF. Të llogaritura me matje origjinale.

Tabela A.7: Llogaritja i varfërisë për banorë sipas lokacionit

Vala e anketimit	2002-03	2003-04	2004-05	2005-06
<i>Matjet Origjinale</i>				
Gjithsej	37.7	43.7	34.8	45
Rurale	34.4	44.2	37.2	49.2
Urbane	46.6	42.1	30.3	37.4
<i>Matjet e post-shtresuara</i>				
Gjithsej	38.7	43.5	34.8	45.1
Rurale	34.4	44.2	37.2	49.2
Urbane	46.6	42.1	30.3	37.4

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF-it.

Tabela A.8: Kosovë: Vlerësimet e BPV nga FMN në çmime Aktuale, 2004–10. (Në miliona euro, përveç nëse thuhet ndryshe, që mund t' i nënshtrohet korrjimit)

	2004	2005	Prel. 2006	Projektimet			
				2007	2008	2009	2010
Konsumi	2,699	2,735	2,840	2,821	2,811	2,748	2,714
Ekonomitë familjare	1,921	1,998	2,107	2,185	2,229	2,259	2,291
Publik	779	737	733	636	582	489	423
Qeveria e përgjithshme	376	337	347	359	401	386	383
Pagat	184	195	204	204	204	200	196
Mallrat dhe shërbimet	192	143	143	155	197	186	187
Sektori i donatorëve 1/	403	400	386	276	180	103	40
Pagat	333	340	330	232	150	85	33
Bashkatdhetarët	261	255	248	176	115	65	25
Punëtorët lokal	72	85	83	55	35	19	7
Mallrat dhe shërbimet	70	60	56	45	30	18	7
Investimet	626	618	681	788	844	909	945
Sektori i donatorëve 1/	158	91	78	99	94	74	28
Qeveria e përgjithshme	169	151	99	142	204	259	270
Investimet private	300	376	504	547	546	576	646
Banimi	203	221	241	242	240	229	219
Të tjera	97	155	262	306	306	347	427
Neto eksporti i mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-	-
	1,112	-1,177	-1,283	-1,288	1,235	1,175	1,092
Eksportet	212	196	233	255	314	365	411
Eksporti i mallrave	79	66	90	113	162	201	230
Eksporti i shërbimeve	132	130	143	141	152	165	181
Importet	1,324	1,373	1,516	1,543	1,549	1,540	1,503
Importet e donatorëve	216	140	122	120	100	73	29
Mallrat dhe shërbimet e tjera	216	140	122	120	100	73	29
Importet në lidhje me ndihmën humanitare	0	0	0	0	0	0	0
Importet tjera	1,108	1,233	1,394	1,423	1,449	1,467	1,474
<i>Prej të cilave:</i> mallrat e konsumit të sektorit privat	709	785	886	860	819	780	743
Mallrat e investimeve private	167	241	329	368	403	427	442
BPV	2,214	2,177	2,237	2,320	2,419	2,482	2,567
Paratë e punëtorëve jashtë vendit	215	262	300	342	346	350	351
Pagat e emigrantëve	23	30	40	31	4	9	11
GNDI	2,451	2,469	2,577	2,693	2,770	2,841	2,929
Artikujt e memorandumit:							
Totali i ndihmës së jashtme	565	491	465	376	275	177	68
<i>Prej të cilave:</i> kontribute direkt në GNDI	204	198	181	128	93	64	36
Të ardhurat e disponueshme të	2,044	2,050	2,049	2,121	2,242	2,300	2,380

sektorit privat

Konsumi i sektorit privat në
përqindje të të hyrave të
disponueshme

GNDI për kokë banori (në
euro)

94	97	103	103	99	98	96
1,247	1,235	1,268	1,303	1,318	1,329	1,347

Vlerësime dhe projeksione të personelit të fondit prej shtatorit 2007. 1/ Sektori donatorëve përfshin UNMIK-un, KFOR-in dhe donatorët e tjerë që shpenzojnë nën të ashtuquajturën ombrellën e “programit për investime publike”, dhe shpenzimet financuar nga grantet e caktuar të donatorëve (DDGs). Ky prezantim nuk përfshin pagat e personelit të KFOR-it si dhe konsumin e mallrave të importuara direkt nga KFOR-i.

Burimi: FMN, 2007.

Tabela A.9: Shkalla e varfërisë, dallimi dhe ashpërsia, korrigjuar për hartimin e anketës

		Vlerësimi	Gabimi standard	95% intervali i besueshmërisë	
Shkalla e varfërisë (p0)	2003/04	43.5%	2.0%	39.5%	47.4%
	2005/06	45.1%	1.7%	41.6%	48.5%
Sa është varfëria (p1)	2003/04	11.9%	0.7%	10.6%	13.2%
	2005/06	13.3%	0.7%	12.0%	14.6%
Ashpërsia e varfërisë (p2)	2003/04	4.6%	0.3%	4.0%	5.2%
	2005/06	5.7%	0.4%	5.0%	6.5%

Burimi: Vlerësimet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

SHTOJCA B. PROFILI I VARFËRISË

Tabela B.1: Llogaritja e varfërisë sipas lokacionit, rajonit dhe zonave etnike

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Gjithsej	38.7	43.5	34.8	45.1
Rural	34.4	44.2	37.2	49.2
Urban	46.6	42.1	30.3	37.4
Gjakova	41.1	48.9	34.8	45.3
Gjilani	35.9	32.5	20.7	23.5
Mitrovica	50.2	59	51.2	69.7
Peja	43.8	37.8	31.8	40.1
Prizreni	41.5	48.3	41.6	40.5
Prishtina	26.3	34.3	29	40.6
Ferizaj	55.5	49.8	38.2	54.4
Rajone shqiptare	38.7	43.7	34.8	43
Rajonet serbe	34.1	39.4	33.3	80.5

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.2: Kontributi i varfërisë sipas lokacionit

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Rural	57.8	66.1	69.5	70.9
Urban	42.2	33.9	30.5	29.1
Gjithsej	100	100	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.3: Kontributi i varfërisë sipas rajonit

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Gjakova	9.9	11.5	11	12.8
Gjilani	7.8	7.9	7.8	5.6
Mitrovica	20.1	22.7	20.8	22.6
Peja	11.5	9.6	10.2	10.2
Prizreni	14.8	15.3	18.6	15.8
Prishtina	23.1	22.5	21.8	19.8
Ferizaj	12.7	10.5	9.8	13.3
Gjithsej	100	100	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF-it.

Tabela B.4: Kontributi i varfërisë sipas zonave etnike

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Shqiptare	94.4	96.4	95.9	90.2
Serbe	5.6	3.6	4.1	9.8

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.5: Llogaritja e varfërisë për kokë banori sipas kategorisë së madhësisë së EF-së

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
1 deri 3	31.6	30.7	29.3	40.4
4 deri 6	35.4	36.5	32	41.4
7 deri 9	41.7	49.5	36	48.5
10 deri 12	45.2	51.2	42.6	48.3
13+	36.2	45.5	34.7	48

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.6: Llogaritja e varfërisë sipas përkatësisë etnike të kryefamiljarit të EF-së

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Shqiptar	38.4	43.6	32.1	42.5
Serb	30	34.7	34.3	81.8
Tjetër	58.7	54.3	67	51.8

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.7: Llogaritja e varfërisë për kokë banori sipas gjinisë së kryefamiljarit të EF-së

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Meshkuj	37.8	43.3	34.2	44.8
Femra	54.2	46.8	44.9	49

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.8: Pjesa e të moshuarve në EF dhe varfëria

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Pa të moshuar	36.4	42.5	35	45.8
1-25%	44.2	46.5	35.1	42.5
26-50%	35.8	41.9	28.1	46.8
51%	59.5	44	42.3	62.3

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.9: Proporcioni i varshmërisë dhe llogaritja e varfërisë

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Vetëm të varur	51.9	40.5	27.3	65
Proporcioni i të varurve<=1	36.4	44.1	33.9	43.1
Proporcioni i të varurve>1	46.4	41.4	37.6	51.5

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.10: Arsimimi i kryefamiljarit në EF dhe llogaritja e varfërisë për kokë banori

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
I pa arsimuar, nuk di të shkruaj/lexoj	43.2	55.5	45.2	52.2
I pa arsimuar por din të shkruaj/të lexoj	49.9	55.1	42.1	56.5
Nuk e ka përfunduar shkollën fillore	43.3	48.2	45.2	60.8
Shkolla fillore	43.6	49.1	41	51.4
Shkolla e mesme	34.9	39.8	33.2	40.5
Shkollën profesional	27.4	30	15.3	31.5
Universitet ose më lartë	25.9	25.5	12.7	19.5

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.11: Aktiviteti kryesor i kryefamiljarit të EF dhe llogaritja e varfërisë për kokë banori

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Punëdhënës	37.3	37.2	19.2	18.4
I punësuar me pagë	29.7	38.6	25.5	35.8
Bujk për ekzistencë	39.1	40.9	35.9	42.6
Punëtor ditor	48.2	50	48.5	60.8
Të vet-punësuar tjerë	36	35.4	18.1	29.6
Të pensionuar/ të paaftë për punë	42.8	44.8	35.4	47.5
Papunësuar	45	51.4	48.9	58.6
Amvise	55.6	22.7	53.3	53.6
Të tjera	20.2	56.8	43.1	58.6

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.12: Sektori i punësimit të kryefamiljarit të EF dhe llogaritja e varfërisë

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
I vet-punësuar, bujqësi	39.1	40.9	35.9	42.6
I vet-punë., miniera/ndërtimtar	45.7	45.7	49.2	51.9
I vet-punë., tregti	55.1	43.7	25.2	37.5
I vet-punës., tjetër	35.2	42.1	20.5	41.3
Me pagë, profesionist	21.8	30.1	15.2	27.5
Me pagë, prodhimtari	37.6	45.1	34.9	42.3
Me pagë, tjerë	31.4	41.8	30.1	36.6
Papunë	45	51.4	48.9	58.6
Joaktiv	42.8	44.8	37.4	48.5

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.13: Posedimi i tokës dhe varfëria rurale

	2002/03	2005/06
Pa tokë	43.1	64
Posedon tokë	33.5	47.8

Tabela B.14: Posedimi i bagëtisë dhe varfëria Rurale

	2002/03	2005/06
Pa bagëti	38.2	55.6
Të paktën 1	27.9	49.4
Më shumë se 1	37.3	43.9

Tabela B.15: Posedimi i pajisjeve të rënda dhe varfëria në vendet rurale

	2002/03	2005/06
Pa pajisje	35.5	55.8
Të paktën 1 pajisje	32.6	37

Shënim: Të matura nga niveli individual i matjeve. Vetëm gjysma e valës III përmban vështrime mbi posedimin e tokës prandaj nuk është përfshirë. *Burimi:* Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF.

Tabela B.16: Punësimi dhe arsimimi, 2002/03. A kanë personat mirë të arsimuar më shumë gjasa të punësohen?

	Nuk e ka kryer filloren	Shkollimin fillor	Shkollimin e mesëm	Shkollimin profesional	Shkollimin e lartë
Punëdhënës	0	0.5	1.6	3.5	3.4
I punësuar me pagë	2.4	8	29.5	65.6	74.5
Bujk për ekzistencë	3.8	6.3	5.2	1.2	0.2
Punëtor ditor	1.4	5.5	6.3	1.9	1.5
I papunë	10.5	28	40.4	13.2	13.8
Amvise	59.3	43.8	8.9	3.9	0.8
Të tjerë	22.6	8	8.1	10.7	5.8
Totali	100	100	100	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF. Shifrat e Matura për moshat 15-65 vjet.

Tabela B.17: Papunësia dhe arsimi, 2003/04. A kanë personat e papunë më shumë gjasa të jenë me kualifikim të ulët arsimor?

	Të punësuar	Të papunë
Nuk e ka kryer filloren	2.5	3.9
Shkollimin fillor	26.9	39.4
Shkollimin e mesëm	53	53.2
Shkollimin profesional	7.8	1.6
Shkollimin e lartë	9.9	1.9
Gjithsej	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF. Shifrat e matura për moshën prej 15 deri më 64 vjeçare. Amviset, punëtorët e familjes që nuk paguhet dhe studentët nuk janë përfshirë

Tabela B.18: Punësimi dhe arsimi, 2003/04. A kanë personat mirë të arsimuar më shumë gjasa për punësim?

	Nuk e ka kryer filloren	Shkollimin fillor	Shkollimin e mesëm	Shkollimin profesional	Shkollimin e lartë
Punëdhënës	0.4	0.5	1.4	1.8	0.94
I punësuar me pagë	2.6	6.5	28.8	68.2	72.3
Bujk për ekzistencë	5.4	6.9	5.5	3.4	0
Punëtor me mëditje	0.6	3.2	5.4	0.8	1.1
Papunësuar	19.4	35.7	43.5	15.7	18.1
Amvise	51.8	41.7	6.5	3.2	0.8
Të tjerë	19.8	5.5	8.9	6.9	6.8
Gjithsej	100	100	100	100	100

Burimi : ABEF 2003/04. Shifrat e matura për moshat 15-65 vjet.

Tabela B.19: Papunësia dhe arsimimi, 2003/04. A kanë personat e papunë më shumë gjasa të jenë me kualifikim të ulët arsimor?

	Të punësuar	Të papunë
Nuk e ka kryer filloren	3	5.4
Shkollimin fillor	23.9	42.2
Shkollimin e mesëm	55.4	48.8
Shkollimin profesional	8.1	1.5
Shkollimin e lartë	9.6	2.1
Gjithsej	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF. Shifrat e matura për moshën prej 15 deri më 64 vjeçare. Amviset, punëtorët e familjes që nuk paguhen dhe studentët nuk janë përfshirë

Tabela B.20: Arsimimi dhe punësimi, 2004/05. A kanë personat mirë të arsimuar më shumë gjasa për punësim?

	Nuk e ka kryer filloren	Shkollimin fillor	Shkollimin e mesëm	Shkollimin profesional	Shkollimin e lartë
Punëdhënës	1	0.2	1.6	0.9	1.2
I punësuar me pagë	2.5	5.3	29.1	67.2	75.6
Bujk për ekzistencë	4.3	7.5	6.9	1.5	1.7
Punëtor me mëditje	1.6	5.6	5.1	1.1	1.4
Papunësuar	17.8	33	39.9	17.1	13.5
Amvise	57.1	42.2	7.7	2.8	0.5
Të tjerë	15.7	6.2	9.8	9.3	6
Gjithsej	100	100	100	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF. Shifrat e Matura për moshat 15-65 vjet.

Tabela B.21: Papunësia dhe arsimiti, 2004/05. A kanë personat e papunë më shumë gjasa të jenë me kualifikim të ulët arsimor?

	Punësuar	Papunësuar
Nuk e ka kryer filloren	3.7	6.6
Shkollimin fillor	23.9	41.6
Shkollimin e mesëm	52.9	47.7
Shkollimin profesional	8.4	2.1
Shkollimin e lartë	11.2	2
Gjithsej	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF. Shifrat e matura për moshën prej 15 deri më 64 vjeçare. Amviset, punëtorët e familjes që nuk paguhen dhe studentët nuk janë përfshirë

Tabela B.22: Punësimi dhe Arsimi, 2005/06. A kanë personat mirë të arsimuar më shumë gjasa për punësim?

	Nuk e ka kryer filloren	Shkollimin fillor	Shkollimin e mesëm	Shkollimin profesional	Shkollimin e lartë
Punëdhënës	0.3	0.1	1.4	1.1	3.6
I punësuar me pagë	3	6.2	27.7	70.6	69
Bujk për ekzistencë	3.6	7	5.6	2.4	1.1
Punëtor me mëditje	1.8	3.9	4.3	1.6	1.3
Papunësuar	16.9	32.1	41.1	15.1	16.6
Amvise	55.2	43.8	10.3	2.6	1
Të tjerë	19.2	6.8	9.7	6.6	7.3
Gjithsej	100	100	100	100	100

Burimi : Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF. Shifrat e matura për moshat 15-65 vjet.

Tabela B.23: Papunësia dhe arsimimi, 2005/06. A kanë personat e papunë më shumë gjasa të jenë me kualifikim të ulët arsimor?

	Të punësuar	Të papunë
Nuk e ka kryer filloren	3.3	5.4
Shkollimin fillor	23.8	39.3
Shkollimin e mesëm	56.4	52
Shkollimin profesional	7.1	1.4
Shkollimin e lartë	9.4	1.9
Gjithsej	100	100

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF. Shifrat e matura për moshën prej 15 deri më 64 vjeçare. Amviset, punëtorët e familjes që nuk paguhen dhe studentët nuk janë përfshirë

Tabela B.24: Varfëria dhe papunësia

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Shkalla e varf.e të papunës.	40.8	50.6	40.8	49.5
Shkalla e varf.e të punësua.	32.2	31.9	25.9	34.7
% e të varfërve të papunës.	52.7	63	59	58.6
% e jo-të-varfër të papunës.	43.5	43.8	42.1	43.3

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat e ABEF. Pyetësori nuk ka informata mbi pasivitetin dhe në këtë mënyrë shkallët e papunësisë nuk mund të kalkuloen.

Tabela B.25: Bruto shkalla e regjistrimit për shkollimin fillor

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Gjithsej	100.9	92.4	90.6	93
Të varfër	100.3	92.8	85.6	92.5
Meshkuj	101.1	92.5	90.4	93.1
Femra	100.6	92.4	91	92.9
Një e pesta më e varfër	98.3	92.3	82.7	91.3
Një e pesta 2	100.8	92.7	90.8	95.2
Një e pesta 3	101.5	93.5	93.7	91.5
Një e pesta 4	103.4	93.7	94.4	94.8
Një e pesta më e pasur	100.6	89.6	93.2	92.1

Tabela B.26: Neto regjistrimi për shkollimin fillor

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Gjithsej	92.2	87.7	85	87.7
Të varfër	90.1	87.2	78.8	85.9
Meshkuj	92.8	88.9	85.6	88.4
Femra	91.6	86.6	84.4	87
Një e pesta më e varfër	86.4	84.6	75.4	83.3
Një e pesta 2	92.7	89.5	84.8	89.5
Një e pesta 3	91.7	87.4	85.3	84.5
Një e pesta 4	94.1	89	88.9	90.1
Një e pesta më e pasur	96.7	87.6	92.5	91.5

Burimi: Llogaritjet e personelit të Bankës Botërore nga të dhënat ABEF. Bruto shkallët e regjistrimit = Totali studentëve/fëmijëve të regjistruar në një grup moshë. Neto shkallët e regjistrimit = Totali i studentëve të regjistruar të moshës 6-14/fëmijët e kësaj grup moshe. Në pyetësorin e vitit 2002/03, Pyetja për regjistrim është bërë për fëmijët mbi 7 vjet. Në anketat e mëvonshme kjo është ndryshuar në 6 vjet. Grup moshat e përdorura janë: fillor 7-14 në 2002/03, Për fillor 6-15 duke filluar nga 2003/04; të mesëm 16-18; terciar 20-24.

Tabela B.27: Neto regjistrimi për shkollimin e mesëm

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Gjithsej	73.1	70.9	66.4	74
Të varfër	68.3	65.1	58.3	72
Meshkuj	75.6	72.6	69.6	81.2
Femra	70	69.2	62.9	66.4
Një e pesta më e varfër	65.3	62.8	54.6	67.3
Një e pesta 2	71.4	64.7	65.2	78.1
Një e pesta 3	81.5	74.5	65.1	71.3
Një e pesta 4	69.3	77.1	73	72.4
Një e pesta më e pasur	76.5	80.9	80.5	81

Tabela B.28: Neto shkalla e regjistrimit për arsimin terciar

	2002/03	2003/04	2004/05	2005/06
Gjithsej	16.7	15.3	14.6	17.7
Të varfër	12.2	9.3	9.3	13.8
Meshkuj	20.4	14.6	17.3	19.9
Femra	13	15.9	12.2	15.2
Një e pesta më e varfër	8.9	7.6	8.8	12.9
Një e pesta 2	15.2	9.6	10.8	12.6
Një e pesta 3	18.5	15.1	14.7	15
Një e pesta 4	20.6	17	12.7	18.3
Një e pesta më e pasur	18.2	26.5	24.3	27.4

